



**SIMON MIRAKAJ EUGEN
MERLIKA FATBARDHA
MËLYSHI HAZIR HAZIRAJ
GJELË GJIKOLA KURT KOLA
LEK PERVIZI NDU MËLYSHI
KAMPI I TEPELENËS AGE
MIRASH NOJA FATBARDHA
SARAÇI SOKOL MIRAKAJ
VALBONA MIRAKAJ SEIT
PETRELA NIKOLLË DOJANAJ
DËSHMITË E TË
MBIJETUARVE**



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

KAMPI I TEPELENËS

DËSHMITË E TË MBIJETUARVE

EDHE | MURET
KANE | VESHE

VOL. 1

Gusht 2018, Tiranë

KAMPI I TEPELENËS - DËSHMITË E TË MBIJETUARVE

Botuar në Gusht 2018, Tiranë

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Adresa: Garda e Republikës së Shqipërisë,

Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë, Shqipëri

Konsulent Shkencor

Prof. Dr. Gjergj Sinani

Intervistat

Kristale Ivezaj Rama

Mira Tuci

Përpunimi dhe redaktimi i dëshmive

Dr. Mirela Sinani

Fotografia

Ervin Kotori

Design

Grid Cartels

Kopertina

Kampi i Tepelenës, kazerma Nr. 1. Pamje e përgjithshme, e njëjtë me tre kazermat e tjera.

Ilustrim nga Lek Pervizi, vuajtës në kamp bashkë me familjen e tij.

Botimi u përgatit në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar", me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe të Qeverisë së Italisë.



*Ambasciata d'Italia
Tirana*



*Empowered lives
Resilient nations.*

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorit/ëve dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë si pasqyrim i qëndrimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) apo të Qeverisë së Italisë.

I nderuar lexues,



Historitë e rrëfyera në këtë botim hapin faqe të historive personale që premtojnë dhimbje, lot e vuajtje. Por dialogu shoqëror që synojmë të edukojmë e zhvillojmë për të shkuarën mund të realizohet vetëm nëpërmjet kësaj hapjeje e dokumentimi. Sepse është përballja me të vërtetën ajo që e çon shoqërinë drejt shërimit dhe rivendos ekuilibra. Kjo përballje nënkupton edhe zbardhjen e fateve të të pafajshmëve dhe nderimin i sakrificës së atyre që ia dolën me dinjitet njerëzor, duke njohur përjetimet e tyre, përmes zërave të tyre. Ky është hapi i rëndësishëm që hedhim sot.

Kujtesa historike është në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive. Ajo luan rol në ndërtimin e raporteve mes grupeve të ndryshme të shoqërisë. Mungesa e saj mund të jetë edhe burim i tensioneve apo konflikteve. Iniciativa të tilla të përkujtimit, dokumentimit historik e më gjerë, të gjitha bashkë luajnë rol në krijimin dhe zhvillimin e një pikëpamjeje historike të individëve e grupeve të caktuara dhe janë mjete komunikimi të diskutimit lokal apo kombëtar a më gjerë.

EDHE MURET KANË VESHË u titullua platforma e rrëfimeve të mbledhura nga AIDSSH. Me historitë e mbledhura me kujdes dhe përgjegjësi, përmes zërave të padëgjuar, AIDSSH i jep një shans më shumë mbështetjes së kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, krahas qasjes së papenguar në dokumentet e Sigurimit të Shtetit në diktaturë.

Metodologjia e EDHE MURET KANË VESHË u zhvillua në kuadër të projektit “Përkujtojmë për të Shëruar dhe Parandaluar”, i zbatuar nga AIDSSH, me mbështetjen e UNDP Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë, të cilët mbështetën edhe këtë botim të parë të kësaj kolane. I falënderojmë për mbështetjen!

Formati i pyetjeve u zhvillua me këshillën e studiuesve nga Instituti i Historisë dhe AIDSSH. Transkriptimi u bë në zyrat e AIDSSH, ku dhe ruhen rrëfimet e regjistruara me zë dhe figurë. Në dukje e thjeshtë, kjo është punë shumë voluminoze dhe e kujdesshme, dhe AIDSSH falënderon të gjithë kontribuesit, por sidomos të mbijetuarit që, ndonëse në pjesën më të madhe kanë moshë të thyer, na i besuan me durim kujtimet e tyre të dhimbshme.

Këto dëshmi do të administrohen me kujdes dhe do t'i vihen në dispozicion çdo studiuesi, në çdo kohë, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë dhe vullnetit të qytetarëve që na kanë besuar rrëfimet, përmes marrëveshjes që kanë nënshkruar me intervistuesin. AIDSSH merr përsipër të administrojë dhe ruajë këto regjistrime, me standardin e një arkivi të vyer historik.

Botimi i parë përmbledh dëshmitë e të mbijetuarve të Kampit të Internimit në Tepelenë 1949-1953. Ky botim do të ndiqet nga dëshmi të tjera të të mbijetuarve, si dhe nga dëshmitë e tepelenasve bashkëkohës të kampit, duke synuar përshkrimin e përjetimeve të tyre në bashkëjetesën e detyruar me të internuarit e asaj periudhe.

“Tregimi im, është detyrim moral për prindërit e mi, për veten time, për ju o bij, për bashkëvujtësit e mi dhe për shoqërinë,” shprehej një nga të mbijetuarit që dëshmoi kalvarin e vet gjatë diktaturës. Pikërisht ky është motivi që na shtyn përpara në punën tonë.

Gentiana Sula
Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

FALËNDERIME

Irma Bataj

Sonila Boci Pepivani

Ermira Shtino

Bianka Hada

Entela Lako, PNUD

Edlira Papavangjeli, PNUD

Elona Dini, PNUD

Gjon Radovani

Ardita Repishti

Mira Tuci

Dëshmitarët

SIMON MIRAKAJ

GJELE GJIKOLA

HAZIR HAZIRAJ

NDUE DHE FATBARDHA MELYSHI

NIKOLLE DOJANAJ (DEDE)

LEK PERVIZI

SEIT PETRELA

EUGEN MERLIKA

SOKOL DHE VALBONA MIRAKAJ

FATBARDHA SARAÇI

KURT KOLA

AGE MIRASH NOJA

Parathënie

N

Në momentet e tronditjeve të mëdha të kalimit nga një regjim totalitar në një shoqëri të lirë, kemi një shpërthim dëshmish e kujtimesh për krimin dhe terrorin e organizuar shtetëror, të cilin, regjimi i atyre viteve u mundua me të gjitha mjetet ta mbante të fshehur e larg çdo mundësie vëzhgimi, verifikimi e analize. Është e rëndësishme të mbahet gjallë kujtesa e të kaluarës, pasi nuk mund të ketë pajtim shoqëror pa kujtesë dhe njohjen e të vërtetës.

Ruajtja dhe promovimi i kujtesës së krimeve të kryera nga regjimi totalitar komunist është thelbësor edhe për edukimin e brezave të rinj, ashtu sikurse për ndërtimin e demokracisë dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Një kujtesë e mirëruajtur, e organizuar dhe e dokumentuar krijon mundësi njohjeje të tmerreve të së kaluarës dhe bëhet një instrument real për njohjen dhe edukimin. Edukimi qytetar aktiv ka një rol të madh në mbështetjen e aftësive qytetare të të rinjve dhe vlerave demokratike.

Trashëgimia e dhunshme (Term i përdorur nga jurisprudenca europiane për të treguar të kaluarën e dhunshme të regjimeve komuniste) e sistemeve totalitare komuniste nuk është e lehtë për t'u trajtuar për disa arsye. Në nivel institucional, kjo trashëgimi përfshin centralizimin ekstrem, militarizimin e institucioneve civile, burokratizimin, monopolizimin dhe rregullimin absolut të çdo sektori të jetës individuale dhe kolektive; në nivelin

shoqëror, kjo trashëgimi përfshin nga kolektivizmi dhe konformizmi te bindja e verbër dhe mënyra totalitare e të menduarit. Vendosja e një situatë qytetare, liberale, nën shtetin e të drejtës është një proces i vështirë për shkak se strukturat e vjetra dhe mënyra e vjetër e të menduarit duhet të çmontohen dhe të kapërcehen. Duke marrë parasysh eksperiencën e një regjimi të tillë totalitar, për brezat e rinj bëhet një detyrë imperative njohja dhe reflektimi ndaj një shoqërie të tillë, ku individët ishin tërësisht të tjetërsuar.

Gjatë procesit të tranzicionit kuptohet që objektiv kryesor është krijimi i demokracisë pluraliste, bazuar në shtetin e të drejtës (ndërsa fatkeqësisht, me apo pa qëllim, te ne përdoret ende termi “shtet ligjor” dhe jo “shteti i të drejtës”, në një kohë që edhe shtetet totalitare ishin ligjorë, por jo të drejtë) dhe respektin ndaj ndryshueshmërisë dhe të drejtave të njeriut.

Parimi i subsidiaritetit (nënkupton se autoriteti kolektiv mund të ndërhyjë vetëm kur individët nuk janë, nga vetvetja, në gjendje që të arrijnë një objektiv të njohur dhe të pranuar, por që, në këtë rast, ky autoritet duhet të ndërhyjë dhe se, në qoftë se ekzistojnë disa nivele autoriteti, është e përshatshme që ai të ndërhyjë në nivelin më të ulët që të jetë i pajtueshëm me qëllimin e kërkuar. Në nivelin e komunës më shumë se sa në atë të provincës, në nivelin e qarkut se sa në atë të shtetit, në nivelin e shtetit kur shtetet janë të pafuqishëm. Kjo formulë kufizon njëherësh shtrirjen e ndërhyrjes kolektive dhe distancën në raport me qytetarin ndaj të cilit ushtrohet. Në parim, u siguron individëve lirinë më të madhe të pajtueshëm me interesin e përgjithshëm. Përshkruar në këtë mënyrë, kjo analizë buron më shumë nga bon sens se sa nga filozofia politike

dhe, kështu, nuk është e vështirë të kapet nga opinioni publik“.), liria e zgjedhjes, barazia e shanseve, pluralizmi ekonomik dhe transparenca e procesit të vendimmarrjes kanë një rol të madh në këtë proces. Ndarja e pushteteve, liria e shtypit, njohja e pronës private dhe mbrojtja e saj me ligj si dhe zhvillimi i një shoqërie civile, janë disa nga mjetet që mund të përdoren me efektivitet të lartë për të realizuar qëllimet e mësipërme. Në funksion të këtyre qëllimeve është realizuar mbledhja e dëshmive të njerëzive që përjetuan dhunën dhe terrorin totalitar komunist 45-vjeçar, që sakrifkuan jetën, rininë e tyre qoftë për shkak të ideve dhe akteve vetjake, qoftë për shkak të lidhjeve familjare, njohja me kalvarin e jetës, qëndresa e atyre që kaluan nga ferri i Maliqit, Tepelenës, Spaçit, etj dhe bërja publike e tyre. Rënia në kontakt me këto dëshmi ka impakt të drejtpërdrejtë transformues të vetëdijes njerëzore, sepse *nuk ka qenie njerëzore të mos krijojë respekt dhe nderim për cilindo vuajtës të asaj diktature, pasi të lexojë dhe njohë këto dëshmi, nuk ka qenie njerëzore të mos ndryshojë mendësi e këndvështrim për të kaluarën, që tjetër i ishte paraqitur dhe tjetër ishte realisht.*

E keqja e një individi dhe është e vështirë të zhbëhet, po ajo e një regjimi të tërë të organizuar në të gjitha strukturat dhe instrumentet e tij? Aq më keq me një jetëgjatësi 45 vjeçare? Të çmontohet trashëgimia është një fjalë goje, por si, kur ajo ka hedhur rrënjë në mendjen e njerëzve, u ka errësuar shikimin, u ka mohuar mendimin e lirë dhe mendimin vetjak, ka mohuar fjalën e lirë, këmbimin e ideve, diskutimet. Pa i rikthyer çeljes së ndërjegjeve vetjake, rritjes së tyre me vlerat e lirisë dhe të të drejtave të njeriut, asgjë nuk fillon të ndryshojë. Këtë mund dhe duhet ta realizojë një shtet demokratik. Është nga detyrat e para më imediate të tij, nëse pretendon të jetë shtet demokratik. Dhe për këtë janë jashtëzakonisht të vlefshëm filozofët, janë të paçmueshëm.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, në Rezolutën 1096 (1996), theksonte se një shtet demokratik zotëron mjete të mjaftueshme për të bërë që të respektohet drejtësia dhe fajtorët të ndëshkohen, por duke bërë kujdes që vendin e drejtësisë të mos e zërë fryma e hakmarrjes. Ka rëndësi respektimi i të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, siç janë e drejta për një proces të rregullt dhe të drejtë dhe këto parime të zbatohen për të gjithë, edhe ndaj atyre që i kishin shkelur kur ishin


në pushtet. Një shtet demokratik i të drejtës është gjithashtu në gjendje të mbrohet edhe ndaj një ringjalljeje të rrezikut totalitar komunist, duke shfrytëzuar mjete të shumta, pa i cënuar të drejtat e njeriut, që kanë përparësi të drejtën dhe që rezultojnë nga e drejta penale dhe masat administrative.

Një çështje tjetër që kjo Rezolutë thekson ka të bëjë me nevojën që ky proces duhet të shoqërohet edhe me një transformim të mentaliteteve (një transformim të zemrave dhe shpirtave), të cilat duhet të kenë si qëllim kryesor të shmangin frikën për marrjen e përgjegjësisë, të shmangin mosrespektimin e diversitetit, nacionalizmin ekstrem, intolerancën, racizmin dhe ksenofobinë, të cilat janë gjithashtu pjesë e trashëgimisë së regjimeve të vjetra. E gjitha kjo, duhet zëvendësuar me vlerat demokratike si toleranca, respekti ndaj diversitetit, subsidiariteti dhe përgjegjshmëria.


Rëndësi ka theksimi nga Rezoluta i procesit të rehabilitimit të personave që kishin qenë deklaruar fajtorë për “krime”, të cilat në një shoqëri të civilizuar nuk përbëjnë akte kriminale, si dhe personat që janë dënua në mënyrë të padrejtë, krahas gjyqimit të autorëve të krimeve si procese që duhet të kryhen paralelisht.

Kjo Rezolutë na mëson se garancia më e mirë për çmontimin e regjimeve totalitare komuniste janë reformat e thella politike, juridike dhe ekonomike që duhet të ndërmerren këto vende, të cilat duhet të shpien në formimin e një shpirti demokratik dhe të një kulture politike autentike. Duke marrë parasysh parimet e mësipërme dhe përvojën politike dhe juridike të organizatave ndërkombëtare, edhe pse vonë, ne duhet të përballemi me kurajo me kujtesën e të kaluarës sonë të afërt dhe sidomos me përvojën e hidhur të “kampeve të detyrueshme të punës”, siç ishte Kampi i Tepelenës.

Në debatin rreth shkrimit të një “historie zyrtare” dhe konkurrencës që po i bën kujtesa, është e domosdoshme që të tregohen dallimet dhe ndikimet reciproke. Ku qëndrojnë dallimet dhe konvergjenat ndërmjet historisë dhe kujtesës? A ka një detyrë të kujtesës? Cili duhet të jetë roli i historianit në debatet shoqërore rreth historisë dhe kujtesës? Termat “bashkëfajtorë” apo “të paanshëm” si duhen përdorur saktë shkencërisht dhe si janë përdorur shpesh abuzivisht nga politika për të justifikuar krim-



KAMPI I TEPELENËS, KAZERMA NR. 1
Pamje e përgjithshme, e njëlllojtë me tre
kazemat e tjera. *Ilustruar nga piktori Lek*
Pervizi, vuajtës në kamp bashkë me familjen



in komunist, mbuluar përgjegjësit dhe penguar drejtësinë që të kryejë procese të rregullta ndaj tyre? Ka edhe shumë pyetje të tjera të cilat nuk mund të zgjidhen nga baza të thjeshta empirike, por kërkohet padyshim njohje të thellë të proceseve historike, njohje të vlerave njerëzore dhe metodën e duhur për të ndërtuar diskutimin, analizën dhe vlerësimin sa më saktë e sa më mirë.

Historia dhe kujtesa janë dy fusha të ndryshme; çdo njeri ka kujtesën e vet, me kujtime të mira apo të këqija; Kujtesa ruan gjurma të të kaluarës, të brendësuar, të shkruara në identitetin tonë. Në nivelin individual nuk ka kurrë dy kujtime identike. Por, kujtesa është edhe kolektive, që krijohet nga shumë individë, por edhe ajo është gjithnjë në ndikimin e asaj të tashmeje kur krijohet. Ndërkaq, historia ka një qasje tjetër, që nuk është një qasje e pjeshme apo për bujë, megjithëse ne sot më shumë shohim këtë të dytën, bujën. *Ambicioni i saj, siç shprehej Herodoti, është "një procedurë për të vërtetën" dhe një diskutim kritik.* Mosmbajtja parasysh e këtyre kritereve, partitizimi i historibërjes, në vend që t'i shërbejnë jetës, siç shprehej Niçe, e rëndojnë akoma më shumë jetën tonë. Rreziku i parë vjen nga ngatërimi i tyre, ndërkohë që kujtesa nuk është histori dhe historia nuk është kujtesë, por si njera dhe tjetra janë në marrëdhënie të ngushta. Historia dhe kujtesa kanë të përbashkët faktin se të dyja janë të lidhura me kohën.

Rrjedha e kohës ekziston në vetvete, pa mbështetjen e kujtesës, përfshirë dhe kujtesën e individëve. Koha nuk identifikohet e "historinë". Shoqëritë njerëzore nuk mund të asimilohen te e kaluara. Kjo "histori, ekuivalent i të kaluarës" ekziston pa historianin, në qoftë se asnjë gjurmë materiale e mjaftueshme nuk i ka lejuar historianit të rishkruajë një tregim. Megjithatë, kjo histori nuk ekziston pa aktorët e saj. Në qoftë se këta kanë ruajtur kujtime dhe kanë tentuar t'i transmetojnë duke u dhënë atyre një koherencë, atëherë lind një kujtesë dhe shpesh edhe një histori. Kështu, historia është koha e ngulitur në tregimin e të kaluarës të shoqërive njerëzore. Historia si historiografi, domethënë si prirja për të shpjeguar dhe interpretuar kohën që nuk është më, nuk ekziston pa vështrimin retrospektiv të historianit, që nënkupton edhe distancën. Historiani priret të kuptojë, duke na propozuar edhe një model shpjegimi, një pjesë, qoftë edhe të vogël, të procesit që ka farkëtuar të tashmen tonë dhe që e ka transformuar dhe vazhdon të peshojë mbi të ardhmen tonë. Kjo histori

është e pandashme nga formalizimi diskursiv dhe kjo është e vërtetë si për historinë "të ngjarjeve", edhe për kronikat dhe analet, qoftë për një kohë të gjatë, apo një kohë më të shkurtër, si ato që lidhen me shpjegimin e fenomeneve demografike, dekriptimin e mekanizmave ekonomikë, depërtimin në "universin mendor", zbulimin e jetës së përditshme dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve në të kaluarën, për të analizuar praktikatat kulturore dhe sistemet e normave dhe zakoneve, si dhe të shumë fushave të tjera, përfshirë dhe historinë e kujtesës. Që të jetë e kapshme dhe e transmetueshme, çdo histori është një diskutim, por një diskutim i distancuar dhe çdo qasje historike nxjerr në pah, në mënyrë të qartë ose të pandërgjegjshme, një marrëdhënie me të vërtetën e kohës dhe të njerëzimit, që gjithmonë ka shtruar probleme për historianët dhe filozofët.

Ngandonjëherë, historia mund të paraqitet si de-shifrim i kujtesës, si për shembull në rastin e aneve dhe kronologjive. Por, a mund të thuhet se historiani, kur tenton të shkruajë Histori, rikrijon një kujtesë, propozon një model kujtese? Kur proceset dhe ngjarjet që analizon historiani janë afër kohës sonë, e tillë mund të jetë një nga pasojat e punës së tij. Kur ka si objekt periudha të hershme, për të cilat nuk ekzistojnë më as dëshmitarë, apo aktorë, atëherë është shoqëria që merret si model interpretimi. Në këtë rast historiani shtron pyetje për të kaluarën dhe përmes një analize kritike të burimeve, ai ndërton një pikturë të së kaluarës që mendon se përputhet me ngjarjen e ndodhur.

Ndërsa kujtesa, më shumë se historia, është e lidhur me aspektin ndijesor, perceptues, emocional. Kujtesa është një të jetuar në një evolucion të përhershëm, që kërkon ndërmjetësimin e aktorëve dhe dëshmitarëve bashkëkohorë të fakteve. Madje edhe në formën e shkruar, në formën e "kujtimeve", ose të "historive jetësore", ajo paraqitet si dëshmi i jetuar. Në këtë kuptim, ajo është tërësisht subjektive dhe nuk ekziston pa mbështetjen e individëve, pa një krijim aktiv të këtyre.

E rëndësishme është që referencat për të kaluarën të mos seleksionohen për të justifikuar një qëndrim politik, sepse edhe kujtesa, ashtu si historia mund të shkasë në favor të ideologjisë. Në këtë kohë, e rëndësishme nuk është thjesht që të silllet historia e persekutimit, e cila bën të mundur të kapet eksperiencia e katastrofës, por që merret

një distancë. Grumbullimi i një mase të madhe kujtimesh, që flasin për dhimbjen njerëzore, mund të marrë kuptim vetëm në qoftë se gjenden njerëzit për t'i treguar këto ngjarje, fjalë që na bëjnë të depërtojmë në sferën e kuptimeve. Me pak fjalë, e rëndësishme nuk është që të kujtohet kjo e kaluar e dhimbshme, të kujtohet dhimbja, po e rëndësishme është që të mendohet për këtë të kaluar. Puna e mendimit është një kusht i domosdoshëm me qëllim që ngjarjet e kujtuara të formohen si eksperiencë, për të mos ngelur vetëm në nivelin e psikikës. Nga ana tjetër, të shtiresh sikur nuk ka ndodhur asgjë, kjo është akoma më e keqe.

Kështu, dalja e nocionit të detyrës së kujtesës lidhet me vendosjen e një marrëdhënie me Shoah ("Shoah, term që tregon shfarosjen e hebrehjve"), me qëllim që të mos bëhej një vrasje e dytë duke i harruar ata që u shfarosën në kampet e vdekjes. Shpesh diskutimi përmbledhet në këtë arsyetim; "Pse të kujtojmë? Me qëllim që ajo që ndodhi të mos përsëritet kurrë". Por, kujtesa nuk garanton asgjë. Detyra e kujtesës nënkupton të kujtuarit. Por, çfarë është të kujtuarit? Të përsëriten disa fakte? Të marrësh në konsideratë një tërësi shifrash dhe emrash? Kjo në asnjë mënyrë nuk është e mjaftueshme. Më e rëndësishme se sa të jesh në dijeni çfarë ka ndodhur në të kaluarën, është të menduarit e saj, pasi vetëm të menduarit do të na mundësojë që të dallojmë përgjegjësitë e asaj kohe dhe tonat. Ne duhet të themi të vërtetën edhe në rast se ajo është një detyrë e rëndë dhe e vështirë. Kjo do të thotë se na duhet të bëjmë një punë serioze historike, për të studjuar se si u vendos dhe funksionoi një regjim i tillë. Ka mbi 20 vjet që shteti në mënyrë institucionale nuk e ka kryer këtë, por në mënyrë mediatike futen njerëzit në qerrthullin e diskutimit shterpë për të përcaktuar kush ishte i miri apo i keqi, ndërkohë që gabimi nis që tek mendësia me palë kundërshtarë apo logjika e dy të kundërtave.

Na duhet të angazhohemi të mendojmë, jo thjesht me shpresën se një gjë e tillë nuk duhet të përsëritet më kurrë, por, sepse ne duhet të mësojmë të jemi njerëzorë, ashtu siç kemi emrin njeri, pra, duhet të mësojmë të jetojmë ndryshe nga ç'kemi jetuar.

Këto kujtime që na bëjnë të prekim dhe të ndiejmë dhimbjen njerëzore, duhet të shërbejnë pikërisht për t'u bërë më njerëzorë, për të gjetur kurdoherë

mënyrën sesi të jemi njerëzorë. Filozofi gjerman *Karl Jaspers shkruante se "Totalitarizmi është si një spektër që pi gjakun e të gjallëve dhe, përmes kësaj, bëhet real, ndërkohë që viktimat e tij mbijetojnë nga vetvetja, turmë kufomash ambulante".* Këto kujtime dëshmojnë se armiku më i madh i regjimeve totalitare ishte bota e lirë. Meqënëse ne tani kemi mundësinë të flasim lirshëm, detyra e parë është që të ndërtohet një dialog autentik dhe kjo nuk është një detyrë e thjeshtë. Asnjë nga ne nuk është profet që të tregojë se çfarë duhet bërë. Ata që e morën përsipër ta bënin një gjë të tillë, ata e shkatërruan lirinë tonë. Secili duhet të mësojë kurajon për të qenë i përgjegjshëm. Në qoftë se ne nuk do ta kemi këtë kurajo, nuk do të jetë vetëm kombi që do të humbasë, por vetë njeriu. "*Shqipëria është e vogël për të parë, po edhe për të qarë*", kjo frazë e thjeshtë e *znj. Gjellë Gjikota, e mbijetuara e Kampit të Tepelenës*, flet më shumë se qindra faqe diskutimesh pa bereqet që na vjen nga diskursi politik i ditës.

Ne të gjithë, si njerëz të lirë, duhet të kërkojmë së bashku të vërtetën duke krijuar marrëdhënie të tjera besimi me njeri-tjetrin. Liria ekziston në masën ku të gjithë janë të lirë. Nga përmbajtja e kujtimeve tona, mënyra se si ne kujtojmë dhe ajo që ne do të zgjedhim si ideal, e gjitha kjo do të ndikojë në zgjedhjen tonë se si do të bëhemi. Por, të kujtuarit nuk është i mjaftueshëm. Në sajë të kujtimeve ne do të njohim atë se çfarë duhet të bëjmë sot. E tashmja dhe e ardhmja duhet të bëhen misioni ynë i përbashkët. Dhe e ardhmja do të jetë e paqartë në qoftë se shoqëria nuk i futet rrugës së vështirë për një ripërtëritje intelektuale dhe morale.

Në këtë kontekst, botimi i këtyre kujtimeve të të mbijetuarve të Kampit të Tepelenës, me rastin e ditës europiane të përkujtimit të viktimave të stalinizmit dhe nazizmit e shpallur në Deklaratën e Parlamentit European më 23 Shtator 2008, le të jetë një thirrje jo vetëm për t'u përballur me të vërtetat e regjimit totalitar, por edhe një thirrje për një ripërtëritje shpirtërore të shoqërisë sonë. Një vlerësim i madh shkon për Autoritetin për Informimin për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, që me përkushtim serioz bëri të mundur mbledhjen e këtyre dëshmimeve dhe botimin e tyre.

Prof. Dr. Gjergj Sinani



Simon Mirakaj

“Kam lindur në një burg në Shkodër... pas dy javësh internuar në Berat”

“Të gjesh kënaqësi duke e parë tjetrin të vuajë, sidomos fëmijët! Njeriu, atëherë, fillon e dyshon tek këta njerëz që nuk kanë asgjë të përbashkët me njeriun, përveç emrit njeri.”

INTERVISTOI KRISTALE IVEZAJ RAMA

M

Mirëdita, zotëri. Le të fillojmë me dëshminë tuaj. Kush jeni ju dhe cili ishte shkaku i izolimit tuaj në kampet e posaçme nga regjimi komunist, menjëherë pas luftës?

Quhem Simon Mirakaj. Kam lindur në 7 qershor 1945. Kam lindur në një burg në Shkodër, sepse shumë shtëpi në Shkodër ishin kthyer në burgje: Të zotët e shtëpisë ose ua kishin pushkatuar dhe familjet ua kishin internuar, ose i kishin futur nëpër

burgje. Kjo tragjedi ka ndodhur ndër familjet më të mira të Shkodrës. Aty kam lindur unë, në një nga këto shtëpi. Thonë, tek një familje me emrin Vuksanaj, që e ka patur atëherë shtëpinë. Pas dy javësh na kanë internuar në Berat.

Domethënë, ju keni qenë i sapolindur, një foshnje vetëm dy javëshe?

Aq, dy javësh, dhe shkaku i shpërnguljes dhe izolimit tonë ishte qëndrimi antikomunist i familjes. Babai im, Pal Bib Mirakaj, kishte dy vëllezër. Vetë ishte më i vogli. Më i madhi i vëllezërve, Kol Biba, ka qenë ministër në kohën e Italisë, Ministër i Punëve të Brendshme. Axha tjetër, axha Pashuk, bashkë me babën dhe nipin e vet që kishte ardhur nga studimet - ishte në vitin e tretë të studimeve në Itali për inxhinier, -kanë dalë në mal, bashkë me të tjerë.

Tepelena ishte e mbushur me bomba lufte, kishte predha mbi tokë dhe nën të. Gratë vendosnin kazanet për të zier rrobat dhe fëmijët afroheshin te zjarri për t'u ngrohur. Ka patur shumë raste që kanë vdekur shumë fëmijë nga minat që ishin nën kazanin që vlonte.

Për cilën kohë bëhet fjalë?

Babai bashkë me ndjekësit e vet kanë qëndruar në mal nga viti 1944-1951, në malet e Pukës, në zonën e Mirditës, Tropojës.

Vëllai juaj na ka thënë se ka gjetur një ditar të babait tuaj, Pal Bib Miraka.

Po, ashtu është. Baba ka mbajtur një ditar gjatë kohës që ka qenë në mal. Atje iu vra i vëllai, më i madh se baba. Iu vra edhe nipi, 29 vjeç, i martuar dhe me dy fëmijë. Megjithatë, baba e vazhdoi qëndresën kundër komunistëve bashkë me ndjekësit e vet.

Çfarë ndodhi me të, si vijoi qëndresa?

Në 1951, meqë ishin shkëputur marrëdhëniet miqësore të shtetit tonë Jugosllavinë, ata shpresuan të ndonjë ndihmë antikomuniste në Jugosllavi, prandaj kaluan kufirin. Atje i futën në një kamp në Podujevë.

Pra, babai u arratis?

U arratis. Baba ishte në mal, për këtë arsye, neve na shpërngulën nga Shkodra dhe na izoluan në Berat. Në 1949, kur u prishën marrëdhëniet me Jugosllavinë, na dërguan në kampin e Turanit, ku vdiqën 30 fëmijë brenda 24 orësh. Turani, nëse e ke idenë e Tepelenës, është në një kodër përballë kampit, nga krahu i djathtë. Aty na futën nëpër staret e bagëtive. Nga mungesa e higjenës, e ushqimit dhe e strehës së përshtatshme vdiqën ata fëmijë.

A keni mësuar më pas si ia doli mamaja juaj t'ju ushqente juve, bebe, në ato kushte ku mungonte shumëçka?

Jo, nuk e di. Më tepër na ka ushqyer Zoti se sa mamaja. Se edhe mamaja nuk kishte me çfarë të na ushqente. Aty jepej vetëm 300-400 gramë bukë.

Si quhej, e ndjera nëna juaj ?

Nëna e ka pas emrin Kune. Katolikët kanë dy-tri emra. Kune dhe Sofie, por ne e njohim me emrin Kune. Na zbritën në Tepelenë dhe tragjedia vazhdoi. Pas vdekjes së Stalinit, u prish kampi i Tepelenës.

Sa vjeç ishit kur ju çuan në Tepelenë? Sa vëllezër e motra kishit?

Ne ishim dy vëllezër dhe një motër. Motra, Adelajde, ishte 9 vjeçe, pak më e madhe se ne. Ka dy vjet që ka ndërruar jetë. Asaj i ra barra më e madhe. Në moshën 14 vjeç atë e ndanë nga ne; kështu ndodhi edhe me vajza të tjera. I çuan në Tiranë, në Kamëz, në fabrikën e tullave, një punë tmerrësisht e rëndë për atë moshë, sidomos për vajzat.

Ende fëmijë. Çfarë pune bënte atje?

Punë fizike, prerje tullash. Nuk mund ta dish sa punë e rëndë ishte. Sot ka fabrika moderne tullash, por, atëherë, gatuanin baltën prej argjili për tullat, një punë e tmerrshme, shumë e rëndë. Pasi gatuhej balta, një kuti që kishte formën e tullave e ndarë në mes, mbushej me baltë. Hidhej pak rërë, qetë mos ngjitej në kuti, pasi i nxirrnin nga kutitë viheshin për tharrje dhe pas tharrjes për pjekje. Dhe përdorej për mur, e për të gjitha.

Ju, çfarë pune keni bërë?

Në Tepelenë ne ishim të vegjël. Megjithatë, të dielave, punonim me municionet luftarake të mbetura nga koha e luftës. Tepelena ishte e mbushur me bomba luftime, kishte predha mbi tokëdhe nën të. Më të rrezikshme ishin ato që ishin pak nën sipërfaqe, sepse shkaktonin tragjedi. Gratë vendosnin kazanet për të zjerë rrobat dhe fëmijët afroheshin te zjarri për t'u ngrohur. Ka patur shumë raste që kanë vdekur shumë fëmijë nga minat që ishin nën kazanin që vlonte. Bëheshin copë-copë. Neve na mernin për ato që ishin mbi sipërfaqe, i vendosnim stivë siç stivohen drutë.

Ku i stivonit bombat?

Brenda telave. Ndërsa vajzat dhe djemtë që kishin mbaruar klasën e shtatë, i çonin në punë, të shoqëruar me ushtarë me automatik. Mbartnin gurë në mal, mbartnin pleh për komandën. Për të ardhur në kamp duhet të kalonin një urë pasarelë, janë ato urat që tunden. Një grup vajzash, të lodhuradhe dëshpëruara, vendosën qëkur të mbërrinin tek ajo ura të hidheshin në lumë, t'i jepnin fund jetës. Deri këtu kishte mbërritur. Bashkë me to ishte edhe një në

moshë më të madhe. Ajo ishte italiane, me sa më kujtohet, e martuar me të birin e Mustafa Krujës. Të shoqin e kishte në burg dhe kishte ardhur në Tepelenë me gjithë djalin. Ajo ishte profesoreshë, kishte mbaruar në Bolonjë për letërsi, dhe u thotë këtyre vajzave: Në rast se do të hidheni, sigurisht që vetë do t'i jepni fund jetës, është zgjedhja juaj, por a e kuptoni se çfarë dhimbjeje u shkaktoni nënave tuaja? Atëherë, vajzat ndaluan, panë njëra-tjetrën dhe nuk u hodhën në lumë, por vijuan rrugën.

Kampi i Tepelenës krahasohet me Auschwitz-in. Nuk mund të imagjinohet nga askush. Edhe mua që kam jetuar vetë atje, sot, më duket sikur po tregoj ndonjë roman, ndonjë novelë. Aq e pabesueshme ishte sjellja shtazarake e atyre njerëzve: Të gjesh kënaqësi duke e parë tjetrin të vuajë, sidomos fëmijët. Njeriu, atëherë, fillon e dyshon tek këta njerëz që nuk kanë asgjë të përbashkët me njeriun, përveç emrit njeri.

Në 1954, pas vdekjes së Stalinit, na hoqën nga kampi i Tepelenës. U mbyll dhe na sollën në Lushnjë. Lushnja ishte një vend bujqësor.

Sa vjeç ishit ju?

Kam qënë 9 vjeç. Klasën e parë dhe klasën e dytë i bëra në Tepelenë. Ka qënë shumë e vështirë sepse rruga për të shkuar në shkollë ishte pak përperjetë, i ngjiteshim kodrës. Ne ishim pa ushqim, pa mëngjes.

Mund të na thoni pak për eksperiencën e shkollës, si ishte? A shkonin të gjithë fëmijët?

Të gjithë fëmijët që kishin mbushur 6 vjeç, fillonin klasën e parë.

Ishit të detyruar?

Jo, njoftohej nga Ministria e Brendshme, nëpërmjet komandës që kishim ne në kamp, komanda e policisë, që fëmijët që kanë mbushur moshën 6 vjeç, të dalin nga telat e të shkojnë në shkollë. Dhe shkuam u regjistruam në shkollë. Dikush kishte mbaruar klasën e dytë apo klasën e tretë. Dikush e fillonte nga e para siç e fillova unë. Në shkollë nuk kishim ndonjë diferencim me të tjerët. Edhe ata ishin fukarenj. Nuk na shihnin me ndonjë

sy. Ata ishin fëmijë njësoj si ne, ndërsa mësuesit po. Mësuesit e bënin diferencën. Unë kam patur një rast timin. Isha në klasën e parë. Po mbaronte ora e mësimit, më kap mësuesi: Ndaluj pak! Mendova tani se mos ka haber të mirë. Dhe më thotë: E e do babain? Unë babën as nuk e kisha parë, se kur lindi unë, ai ishte në mal. Dhe i them: E dua! Instinktivisht. Si e do? -tha. Merr vizoren dhe më qëllon me tehun e vizores.

Ishte mashkull apo femër?

Mashkull.

Si reaguat ju më pas?

Si fëmija që gjithmonë bën të kundërtën e asaj që i thonë. Ai vazhdoi të më qëllonte, unë vazhdova duke i thënë "e dua". Ai vazhdonte të më binte. Fillova të qaja. Mirëpo, pas derës ishte vëllai. Ai ishte në klasë të dytë. E filloi duke qarë edhe ai, sepse dëgjoi që unë po qaja. Ishte bashkë me motrën, ajo ishte nja 10 vjeç. Pas gjysmë ore më lëshoi mësuesi dhe bëmë të shkonim drejt kampit. Sa kaluam e morëm rrugën që ishte pak poshtë, mua më ra të fikët. Më morën në krah vëllai me motrën dhe kur shkova në kamp, aty pastaj erdha në vete.

Mund të përshkruani mësuesin? Si dukej?

Ka vite shumë, me ju thënë të drejtën. Ai ishte djalë i ri, nja 20 vjeç. Nuk e di, a kishte mbaruar shkollë apo nuk kishte mbaruar. Se në atë kohë të kishe 4 klasë shkollë, mjafton që të kishe partishmëri.

Çfarë ju mësonte?

Abetaren.

Edhe për partinë?

Jo, nuk më kujtohet. Ndoshta klasat e treta e të katërta, mund të kishin ndonjë vjershë për partinë. Sigurisht, ata, mësuesit bënin edhe punën e propagandës së partisë.

Po më tej, a kishit frikë nga mësuesi? Si u ndërtua në ndërgjegjen tuaj figura e mësuesit, sepse dihet, ajo është një busullë shumë e

rëndësishme në jetën e çdo fëmije?

Sigurisht që kur e shihja, e shihja me frikë se mos po vazhdon e njëjta histori, por nuk ndodhi më. Vetëm atë ditë. Merre me mend, tani, se sa shumë është ngulitur ajo sjellja e tij, që edhe pas 60 vjetësh, atë e kujtoj.

Sic thashë në 1954, na hoqën nga Tepelena. Na dërguan në Lushnje. Lushnja ishte vënd bujqësor, kishte kënetë, duhej tharë, dhe këtë punë më shumë se mund ta bënin të internuarit nuk mund ta bënte kush: hapje kanalesh, punë të ndryshme.

Sa vjeç ishit?

Unë isha 9 vjeç, por nuk punoja. Vazhdova shkollën, sapo kisha hyrë në klasë të tretë. Vazhduam shkollën në Savër. Savra ishte kampi ku ne u stabilizuar për herë të parë. Shumë nga të internuarit që erdhën nga Tepelena, u shpërndanë nëpër kampe. Ne në Savër, një pjesë tjetër në Plug, i shpërndanë sipas nevojës për punë. Por tashmë kishte ndryshuar, punoje, sigurisht punë të rëndë, por shpërbleheshe për atë punë.

Sa vjeç ishit kur punuat për herë të parë?

Për herë të parë kam punuar në moshën 20 vjeç. Sapo mbarova gjimnazin. Kur mbarova 7-vjeçaren na u dha mundësia të vazhdonim gjimnazin. Gjithmonë paraqiteshim në mëngjes para policisë, dhe gjatë këtij intervali kohe, mëngjesit dhe darkës, paraqiteshim përsëri në apel para policisë. Na dhanë mundësi për të vazhduar shkollën. Kështu që, ajo lufta e klasave nuk ishte ashpërsuar shumë. Në këtë periudhë ishim të lidhur me rusët dhe kishte një farë liberalizmi. Mund të quhen si ditët më të suksesshmet tonat, në krahasim me vitet e më vonshme, sepse na u dha mundësia për të mbaruar shkollën e mesme.

Në atë kohë pati edhe përkthime nga shkrimtarë të ndryshëm klasikë, qoftë rusë, qoftë anglezë, amerikanë. Gjatë shkollës merreshim edhe me lexime, edhe pas shkollës pasi mbaruam gjimnazin. Çdo e keqe e ka një të mirë, qoftë në burg e qoftë në kamp, ka patur njerëz të mëdhenj që na mbanin afër dhe na ushqenin me dashuri për dijen, për të lexuar, sepse është ushqimi më i mirë për të përmballuar vuajtjen.

Isha në klasën e parë...

Ai (mësuesi) vazhdoi të më qëllojë, unë vazhdova duke i thënë “e dua” (babain).

Ai vazhdonte të më binte.

Fillova të qaja. Mirëpo, pas derës ishte vëllai. Ai ishte në klasë të dytë. E filloi duke qarë edhe ai, sepse dëgjoji që unë po qaja...

Sa kaluam e morëm rrugën që ishte pak poshtë, mua më ra të fikët.

Ku i gjenit rrobat?

Po, siç thashë lufta e klasave nuk ishte ashpërsuar. Ne na vinin teshat nga babai. Babai iku në 1960, iku nga Italia dhe shkoi në Amerikë. Në këtë periudhë na dërgonte nga një pako.

Nga e merrete informacionin babai juaj se ku gjendeshit ju? Si kalonin pakot?

Ne dërgonim letra.

Nga e mësuat adresën e babait tuaj?

Shiko, nëpërmjet letrave. I pari që na solli letra dhe fotografi nga Podujeva ishte babai. Më pas, në bazë të asaj adrese, i kthyem edhe ne përgjigje dhe i dërguam edhe ne fotografitë tona. Pastaj përsëri na shkroi letër që ishte nisur nga Podujeva. Iu dha mundësia për të shkuar në Itali. Në Itali kishte vëllain, Kolën, Kol Mirakaj. U bashkua me vëllain dhe pastaj në 1960, se nuk qëndroi në Itali, pra, në 1960 u nis për në Amerikë në New York. Babai shkruante me makinë dhe nuk shkruante me emrin e tij, shkruante me emrin e një gruaje. Me emrin Dalina. Mirëpo vinte gjithmonë firmën e tij. Kështu që merreshim vesh shumë rrallë. Një herë në vit mund të na vinte letër. Edhe nuk e jepnin letrën, edhe letrat që i dërgonte ai nuk na i jepnin. Kështu që...

Për çfarë shkruanit?

Shkruante 3-4 rreshta sa për të kuptuar ne që ishte gjallë. Kur i dërgonim ne fotografi, thoshte "i mora". Madje, kur vëllai është martuar i ri, 21 vjeç, se atje martoheshë i ri me budallallëkun e të riut, pra, u martua i ri, dhe i shkruajtëm letër babës, e shoqja Vali është shtatzënë. Atëherë nuk kishte aparate që ta dije që më parë a do ishte djalë a vajzë? Na dërgon 3-4 rreshta dhe thotë: në rast se lind djalë, do t'i vini emrin, nëse është e mundur Filip, Rrok ose Leon. Shkon Sokoli në gjendjen civile, dhe nuk i pranojnë asnjë nga këta emra.

Përse?

Sepse i kishin vetë emrat. I kishin vetë emrat dhe do i vije një emër që kishin aty. Dhe aty për fat ishte emri Luan. Leon – Luan, kështu e regjistroi Luan. Por ne e thirrëm Leon, për hatër të babës.

Edhe sot i flasim Leon. Në 1966 u ndërprenë letërkëmbimet.

Mbani mend ndonjë rresht nga letrat?

Po mbaj mend. I dërguam një fotografi të Vilmës. Vilma ishte 3 vjeçe, edhe i kishte ngritur duart nga qielli dhe ai na thotë **"u kënaqa me fotografinë. Duart e Vilmës më dukej sikur po i lutej Zotit"**. Se i kishte ngritur lart.

Po fotografitë ku i bënit, se ju ishit në internim, në fshat? Apo vinin fotografë nga qyteti?

Po, po. Vinin nga qyteti. Savra me qytetin ishte 4 km. Ishin privatë. Vinin shpesh, se Savra ishte me familje që kishin dëshirë për të patur kujtime, qoftë nga puna qoftë nga jeta. Bënin shpesh. Sa herë që vinin, pothuaj të gjithë i shihje duke u ndërruar, duke u pastruar, dhe këto foto ua dërgonin edhe familjeve që i kishin jashtë ose brenda.

Na kishte dërguar babai një fotografi me nja 4-5 veta të tjerë. Mirëpo babai ishte pa flokë, si puna ime. Ata të tjerët ishin të gjithë me flokë, dhe unë i them nënës, si e paske marrë këtë qeros? Dhe ne i shkruanim letër dhe i thotë, kështu, kështu. E pa fotografinë Simoni, - i thotë, -dhe thotë që, si e ke marrë këtë qeros pa flokë. Dhe thotë: Kur e lexova letrën, atë të Simonit, kam qesh me lotë.

A njihnit, personalisht, ndonjë fotograf të asaj kohe?

Nuk e di a janë gjallë apo jo. Besoj kanë vdekur, se në atë kohë kanë qënë. Një mbaj mend, emrin e asaj gruas që vinte na bënte fotografi. Ishte fotografe e qytetit. Quhej Fajka. Nga fotografet e para të qytetit të Lushnjës. Burrë e grua fotografë.

Kur u bëtë 20 vjeç dhe filluat punë për herë të parë, çfarë lloj pune keni kryer?

Ka qënë shumë e dhimbshme puna, dita e parë. Pasi bëra apelin, dita e parë, fillonte apeli tjetër për të marrë planin e punës se ku do punoje. Këta quheshin brigadierë. Edhe shkoj tek brigadieri dhe i them, jam filani, i paraqes dokumentet. Me thotë, do punosh në kanal, nuk ka punë tjetër. Po, ku është ky kanali? Kanali ishte buzë rrugës. Mirëpo, mendo, një djalë 19 vjeç... ajo që të bënte përshtypje ishte

jo puna, por problemi ishte se, thojta, do të kalojnë shokët dhe shoqet e klasës dhe do të më shohin mua duke punuar aty. Kanali ku shkova unë, i shihja të gjithë punëtorët, kanali ishte i thellë 3-4 metra. Me çizme, se kishte edhe ujë. Nuk ia kisha idenë e punës. Duhej pastruar, të hidhja dheun lart. Megjithatë, ishte një punëtor, që ishte afër. Ishte më i madh, kishte eksperiencën e punës dhe vjen më thotë se si duhej të punoja. Atje përdoreshin kapellet e kashtës mos të të kapte dielli. I bënim vetë. Na i kishte bërë motra nga një kapele.

Kishit vegla?

Po, lopata. Kapelën në kokë e kisha vënë të maskohesha, se sa për diellin...Pastaj filluam duke u bërë edhe ne profesionistë, si të punosh çdo ditë.

Si i kishte oraret e punës?

Orari, në orën 7 fillonte puna. Verës nuk kishte orar deri në orën 8. Por ne kishim orarin e policisë, kështu që përfitonim nga ky rast. Shkëputeshim. Kishte raste që punonim 7 deri në 9, sipas punës. Ne ishim të detyruar të linim punën.

A kishte ndonjë roje që ju rrinte mbi kokë?

Roje mbi kokë jo, të deklaruar, jo. Por të gjithë ishin, ishin të pa deklaruar. Ne ruheshim nga të gjithë. Për drekë kishim bukë, verës zarzavate, domate, kastraveca, pak djathë. Dimrit ndonjë kavanoz groshë, pak kos.

Si ishte puna gjatë dimrit në Savër?

Dimri ishte dimër i vështirë. Borë nuk binte, shi, erë. Edhe në shi ishim të detyruar të punonim. Nëse nuk punoje një ditë, ishte mungesë nga të ardhurat. Ishim të detyruar të prisnim që të pushonte shiu, që të merrnim ditën e punës.

Sa ishte kuota e punës, sa ishte norma?

Punët ishin të ndryshme. Për shembull kishte prashitje, hapje kanalesh, kishte vaditje misri, jo të gjitha kishin të njëjtën pagesë dhe normë. P.sh. për të hapur kanal duhet të shkundeshin brinjët mirë, ishte 14 metër kub norma. Ishte jashtëzakonisht e vështirë, por ishe i detyruar, sepse nëse nuk e bëje normën, të ardhurat ishin më pak.

Edhe në shi ishim të detyruar të punonim. Nëse nuk punoje një ditë, ishte mungesë. Ishim të detyruar të prisnim që të pushonte shiu, që të merrnim ditën e punës.

A ishit në gjendje ta përballonit fizikisht punën?

Duhej kohë që të merrje veten. Megjithatë kishte një të mirë, e përballuam me moshën e rinisë. E përballuam, sepse shihnim njerëz të moshuar, që tërhiqeshin zvarrë. Megjithatë, ne mundoheshim t'i ndihmonim, por duhej të bënim normën tonë. I ndihmonim kur i kishim afër.

Sa vjet punuat?

Nga viti 1965 deri në vitin 1990, 25 vjet në lopatë. Por vitet më të rënda kanë qënë në 1969.

Na hoqën nga Savra. Na dërguan në një sektor 20 km larg Lushnjës. Aty na izoluan. Nuk na lanë të lëviznim, vetëm brenda hektarëve të tokës së caktuar. Madje, kur Sigurimi i Shtetit erdhi të na prezantonte tek paria e Sektorit, na futën në një sallë dhe ai që na bënte apelin i thotë shëfit operativ që kishte ardhur nga dega e Lushnjës: Deri ku kanë të drejtë këta që të lëvizin? Dhe ai i thotë shprehimisht, që këta kanë të drejtë të lëvizin 700 hektarë tokë. Po kaluan kufirin, plumbin ballit! Kanë qenë vite të tmerrshme. Aty na shkante 3 herë në ditë apel. Po të vinte një delegacion i huaj në Tiranë, nga Kamboxhia mbaj mend, edhe ne na bënin apel 3 herë në ditë atje. Ose, po të kalonte Enver Hoxha që shkante në Vlorë, kur vinin festat e nëntorit, viti i ri, 1 maji etj, apel 3 herë në ditë.

Unë kam qenë i apasionuar pas futbollit dhe në moshën e rinisë kam luajtur. Të paktën kështu thonë të tjerët që më kanë parë. Dhe kur ishim në Savër shkonim shihnim "Traktorin", kështu quhej ekipi i Lushnjës. Mirëpo, kur na hoqën nga Lushnja, aty u izoluam dhe s'kishte më. 15 vjet pa parë sport.

Kishte ardhur operativi. Bëmë apelin e mëngjesit dhe i them vëllait, po shkoj t'i kërkoj leje, meqë kishte ardhur Shkodra për të luajtur me Lushnjën. Dhe unë isha tifoz me Shkodrën dhe me Lushnjën. Më thotë vëllai, mos shko, se nuk ka për të dhënë leje. Unë do shkoj, i thashë, se i humbur jam, do shkoj ta provoj. Edhe nisem. Ai e pa që unë po drejtohem drejt atij dhe u ndal. Kur mbërrita aty, e përshëndeta, – zotni kapiten. – Nuk jam Zotni, jam shok. I them, - je shok, por nuk je shoku im. Dhe këtu fillonte provokimi. Se

po t'i thoja, që je shoku im, pastaj kishte punë të tjera.

–Pse ke ardhur? –më tha, por në mënyrë shtazarake, me përbuzje. –Kam ardhur për të kërkuar leje, për të shkuar në Lushnje për të parë sport. – Kush luan?– tha. –Po, ka ardhur Vllaznia dhe do luajë në Lushnjë. – Pse me kë je tifoz ti? – Unë - i thashë- jam tifoz me Lushnjën ngaqë jetoj ne Lushnje, por jam tifoz edhe me Vllazninë, ngaqë jam prej veriut. – Pse nuk je me Dinamon? Dinamo ishte skuadra e Ministrisë së Brendshme. I them që me Dinamon nuk jam dhe nuk kam për të qenë ndonjëherë. – Atëherë, as nuk ke për të shkuar ndonjëherë për të parë sport! Edhe kthehem, shkoj në shtëpi. Ne, në të tilla rastesh duhet të tregoheshim të vendosur, sepse po të ishte pak i lëkundur, i hapje punë vetes.

Nuk futeshit në burg nëse ju flisnit ashtu?

Duhet të merrje shumë gjëra parasysh. Por ishte e nevojshme t'ju tregoje nganjëherë se kush jemi. Ti ke shumë gjëra në dorë, por atë kryesoren e kam unë. Ti ke në dorë të më futësh në burg, të më japësh punë të rëndë, por të më bësh veglën tënde nuk e ke në dorë ti.

A keni patur momente të tilla përplasjeje kur jeni ndjerë krenar për veten, në lidhje edhe me këto që thoni?

Më krenar për veten jam ndjerë kur më thirrën për t'u bërë spiun. Ishte luftë e tmerrshme. Ishim duke punuar, kur shohim afër, po vjen operativi dhe ai që na bënte apelin. Binte pak shi, i hollë. Ishim nja 5-6 veta, punonim bashkë. Dhe vjen ai që na bënte apelin, dhe thotë, – Simon, hajde pak. Sigurisht që do shkoje patjetër. Ata u shtangën, edhe unë. Mendova që tani më arrestuan. Më thotë, -do marrësh preventivin. Ne punonim në një periudhë duke ndërtuar një kinema. Unë nuk kisha punuar kurrë në ndërtim, por për të ndryshuar punën e bujqësisë u futa edhe unë.

Do marrësh preventivin, më tha, dhe do e dërgosh në drejtori. I thashë, unë preventivin?! Unë nuk jam as brigadier! Isha 26 vjeç. Dhe më thotë që ty të kanë kërkuar. Isha me çizme. Shkoj në shtëpi për t'u pastruar. Vjen Sokoli i shqetësuar. Të gjithë u shqetësuan. I them vëllait, 99.9%

Ti ke në dorë të më futësh në burg, të më japësh punë të rëndë, por të më bësh veglën tënde nuk e ke në dorë ti.

janë duke më arrestuar. Por pas meje mund të arrestojnë edhe dikë tjetër nga shokët tanë. Dhe do thonë, kështu-kështu ka thënë Simoni. Simonin vetëm kur ta varin në litar se nuk e hap gojën. Prandaj, mos të bien pre e lojërave dhe intrigave të këtyre. T'ia thuash atyre shokëve, nëse do kenë fatin e keq. Dhe nisem. Kisha një biçikletë që e përdornim brenda fermës, brenda sektorit. Marr biçikletën dhe nisem në Lushnje.

Kur mbërrij afër qytetit, dëgjoj një zë që më thërret, o Moni, o Moni? Kur kthej kokën unë, shoh operativin. Një herë, bëra sikur nuk e dëgjova. Ai atëherë e ndryshoi, jo Moni, por "o Simon". Kur thirri "o Simon", ndala. Hë, tha, ku po shkon? Thashë, po shkoj të dorëztoj preventivin. – Po pse, ti kështu, i pa rruar? – tha. I thashë: Nuk po shkoj për në paradë, po shkoj për punë dhe nuk e kam vënë re jam i rruar apo i pa rruar. -Na, tha, ndize një cigare. – Jo, i them, faleminderit, nuk e pi. Mirë, tha, nisu atëherë, shko çoje. Vazhdo va rrugën unë. Ky, mesa duket, kishte hipur në një makinë. Kur po eci unë, këtu tani, ishte rruga për t'u kthyer për tek dega. Dhe ky ishte mu këtu. Ndërsa rruga për të çuar preventivin, vazhdonte drejt. Kur mbërrita këtu, më thotë, ndalo,

lëre biçikletën në trotuar dhe hajde pas meje. – Biçikletën nuk mund ta lë, se e kam blerë me lekë, nuk mund ta lë në rrugë. – Lëre aty– tha, – e ruajmë ne. – Po kam edhe preventivin - i thashë. – Lëre aty! Kur më tha "ec!", në atë rrugë 50 metra që ishte për te Dega e Punëve të Brendshme po mendoja, tani vetëm kur të dali ndonjë e të më venë hekurat.

Kur iu afruam Degës, kthehet dhe më thotë: Ec pas meje. Çfarë po ndodh? Megjithatë, gjithë rrugës i lutesha Zotit, që të më japi forcë, mos të koritem, mos të fëlliqem. Duke ecur pas tij, kur, më fut në hotel. Ishte hoteli më i mirë i Lushnjës, quhej hotel "Myzeqeja". Këta kamerierët, përgjegjësit e hotelit ishin të gjithë spiunë. E pashë që ky ia bëri me sy atij të sportelit. Unë pas tij. Në katin e dytë, në fund të korridorit, një dhomë. Hap atë dhomën dhe ishte një tavolinë, dy karrige dhe një minder. -Ti do rrish këtu, tha. E mbylli derën dhe tha se do vinte me një shok pas pak. Tani, unë nuk e dija se çfarë do ndodhte me mua. Nuk e kisha idenë. Diçka e keqe po, por seç çfarë. U ula tek ai minderit përballë tavolinës dhe llogaritja distancën e kokës me murin. E mata, ishte një pëllëmbë distanca nga koka tek muri. Mendova,

**Ti je bir i një
krimineli, edhe ti,
si ai je, dhe ma
futi një shqelm në
kockë të këmbës.**

**Më lëshuan
sytë xixa.**

**...kafshova gjuhën
se nuk doja t'u
jepja kënaqësi.**

në rast se do më torturojnë, dhe nuk do jem në gjendje ta përballoj, t'i jap fund jetës. Kjo zgjati një orë. Kur futet çelësi, hapet dera dhe hyn kryetari me gjithë operativin e degës. Ngrihem në këmbë. Më zgjasin dorën. Dhe ulemi. Filluan komplimentet, sepse kështu e nisinin. Unë jam filani, jam kryetari i degës, kam marrë informacion nga operativi që je djalë i zgjuar, je djalë i hijshëm. Gjynah që ti të rrih në internim dhe të kalbesh... Duke qënë se ti je i biri i Pal Bibës, njerëzit kanë besim tek ti, mund të flasin. Është një shans, është një privilegj që të japim ty. Mund të të çojmë në Tiranë të vazhdoesh edhe universitetin. Kemi dëgjuar që luan mirë edhe futboll, mund të të futim me Dinamon. Të krijosh familje. Dhe nuk do kesh punë me njeri, do kesh lidhje direkt me mua si kryetar i degës. Ky është shansi! Kjo varet nga dora jote. Duhet ta shfrytëzosh këtë moment. Unë i them: Faleminderit shumë për privilegjin, por, qoftë unë, qoftë kolegët e mi, nuk na del koha të merremi me politikë, sepse kemi një punë aq të rëndë sa nuk na bie në mend të merremi. Atëherë, ndryshoi. Nga komplimente, u kthye në ulërima, britma.

Çfarë ju thanë?

Ti je bir i një kriminelit, edhe ti, si ai je, dhe ma futi një shqelm në kockë të këmbës. Më lëshuan sytë xixa. Mirëpo, kafshova gjuhën se nuk doja t'ju jepja kënaqësi. Pastaj fillova me bërtima, jo nga dhimbja, por drejt atij.

E guximshme, kjo. Si mundët ta bënit? A nuk patët frikë?

Unë i thashë, jam fajtor aq sa është ai djali yt, që është duke luajtur me shokët e vet dhe nuk e di se çfarë po bën babai i vet. Madje, djali yt ka më shumë faj, nëse do t'i hymë, sepse në darkë merr përkëdheljet e babës, ndërsa unë nuk e kam parë babën dhe as nuk më ka parë. Atëherë, i bëri efekt kjo thënia ime, por, para se t'i thoja këtë punën e të birit, i them: – Unë ja ku jam, këtu, bëni ç'të doni me mua. Unë, spiuni juaj nuk bëhem. Ka marrë fund ajo punë. Ja, ku më keni, më bëni çfarë të doni. Dhe atëherë, i thashë punën e djalit. Atëherë u tërhoq pak. Mirëpo, gjatë debateve që zgjatën nja 5 orë, më shumë bërtita unë, aq sa më thoshte, ule zërin. Me thënë të drejtën, kur je në të drejtën tënde, të jep edhe zoti forcën, të duken si miza. Pavarësisht se unë e kisha sfiduar vdekjen

dhe nuk më bënte përshtypje as vdekja, absolutisht, për asnjë moment nuk ka qenë dilemë, a po me dhimbset vetja apo nuk po më dhimbset.

Atëherë, pas 5-6 orësh, më thotë: Dëgjo këtu, këto muhabete që bëmë këtu, nuk do ia thuash askujt. Po i the dikujt, ne kemi njerëz që na i dinë të gjitha dhe nuk do të sjellim makinën të të arrestojmë, por do të vish vetë këtu t'i vësh hekurat. Dhe do të dënojmë me kostumin e prerë 25 vjet, dhe nuk ke për të dalë më gjallë. Ti e di mirë, që ne i dënojmë dhe ridënojmë brenda në burg. Dhe i them: Nuk kam ç't'u them, se nuk është ndonjë gjë e bukur për t'u treguar. Atëherë, ngrihu dhe je i lirë të ikësh.

Pas atij presioni psikologjik, a mund të ktheheshit lirisht në shtëpi?

Dola, shkova mora biçikletën, kishin lenë dikë që ta ruante. Pasi nisem për në kamp, tek kryqëzimi ku ndahet rruga për Berat, ndërtohej fabrika e letrës në Lushnje, kur shoh Kurt Kolën që po suvatonte. Dhe i thërras, o Kurt, zbriti nga skela Kurti dhe vjen. Anës rrugës pambuku i mbjellë ishte i lartë. E mbështes biçikletën dhe futem në pambuk dhe i tregoj Kurtit gjithë historinë. Kurti ishte njeri që kishim besim tek njëri-tjetri, shumë. Dhe unë kisha nevojë të çfryja pak. Kurti ishte i sigurt për këtë punë. Ndejtëm 1 orë apo 2 dhe u nisa duke falënderuar Zotin. Ajo ndjenja e krenarisë, që thatë ju, ishte duke falënderuar origjinën time, kam mbajtur shumë. Sepse ne, u mbajtëm në internim tashmë jo për babën. Tashmë u mbajtëm në internim për qëndrimin tonë.

Jemi liruar me 4 korrik të 1989. Filluar në 1945 deri në 4 korrik të 1989. 44 vjet. Për ta thënë thuhet me një gojë, por se sa peripeci ka brenda vetëm shpirti jonë e di.

Na kanë treguar një histori tuajën lidhur me detin të cilin e keni parë shumë vonë. Si jeni ndjerë?

Detin, e kam parë në vitin 1990. Në gjimnaz e kisha parë në hartë, në orën e gjeografisë. Gjithë ai bregdet dhe thoja brenda vetes, a do vijë ndonjëherë dita ta shoh, ta prek? Nuk e kisha idenë. Laheshim nëpër kanale. Kur u lirova, udhëtimi i parë ka qënë për në Durrës.

Të nesërmen. I hipa autobusit deri në Lushnje, pastaj preva biletën dhe u nisa për në Durrës. Kur i afrohem Shkozetit, diku, kthej kokën, se gjithë kohën po prisja kur po e shoh detin. Kur mbërrij në Shkozet, dukej deti. Zbres. Nuk ia kisha idenë as rrugëve asgjë. Zbres nga treni duke pyetur, rrugë pa rrugë, mbërrij në plazh. Kur shoh femrat me rroba banje... i shihja me ndrojtje, fshehurazi. Unë isha me pantallona. Eci dhe shkoj buzë detit dhe ulem.

Mbani mend çfarë dite ishte? Kishte diell?

Jooo, diell, diell. Ishte ditë plazhi. Korrik ka qënë. Ulem aty, m'u morën pak mendtë. U shtriva në rërë, duke parë qiellin. Më dukej që po shihja detin edhe lart. U ngrita, preka pak ujin, laga fytyrën.

Sa vjeç ishit?

40-42 vjeç. Ndejta edhe 1 orë duke e soditur. U nisa për në Durrës, udhëtova në këmbë nja 4 a 5 km se nuk ia kisha idenë. Duke pyetur. Mbërrita tek stacioni i trenit, dhe u nisa për Lushnje. Pastaj u nisa për Gjazë, kështu quhej sektori ku kemi jetuar, Gjazë. Kjo është historia e trishtë. Mirëpo, kur je në pafajësinë tënde... Sot është kollaj të flasësh, por atëherë, ka qenë shumë e vështirë. Ka qenë ndihma e Zotit dhe origjina e familjes!

Duhet të dini një gjë. Ne kemi qenë nga të rinjtë më të hijshëm. Dhe duhet të sakrifikoje shumë. Po them, më të hijshmit, jo vetëm unë, por të të gjithë kampit. Binim në sy. Ishim rracë, njëri më i mirë se tjetri. Duhet të sakrifikoje rininë tënde, sepse me anën e vajzave kishin rënë shumë viktime.

Ka pas raste përdhunimi?

Jo, nuk ka pas. Raste përdhunimi nuk ka pas, absolutisht asnjë. Të paktën në momentin që unë kam filluar të kuptoj. Në Tepelenë nuk e di se çfarë ka ndodhur, sepse kam qenë i vogël. Flitet që komandanti i kampit ... por nuk kam dëgjuar nga nëna, motra. Ndoshta si malësorë i kanë mbuluar këto muhabetë... Më pastaj, jo, nuk ka ndodhur.

Ku shkonin njerëzit pasi lroheshin nga kampi? Kishit para?

Shumicën e rasteve kur lroheshin rrinin në kamp.

Gjendja e jetesës?

Jetonin nëpër shtëpira me tullë. Sigurisht ngushtë, por ishin më mirë se sa të shkoje në fshat, sepse fshati ishte kooperativë, ishin më mirë aty. Për këtë arsye, lroheshin por rrinin aty.

Sa vetëbanonin në një shtëpi të vogël?

Ne ishim: vëllai, e shoqja dhe 3 fëmijët, unë dhe nëna. 7 vetë në dy dhoma. Dhomat ishin 3 x 3m.

A i kishit disa sende të nevojshme për jetesën, një furrë, një banjo?

Kishim një sobë me dru dhe me dru ngroheshim. Për t'u larë... me kanoçe.

Kishit banjo të veçanta apo të përbashkëta me të tjera familje?

Kishim një tualet brenda në shtëpi, aty laheshim. Do u tregoj një të bukur, është pak banale, por do ua tregoj. Mua, më kishte marrë flokët kumbara, nun i thonë. Ky ishte i internuar me ne që në Tepelenë dhe nisët të arratiset. E kapën dhe bëri 23 vjet burg në Burrel.

Si quhej?

Musa Sina. Ka vdekur, i shkreti. Kishte një vëlla, Beqir Sina, gazetar në New York. I kishte thënë nënës që të m'i priste flokët. Atëherë, nënës i kishte ardhur keq. Ishte burrë simpatik, me mustaqe të holla. I vëllai nga Amerika, i kishte dërguar një kostum. Kur doli nga burgu i dërgoi një pako. I vishte ato. Shumicën e kohës ishte pa punë, se ishte i sëmurë. Tualetet kishin një gropë jashtë. Dhe vinte dikush me lopatë pastronte gropën e zezë, i mblidhte në një qerre dhe i hiqte tutje. Paguhej mirë për atë kohë. Këtë punë e bënte një plak. Një ditë prej ditësh, plaku vdes. Dhe vendos ta bëjë Musai këtë punë. Pasi bëmë apelin në darkë, shkoi në zyrën e këshillit. Aty ishte sekretari i partisë, kryetari i frontit, përgjegjësi i sektorit. I bie derës ky. -Hë, Musë, pse ke ardhur? I thotë, -kam marrë vesh që ka vdekur Vladimiri, se kështu e kishte emrin plaku që pastronte gropat e tualeteve. Kam ardhur të më jepni punë t'i pastroj unë ato. -Mirë të ka shkuar mëndja, por ti nuk ke triska fronti. Kjo ishte një copë letër që tregon-

te që ke biografi të mirë. Po pse? – thotë i gjori Musa– edhe për të ngrënë m.. duhen triska fronti?! Dhe...nuk ia dhanë punën. Sepse nuk kishte biografinë e mirë!

Deri te gropa e zezë? E pabesueshme. Çfarë bëtë ju kur erdhi demokracia?

Në vitin 1991 kemi ardhur në Tiranë. Kushërira e kunatës së Sokolit, lëshoi një dhomë, një hapësirë dhe erdhëm në Tiranë. Aty kemi ndenjur 3-4 vjet. Unë në 1991 ika në Itali me anije. Nuk e kisha në mend të ikja, por vjen një mik i familjes, ai kishte mbaruar universitetin, dhe e shoqja e nxiste për të ikur. Kishte ardhur në shtëpi për të na uruar mirëseardhjen dhe lindi ky muhabeti dhe më thotë, po iki në Durrës me anije, a po vjen edhe ti? Ta merr mendja tani, në këtë moshë për të bërë aventura, e me ik? Jo, po unë nuk iki dot vetë. Epo meqë do të të shoqëroj, po vij. Ky e kishte babain doktor. Kishte telefon në shtëpi, se atëherë jo të gjithë kishin telefona nëpër shtëpira. I them, shkojmë tek shtëpia jote, interesohemi, se mos hamë ndonjë plumb kot. Merr në telefon në Durrës dhe i thotë që kalohet lirshëm. Gjuajnë vërtet, por gjuajnë lart. Dhe përqafohem me Sokolin, i hipim trenit dhe nisemi. Shkojmë në Durrës, njerëz si miza në anije, "Panameze", kështu quhej. Nuk kishe ku të hidhje kokrrën e mollës. Ne hipëm të mërkurën, anija u tërhoq ca nga pesha e njerëzve por edhe me çimento ishte ngarkuar. Në mëngjes jemi nisur. Mbërritëm në darkë në Brindisi.

Sa zgjati udhëtimi?

1 ditë e gjysmë. Kemi ndenjur në Brindisi jashtë. Pa larë, një tmerr i vërtetë. Na sollën ca mushama për t'u mbështjellë natën. Ca si qese, por kishte shumë njerëz. Shumë e vështirë. Kaloi edhe ajo. Na futën nëpër shkolla. Nja 2-3 javë në Brindisi.

A ju dhanë status refugjati?

Akoma. Pastaj na shpërndanë nëpër kampe, na morën në intervista. Unë fitova statusin e refugjatit politik, por nuk vlente. Nuk pata ndonjë ... në Itali kjo, sepse në Gjermani më kanë trajtuar më mirë. Por dhe në Itali kam kaluar mirë. Ata të studiojnë, të

shohin që je serioz. Më lutën të rrija, në Udine, por i them që unë nuk njoh vendin tim, jo të njoh Italinë para vendit tim. Kam ardhur rastësisht.

Sa kohë qëndruat në Itali? A punuat gjëkund?

Dy vjet. Kam punuar në Karitas, u gjeja punë shqiptarëve. Pastaj u ktheva, nuk mund të njihja Italinë, dhe nuk e di si e morën vesh, erdhën gazetarë nga Holanda, madje, m'u lutën të shkoja në Hollandë. U bëri përshtypje shumë. Si ka mundësi që një njeri të jetë i dënuar 44 vjet? Të sistemojmë me punë, me shtëpi me të gjitha...

Të kishte marrë malli për familjen, për nënën. A ishte nëna gjallë?

Jo, nëna vdiq në kamp. Ajo, u nda me të shoqin 23 vjeç, me tri fëmijë. Me peripecitë e saj. U sëmur nga zemra. Dhe në 1974 vdiq, ishte 54 vjeç.

U martuat kur u kthyet në Shqipëri?

Jo, u martova kur isha në Tiranë. Vëllai kishte marrë grua myslimane. Dhe unë kisha qejf të dilja të shëtisja. Në atë rrugëtim vetëm i lutesha Zotit që, nëse e ke vendos të martohem, kur të shkoj në shtëpi të më japësh kënaqësinë nga gruaja, dhe kënaqësinë edhe kur të iki në punë. Mundësisht një grua katolike. Dhe deshi Zoti, gruan e gjeta katolike, një grua të mirë. Kam kënaqësinë, siç thashë.

A mund të na tregoni ndonjë episod nga ky çast kaq i shumëpritur në jetën tuaj?

Edhe ajo ka një histori të bukur. Një mikeshë më thotë se njihje një vajzë le e rritur në Tiranë, por me origjinë nga Puka. Kjo më shtyu kureshtjen ta njihja. Jo vetëm nga Puka, por edhe nga Iballa. Mirëpo, ne kemi një gjë, që mos jemi brenda fisit. Edhe interesohem. Pavarësisht se jemi brenda një fshati, nuk ishim fis. Pas disa takimeve, ajo goditja e parë ishte pamja. Ishte e pashme! Pastaj njeriu fillon duke u njohur, bisedon...

Faleminderit shumë, për intervistën, zoti Simon. Jetë të gjatë!



Gjelë Gjikota

“Shqipëria është e vogël për të parë, po edhe për të qarë sytë!”

INTERVISTOI: MIRA TUCI

K

Kam tash 40 vjet që kurohem në spitalin e Rrëshenit për azmën. Nuk kam shkuar as në Tiranë, as në Shkodër, as në Burrel. Vetëm në qytetin tim të Rrëshenit. Këtu më kanë mbajtur doktorët. Vendi këtu i kanë pas thënë Mirdita. “Mirëdita!”, tash thotë tërë Shqipëria. Mirditasit kanë qenë bujq punëtorë. Unë jam martuar në Kurbnesh, tek Gjirkolajt. Në vitin 1948, e kisha burrin tim shitës me dyqan, që furnizonte 5 katunde me mallra. Nuk kishte xhade, vetëm shtigje për kafshë. Burri im e kish këtë punë që në kohë të Zogut, kur erdhi Italia e më pastaj Gjermania. Kam qënë fare fëmijë, kur jam fejuar, shumë e singertë, për kurorën. E kishim dhënë besën, 13 vjeç kam qënë kur jam

fejuar. Burri im ishte rehat me dyqane e me punë.

Isha 13 vjeçe, po mbaj mend emra si Qazim Mulleti, Abaz Kupi, Menajt, Mirakaj, Bajraktari, nuk di mirë...

Në 1948 kanë tradhëtuar burrat. Burri dhe dy kunetërit. Ndodhi ngjarja e Bardhok Bibës në atë kohë. Burri im shitës ishte, kishim dyqan, mall, tokë sa deti. Dhe në atë kohë u mblodhën burrat, por u mblodhën gabimisht, pa mirëkuptim. Shqipëria nuk priset me 60 burra! Shqipëria është e vogël për të parë, ama edhe për të qarë sytë.

... U arratisën të gjithë. Të gjithë. Ne na lanë. Erdhi policia në atë vakt...kur u largua policia, ma fali Zoti cucën. Kemi ndenjur tri ditë aty tek një shtëpi, strehë gjëje, jo shtëpi, kur ka lindur vajza. Në krye të tri ditëve dhanë urdhër me na internue. Erdhën dhe na morën, vjehrrin, gjënë e gjallë, mallin e dyqanit, e pse? Vetëm me shti frikë, frikë në familje...Lindën cucat në udhë, me policë para e mbrapa.. Ato tmerre bënë ata në atë kohë.

Na nisën për Burrel. Katër muaj në Burrel, katër muaj pa parë dritën e diellit me sy. Fëmijët duke i larë në çimento, në ato kohë. Katër muaj kemi ndenjur në hetuesi. Bënin pyetje, - atë ditë që iku burri a i ke dhënë bukë? A ke qënë dakord me të? Në asnjë mënyrë nuk e dinim në atë vakt ne. Nuk fliste burri e gruaja. Burri nuk tregonte rrugët ku shkonte e çfarë bënte.

Enver Hoxha e mbajti vendin mbrapa, 50 vjet e mbajti. Neve na çuan në internim. Na morën në Burrel. Në hetuesi 4 muaj. Kunata lindi në rrugë me policë. I thonin: Nuk të ka ardhur koha për të lindur. Po, more ti, shok - i thotë ajo, - m'u largo. E ia fali Zoti vajzën, mu në rrugë. Unë e kisha fëmijën vetëm 3 ditësh. Gjënë e gjallë krejt e mori shteti në atë kohë. Në hetuesi na bënin pyetje për burrat, nuk na torturonin, por ... duhet të flisje. Të flisje drejt, t'i shiteshe shtetit, se i kishte shteti të dhënat. Kemi ndenjur 4 muaj aty në burg. Prej burgut të Burrelit na çuan në Tepelenë: Vjehri, të dy cucat dhe ne, dy kunata. Si vajtëm në Tepelenë, atje pamë se ishin 3 mijë vetë. Krejt paria e Shqipërisë. Krejt!

Jetonin ashtu, duke ngrënë hithra, gjethe larushku në atë kohë. Tri vjet, u bënë tri vjet, që u vra Bardhok Biba. Më pas erdhën të internuar të tjerë prej Mirditës. Ishim 3 mijë, u bëmë 6 mijë. Shteti na preu bukën, ushqimin. Ne ishim pleq, plaka e kalamajë. Atëherë më kanë vdekur vajzat. Nuk kishin çfarë të hanin, nuk kishin ushqim. Më pyeste e shoqja e Kol Bib Mirakës, - hë moj Gjellë, si t'u bënë cucat? I thashë: Cucat më lipin ujë, e unë nuk kam me i dhënë.

Ishim në një dhomë. Mora një filxhan ujë, ia lagia gjuhën, se nuk kisha ujë më shumë për të pirë. E kanë vdekur brenda tri javëve të dyja, me të njëjtën lloj sëmundjeje, nga tifoja.

Sa vjeç ishin?

Tri vjeçe, tri vjeçe kanë vdekur. I kemi varrosur aty... u vumë dhe një shenjë. Bënin plot varre për të internuarit. Varre! Vetëm varre! Ashtu si po vdisnin njerëzit, s'di. Thotë kunata ime, - me leje komandant, a ka mundësi të më japësh leje, të shkoj tek lumi të marr do gurë? Këta bënë dyshim, se menduan që po shkon për t'u mbytur në ujë. Prandaj i thamë policit, -duam të marrim gurë zalli dhe t'i

vëmë shenjë varrit se do na lirojë Enver Hoxha dhe do vijmë t'i marrim vajzat. Varret i vumë tek ato dy varret italiane. Sipër u vumë gurë të bardhë, dhë, gjethe, i mbuluam ato vajza, atje. Shkuam në kazerma. Si shkuam atje... vuajtje.

Gjithë ditën burrat bënin dru, ne gratë, i mbanim në kurriz. Ktheheshim mbrëmjeve tek kazerma, 5 sahati, po. E kalonim malin e grekut, në mes të rrugës, tri orë pasi kishim dalë prej shtëpisë. Policë para e policë mbrapa. Isha me të shoqen e Qazim Mulletit, me Mirakajt, Barajktarët e Lumës, ishte edhe një familje tiranase, Topalli. Të gjithë kemi vuajtur.

Vinim kazanin për të zierë se kishte rënë një mikrob i fushës, në atë kohë. Zienim makarona me miza. Ca kohë, na jepnin dy lekë bukë, një tani dhe një nesër në të njëjtin vakt, se u pre dhe buka, nuk kishte. Kush po e dinte, vinte nga jashtë shtetit ajo. Kemi ndenjur 3 vjet e gjysmë në Tepelenë. Më pas, na liruan, erdhëm në shtëpi.

Demokracia. Demokracia na ndihmoi. Vajtëm tek Sali Berisha, i bëmë kërkesë Sali Berishës, Kryetarit të Komunës, si janë do persona kështu kështu, erdhëm në Tepelenë. Gjetëm varret e tyre, krejt puhur. Të dyja në një gropë. U kishim vënë shenjë. I kemi qitur pasi erdhi demokracia. Shteti na ndihmoi.

Kam ndenjur 6 vjet me burrin unë. Jam fejuar 13 vjeçe, në kohën e Zogut. Ai shiste mollë. Unë e shihja. Malli i vinte nga Tirana, vinte për në qëndër se ishte xhadeja e serbit në atë vakt, xhadeja e Zogut. Me kafshë e furnizonte burri dyqanin qënga qendra. Kur na internuan na e morën mallin, gjënë e gjallë e... Mshelën derën me dryn të kuq, shteti i asaj kohe. Po Shqipëria është Shqipëri. Mbaj mend unë një Shqipëri, edhe sot, ar e flori krejt. Ar e flori! Mbaj mend, na thonin, se kur u krijua perëndia, Muhamedi dhe Krishti ishin bashkë. Mbanin shkallën shenjtore. I thotë Muhamedi Krishtit: Unë mbeta në klasë, nuk fitova në Shqipërikur u krijua feja. I thotë Krishti Muhamedit: Do të të bëj vëlla. - Po si do më bësh vëlla? - i thotë Muhamedi. - Do ndërrojme vajza¹...Pra, në atë kohë, kur është krijuar njerëzimi... Jam duke thënë që njerëzimi ka qënë, ka qënë e do vazhdo-

1. Nënkupto do të bëhen martesë mes besimtarëve të të dy feve. (Shënim i redaktore M.Sinani.)

Si vajtëm në Tepelenë, atje pamë se ishin tre mijë vetë. Krejt paria e Shqipërisë!

jë edhe sot, do vazhdojë edhe nesër njerëzimi...

Prandaj nuk duhet ta lërë kështu vendin, kryeministri, sot. Sot është Shqipëria ar, flori. Duhet të vejë harmoni për Shqipërinë, se vëllezër janë shqiptarët e vëllezër duhet të jenë dhe në ato detyra.

...Kurse ata humbën. Ne edhe sot nuk e dimë se çfarë drejtimi kanë marrë, ku shkuan... 60 burra! A i kanë pushkatuar, a i kanë mbytur në ujë, a shkuan matanë dhe i ka prerë Jugosllavia. Shteti duhet ta dijë, se dinte çdo gjë në atë vakt. Ne mbetëm në xhade duke i pritur, hë se po vijmë, hë se po vijmë, hë se po vijmë. Nuk erdhën. Me gjithë kunatën dhe vjehrrin kemi ndenjur në xhade e akoma me sytë në xhade.

Më kujtohet, në Tepelenë, nga 15 në ditë i kishim varrosur. Sidomos kur u shtuan 3000 të tjerë. Pleq e plaka, fëmijë... qoftë larg, mosha e këtyre djemve, e bënin varrin vet, hapnin varret për të tjerë, por i zinte tifoja dhe në atë varr shtiheshin ata... Çfarë doktori, as doktor e as gjilpëra, fare, fare, vetëm i nxirrin e i varrosnin.

Sot Shqipëria është... nuk duhet të ikin djemtë e rinj, të lënë nënë e babë duke qarë në jetë. Por duhet të kenë punë. Ka punë sa të duash në Shqipëri. Kryeministri të marrë ndihmë nga shtete të tjera e të hapi punë.

Sot unë bëj kërkesë, bëj kërkesë vetëm për popullin shqiptar. Mos ta lejë Shqipërinë duke vuajtur. Duke pasur ar e flori krejt Shqipëria. Ta bëjë popullin e Shqipërisë të gjithë, asnjë mos të iki prej Shqipërie. Le t'u japi bukë e punë në Shqipëri. Është a nuk është Shqipëria kjo, Shqipëria e pasur?

Tani ndodhem në spitalin e Rrëshenit. Spitali i parë, spitali i Mirditës, i Rrëshenit, qysh tek doktori, tek infermierja. Pasi u lirua prej internimit, na dha leje shteti për të hyrë në punë në atë vakt. Sa me ndejt gjallë. Si vajta tek shtëpia, pasi u lirua nga burgu, na dha shteti punë.

Pata punuar tek skrapit, tek dheu, tek galeria... vuajtje gjithë jetën. Luftë klasash, luftë mos të flisje, mos të qeshje. Vetëm punë. Dhe ne tërë jetën duke vuajtur. Çfarë kam marrë unë shpërblim? 5 kaptina, tri burra, dy kunetërit dhe burri, dy cucat, ne dy plaka rrugave, 14 milionë kam marrë, këto vite. I bëra kërkesë kryeministrit, na i dhanë dy këste. Gjithë ato njerëz që kanë humbur, e vuajtjet, joo nuk na ka dhënë lekë. Jo, jo kemi bërë ankesë, boll letra, letër pas letre. I kanë lënë në dosje, nuk na i kanë nxjerrë kaq kohë. Kam vënë dhëmbë, vetëm këtë. Kam vajtur i kam marr për sevap tek banka e shtetit... Eee, cucën ta kisha gjallë!

Ju falënderojmë shumë dhe qofshi mirë, zonja Gjelë.



Hazir Haziraj Plaku me qeleshe!

INTERVISTOI: MIRA TUCI

U

Unë jam Hazir Haziraj, 93 vjeç, nga fshati Padesh, Tropojë. Babai e ka pas emrin Ramë, nëna -Fatime. Kemi qenë 5 vëllazër e 5 motra. Prej atyre, sot, jam vetëm unë.


Erdhën partizanët, erdhën aty me forcë. Ne kujtonim se ishte mirë, me ik gjermani e me ik ata. Por ishte më keq!

Pse më kanë kallzue? Po, ne jemi nga kufiri. Një vëlla e kisha në burg. U shkante mëndja a mos po iki dhe unë në Jugosllavi. Kështu e mendoj unë, me hamendje po flas, jo se ma ka thënë kush. Vallaj, veç e di, se ka qenë ditë Bajrami, këtë e mbaj mend si ditë.

Unë isha në shtëpi, me nja dy fshatarë, po u jepja kafe, se bënim vizita për Bajram, kur më thërret sekretari i organizatës së partisë së katundit. Më tha – po të thërret një oficer, ka një pyetje me ty. Nuk shkonim keq me atë sekretarin, por vura re se, tek më fliste, i dridhej buza. E mora vesh se diçka është. U bëra për të dalë. Isha veshur si për Bajram, me tirq, një fanellatë e këmishë. I thashë, - a tëkthehem të marr një rrobe tjetër? –dhe u ktheva në shtëpi. Kam patur ca kupona të asaj kohe në xhep, me të cilat merrnimushqime, dhe i thashëgruas së vëllait, -mos i humb keto letra. Ia lashë asaj, se më shkoi mëndja që diçka është.

Po shkoja, meqë më thirri, e po mendoja se po shkonim te shtëpia e atij...ushtar a oficeri postës së policisë së Tropojës. –Hajde, tha, -se të ka thirrur se është vëllai sëmure. Vëllai im ishte në burg... E dija unë atë... U thashë: Do ishte mirë ta dinte familja se ku jam. Tha: Nuk donim të vinim të të merrnim e të alarmohej familja. Kur mbërrita, hyra, pas shtëpie kanë dalë policët. Dhe unë du-

HAZIR HAZIRAJ



**Nuk i
shkonte kujt
mendja për
armë. Kampi
i Tepelenës
nuk ishte
kampi i
internimit,
por kampi
i shfarimit,
me i shfaros
njerëzit.**

art përpjetë. Më kanë lidhur. Më ka thënë oficeri: Qe tash, e sheh vëllain mirë ti. Dhe unë i kam thënë pikë "Faleminderës mos qofsha, derisa e di veten të pafajshëm", pikë "Faleminderës mos qofsha!"

Më kanë marrë e më kanë çuar në burg, në Tropojë, atë natë. Të nesërmen, më kanë lidhur duart mbrapa, këtu edhe këtu dhe më kanë çuar në Degën e Brendshme në Tropojë. Duart i kisha mbrapa, në dy vende të lidhura. Biles, kur m'i panë, i folën policit: Pse i ke lidh 2 herë ashtu? Më dorëzuan aty, më kanë mbajtur një javë, a 10 ditë, aty, të internuar. Pastaj, na kanë nisur, pa më pyetur fare, asnjë send.

Edhe vëllai doli në gjyq, unë e ndiqja, prisja. S'ka bërë vaki ndonjëherë, more. Kur prokurori jepte 18 vjet, në bazë të rregullit, prokurori kërkonte të dënonte më shumë, por gjykata ulte diçka. Kur mori fund gjyqi, vëllait i dhanë 25 vjet burg?! Atëherë, nuk e dënoi gjykata, por e paska dënuar Dega e Brendshme. Vëllai e ka bërë në Tiranë, e ka bërë në Shkodër, e ka bërë në Fier, e kudo.

Një natë jemi nisur prej Bajram Currit, kemi fjetur në Shkodër. Të dytën natë, kemi fjetur në Tiranë. Të tretën natë, kemi fjetur në Vlorë. Të katërtën, nga gjysma e ditës, kemi mbërritur në Tepelenë. I kam pas pak lekë në xhep, se, kur u nisëm e më kanë hipur në makinë, ka ardhur baba im. Nuk kish patur lekë, ka shkuar e i ka marrë borxh do lekë, nja 500 lekë të asaj kohe, porishin shumë atëherë, e m'i ka prurë, e i kam marrë në xhep, edhe nja 1000 i kam pas unë. Kur ma ka dhënë dorën, unë i kam dhënë dorën e majtë, se dorën e djathtë e kam pas të lidhur me një tjetër. Atij i mbeti mendja, -pse ma dha Haziri dorën e majtë?- e gjersa jam liruar, atëherë ma ka thënë.

Në Tepelenë, më parë kishin qënë kazerma ushtrie. Aty u bë një kamp internimi, dhe krevatet prej dërrase kanë qënë, hëm lartë, e hëm poshtë. Kapanona, u thonin. Në dërrasa, qe aty flinim, në dërrasa.

Dita jonë ishte: Çoheshim në mëngjes, si çoheshim na shpinin për të mbartur dru në shpinë. Na detyronin policët: Kaq ke për të marrë! Disa mbeteshin në rrugë, se s'mund ta ngrinin.

Aty ka qenë mizerje. Gjellën që na e bënin i thonin bollgur. Vallaj, me kryma na erdhke. Me kryma na erdhke shumë! Vallaj, sa me mbajt shpirtin, biles po mendoj, si kemi rrue me ato çka hanim?

Kanë vdekur fëmijë shumë. Kanë vdekur shumë fëmijë të vegjël. Ka pasur vdekje prej fëmijëve shumë. Vinte një lumë, tek lumi ia bënin varrin.

Ka pasur nga Tropoja shumë. Ka qenë Avdyl Qerimi, djali i Zenun Alisë, djali i Ali Brahimit, gratë e Ali Brahimit, ka pas shumë prej Tropoje, Halil Lini, Sokol Rexhepi, familje të dëgjua më parë. Unë mbaj mend Bexhet Ndreun, Rexhep Bajrami e, janë kon shumë, vallaj, por edhe po ua harroj emrat tash.

A keni bërë përpjekje për të gjetur armë gjatë kohës që ishit në kamp?

Nuk i shkonte kujt mendja për armë. Kampi i Tepelenës nuk ishte kampi i internimit, por kampi i shfarimit, me i shfaros njerëzit.

Në Tepelenë kam ndenjtur nja dy vjet e gjysmë a tri. Prej Tepelene na kanë çuar në Fabrikën e Tullave në Tiranë. Ngjeshnim dhë për tulla, për qeramikë. Atëherë, në fund të 1953, apo 1952, po harroj, janë liruar disa. Unë nuk jam liruar. Na kanë çuar në Lushnje, kam ndenjtur edhe nja dy vjetë në Lushnje edhe më kanë lirue. Unë jam liruar në 1954. Jam liruar nga Lushnja.

Vallaj, urrejtjen e kanë të tanë, s'ke çfarë thu. E gjitha kot së koti, pa bërë gjë. Se nuk kisha bërë gjë, se me pas bërë ndonjë gabim, më kishin futur në burg. Por në internim, si punë e kotë.

Jam martuar i vjetër unë. Në Tiranë, erdha në 1996.

Pas lirim it jeni kthyer në Tropojë? Në fshat?

Atëherë? Po, po, edhe në 1987 më kanë marrë në internim prapë, familjarisht. Më kanë çuar në Lekbibaj, në kooperativë bujqësore. Se nuk kishte kamp atëherë, në kooperativë bujqësore, më larguan nga Padeshi. Familjarisht. Arsyeja? Nuk e di. Duhëj të shkoja në zyrë të kryetarit të degës, në atë kohë, ta pyesja. Sulejman Abazi e ka pas emrin, del edhe nganjëherë në televizion, e kam

dëgjuar aty emrin e tij.

Me pas dashtur me shku në Serbi, unë hyja edhe ditën në drekë, se gjithë ditën e gjatë, në vijë të kufirit punoja. Se e kemi pas shtëpinë në kufi me Serbinë, me Kosovën.

Pasandaj, kur më doli lirimi, më thanë: Shko në shtëpi. Nuk shkova. Në kooperativa ka qenë e zorrshme për të ngrënë bukë. Kur nuk shkova atje, më çuan në fermë, Rogan, i thonin një vendi. Shkova atje, hëngra një kafshatë bukë. Pak, se kooperativë...

Në katun i kishim nja dhjetë dhen, na i kishte lënë kooperativa bujqësore. Unë kositja në vende të rrezikshme që të më rrëshqiste këmba, copë-copë u bëjsha. Ata, që ishin me partinë, kurrëgjë, në livadhe, mua më linin atje me kosit.

Me thënë, sot për sot, jemi gati si në atë regjim komunist, njëlloj, se është brumi i atyre që kanë varur e pushkatuar njerëz në atë kohë. Nga ai brumë është Edi Rama. Kristaq Rama i kanë thënë babës së tij, ka firmosur të varej Avni Nela prej Kukësit.

Jam dëmshpërblyer dikur, ma kanë dhënë një pallat në Tiranë, një hyrje në pallat. Më kanë marrë, më kanë thirrur pa më internuar familjarisht, më kanë thirr në degë të brendshme me u bë bashkëpunëtori i tyre, por nuk jam bërë. Edhe me më gri e me më bë si duhani, unë bashkëpunëtor i tyre nuk bëhesha! Unë e kisha farefisn në Kosovë, gjithë njerëzit, e di? Edhe me më shti në Kosovë atje, me krye hetime, me u bë hafije me një fjalë.

Për Zotin, tash po ta them një fjalë, se e kam edhe prej fetarëve, se të bëhesh hafije e sigurimit je edhe i mallkuar prej Zotit. Edhe mos me ta thënë, veç ajo fjalë "hafije", kur e ndi këtë fjalë nuk u bëjsha edhe me më gri copa-copa.

Më parë i rrihim duart se kujtonim se është gjithçka mirë, por nuk shkoi ashtu. Nuk shkoi, u bë si mos më keq! Si nuk kishte një njeri, çfarëdo njeri të jetë, që të thoshte "Nuk ka Zot", se e di gjithë bota që Zot ka!

Faleminderit edhe një herë për mundimin dhe shëndet!



“Na ka ndjekur mbrapa biografia... ...Por njeriu është më i fortë se guri dhe i përballon...”

105 vjeçari, Ndue Mëlyshi dhe
vajza e tij Bardha Mëlyshi¹, 79 vjeçe.

INTERVISTOI KRISTALE IVEZAJ RAMA

B

Bardha Mëlyshi: Zemër, mirë se keni ardhur dhe mirë se ju ka prurë Zoti! Unë nuk përtoj të flas sa të doni ju, ditë e natë, por, tërë këto histori që mund t'ju kallëzoj unë, them se, 40 % mund të merrni ju e të kuptoni tamam. 100 % s'mundeni, s'e nuk e keni jetuar. Ne, që e kemi jetuar... ishte e tmerrshme!

Problemet e familjes sime kanë filluar qysh në 1947, kur babai im nuk u pajtua me komunizmin dhe doli në mal. Unë kam qenë 7 vjeç, se jam e datëlindjes 1939. Mbjaj mend që ishim veç gra

e fëmijë në oborr të shtëpisë, se burrat kishin ikur prej shtëpive, kurata i vunë flakën shtëpisë. Na janë djegur shtëpitë, na janë djegurbrenda 1 dite tok me shtëpitë e Gjon Markagjonit, kullat e Gjonmarkajve. Se unë jam prej Rrëshenit. Nënë e kam pas bijë Gjonmarkash. Ka qenë kushërina e tyre. Aty filloi kalvari, një jetë për së mbrapshti. U dogj shtëpia, u shkatërrua gjithçka. Arritën na çuan në një vend që i thonë Shpali i Mirditës, nja 2-3 netë. Ka shumë historira por, prej aty, na kanë çuar në Lezhë, e përfunduar në Berat. Unë, qysh 7 vjeçe e nisa punën. Na kanë çuar në Berat, në shtëpitë e pashait të Beratit, që edhe sot i mbaj mend, i kam si të rregjistrome. Sikur të më çoni tash atje, e di mirë me ta diftu vendin, se nje këtu kam ndejtur. Nënëat tona i çojshin me mbajt dru, për me u nxehur ata, dega e brendshme. Na linte nëna mbyllur me çelës, ne fëmijëve të vegjël, se ishim 3 motra, e plus këta, ishin dhe të tjerët se ishim e tërë familja.

1. Mëlyshi është mbiemri i vajzërisë i Bardhës. Bardha mban sot mbiemrin e të atit. Martesa e saj përfundoi për shkak të biografisë së saj, sepse konsiderohej si bijë e armikut të popullit. (Shënim i redaktores M. Sinani.)

BARDHA MËLYSHI



**Babai ishte i arratisur.
Ky quhej kriminel,
tradhtar, diversant, ne,
“bijat e filanit”... Sa
ishim në kamp, tok
me shokë, nga kjo anë,
ishim rehat.
Por, kur erdhëm këtu,
na bënë me gisht. Ishte
tmerr, më tmerr s’kishe
ku me e çu. S’na afrohej
askush më!**

Prej aty kena shkuar në Kuçovë, Qyteti Stalin i kanë thënë në atë kohë. Kurse në 1949-ënështë hapur kampi i Tepelenës, kampi më famëkeq që mund të ketë ekzistuar kund.

Ne i qajmë hallin të tjerëve e nuk shohin hallet tona, hallet që ka vendi ynë, e populli ynë. Kështu që, filloi jeta qysh në fëmijëri, e vazhdoi në rini. Prej kampit të Tepelenës kemi dalë të fundit. Aty tani, kam patur fatin, se kam qenë e vogël, dhe nuk më kanë çuar me dalëpër të punuar, krahas të mëdhajave që ishin mbi 20 vjet. Por, në Tepelenë ishin ajka e Shqipërisë, ee....

Plaku 105 vjeçar, Ndu Mëlyshi, babai Bardhës:

Këto këmbët e mia kanë fillu mos me qenë fort të forta. Ka disa vjet që nuk jam më në Shqipëri. Unë kur flas, flas atë dialektin e vjetër. E kam problem me e fol këtë. Kam qenë shqiptar, s’e kam har-rue, të riun nuk e kam mësue. Ju bëni punët tuaja. Besa, Pal Bibën e kam pas shok lufte.

Jeta është jetë, duhet me luftu. Edhe vdesim. Tash i kam mbush 105, por mungesën më të madhe kam veshët. Kur më drejtohet dikush e më pyet fjalë, nuk e ndij. Kam probleme, por kalojnë dalëngadalë. Më mirë vonë se kurrë.

Bardha Mëlyshi:

Vazhdoi kalvari i Tepelenës. Tepelena ka qenë kampi më i tmerrshëm që ka patur ky vend. Aty kam patur fatin e mirë se kam jetuar me ajkën e Shqipërisë, pse me rrejtë, me familje që kanë qenë shumë të përmendura. Kam qenë e vogël, unë nuk punoja. Ne u sjellshim nëpër kamp. Ndezniin ndonjë zjarr me u nxehur ujë pleqve, këta që ishin në moshë, me u bë nga një çaj. Çaj i thënçin, se ishte një ujë aty edhe... hajt. Dreka ishte, por siç dihet mirë, ishte bollguri që hanim, e di edhe Simoni, gjithë kryma. Nën-at tona na rreshtonin kështu, i pastronin krymat na ushqenin ne dhe, çfarë mbeste nga kjo, e hanin vetë. Dhe për të fjetur, aq sa e kishe trupin kishe vend për të fjetur. Ishim në rresht. Bajagi mirë, e ka bërë ai, Lekë Previzi, e ka përshkru mirë kamp-in. Aty ndenjëm 5 vjet rrumbullak. Dilnim nganjëherë prej telave, me shku me hëngër gorrice të egra, ne i thoshim dardha të egra, sa me ngop barkun. Kalonim përmes një teli.

Pas shumë viteve, kam udhëtuar njëherë për në Gjirokastër. U ndalëm me shoqet, për të fjetur në

..kalonim lumin Kir, se atje ishte vendi ku punonim në bujqësi. Çdo ditë hynim në ujë për të kaluar, verë e dimër

Tepelenë. Tani, ato nuk dinin gjë që unë kam ndejtur në Tepelenë 5 vjet, se nuk mujshim me fol, se ikje prej pune. S'të mbante kush në punë më. Edhe i pyes njerëzit aty, u them: A e dini, ku është një urë teli? Se nuk po mundesha me u orientue unë se ku kam pas ndejt, kishte ndërru gjithçka. Se Tepelena s'ka pas banesa, nja dy si tip kasolle, edhe një si tip kalaje, s'ka pas tjetër gjë. Dhe me thotë njëra, ja, atje është, por është te rruga e vjetër, kjo është rruga e re që është bërë. Atëherë jam orientuar unë se ku kam ndejt në kamp, në Tepelenë. Prej aty na kanë larguar, pas 5 vjetëve. Aty ka qenë tmerr. Aty kishte epidemi, aty vdisnin fëmijët, i varrosnin, i zhvarrosin, si u donte qejfi të gjithëve.

Na çuan në Savër të Lushnjes. Kemi punuar nëpër ferma, në pambuk, në dhomat e orizit, na hanin ushujëzat nga këmbët, e prapë duhej të hynim aty. Ka qenë jetë e vështirë shumë. Prej aty, në 1957, na kanë nxjerrë prej kampit, me nënën dhe ne, 3 fëmijë që ishim; babai ishte i arratisur. Ky quhej kriminel, tradhëtar, diversant, ne, "bijat e filanit"... Sa ishim në kamp, tok me shokë, nga kjo

anë, ishim rehat. Por, kur erdhëm këtu, na bënë me gisht. Ishte tmerr, më tmerr s'kishte ku me e çu. S'na afrohejaskush më. Neve na kanë çuar prej kampit, na dëbuan për në Bardhaj të Shkodrës. 9 muaj në Bardhaj. Kishte një kushëri nëna, që ndërhyri në Degën e Brendshme, me Ilmi Seitin, që prej Bardhajt, ne të na sillnin këtu në Shkodër. Dhe ikëm prej atje. Na mori kushurira e nënës, na mbajti në shtëpi. Motrat e mia ishin më të vogla se unë. Motra e dyte kishte 5 vjetë diferencë me mua. Ajo me të voglën ishte afër. Atëherë, ato vazhduan shkollën këtu. Mbaruan 7-vjeçaren, edhe gjimnazin, edhe... stop, s'kishte më.

Kurse unë e nëna, shkonim në Bardhaj, kalonim lumin Kir, se atje ishte vendi ku punonim në bujqësi. Në darkë i hynin edhe njëherë Kirit dhe vinim në shtëpi, për të mbajtur familjen.

Intervistuesja: Ishit të detyruara të kalonit Kirin në këmbë për të mbërritur në vendin e punës? Dhe vijonit punën me këmbë të lagura? Sa zgjashte ajo rrugë?

Tepelena ka

Dreka ishte, por siç dihet mirë, ishte bollguri që hanim...gjithë kryma. Nën timer tona na rreshionin kështu, i pastronin krymat na ushqenin ne dhe, çfarë mbeste nga kjo, e hanim vetë.

kampi më i

Ndeznin ndonjë zjarr me u nxeh ujë pleqve, këta që ishin në moshë, me u bë nga një çaj. Çaj i thëncin, se ishte një ujë aty edhe... hajt.

PLAKU 105 VJEÇAR, NDUE MËLYSHI,

që ka patur

qenë

Bardha Mëlyshi: Ajo rrugë ishte gjysëm ore për të shkuar e gjysëm ore për të ardhur, por duhet të hyje në ujë, të merre rrjedha e ujit me vete. Çdo ditë hynim në ujë për të kaluar. S'kishte urë Kiri. Verë e dimër. Tek varret katolike që janë sot, ishte Kiri; aty kalonim me nenen për të shkuar për punë në fermë, të dyja bashkë. Ajo ishte e drejta jonë. Kur unë kam hyrë në fabrikën e salcës për të punuar, më

Në kohën e demokracisë më kanë mirëpritur për shkollën e saj. Kurse ajo tjetra, për një copë pune më ka ikur në Itali, nuk jeton këtu. Jeta është shumë e vështirë, por unë e kam ngrënë me dhëmbë jetën, kam punuar. Kudo që kam punuar 8 orë pune, kam ardhur kam punuar edhe në shtëpi. Kam bërëtriko, kam punuar me grep. 40 vjeçe kam mësuar të qep në makinë, kam qepur këmisha burrash.

Si ka qenë kampi i shfarosjes! Këto vajza nuk i kanë ditur deri sa ka ardhur demokracia, vuajtjet e nënës sëvet, se s'doja t'ua dëftoja. Atë që kam në Itali e kam pas shumëshakatore. Kur ka ardhur demokracia dhe i tregoja ndonjë episod, i tregoja që njihesha me shumë njerëz, më thotë ajo, – mama, a je duke na dëftuar përralla me na vu me fjetur? Se i dukej si përrallë. Edhe ju, që ua

tmerrshëm

është dukur se kam hyrë në zyrë me punë. Kam thënë: Te paktën shiu s'më lag, të ftohtit s'më merr, kështu që jam shumë rehat, shumë mirë.

Krijova familje, por dhe familja u prish për punë biografie. I rrita dy fëmijë vetë. Iu dhashë maturën, pas maturës nuk kishte më shkollë për këto, se ishte biografia e keqe prej gjyshit. S'kishte më universitet. Njëra vajzë, ajo aty, e ka bërë 5 vjet me vonesë universitetin. Ia di për nder që e ka bërë, pse me rrejtë. Edhe sot është 20 vjet mësuese gjuhe-letërsie. Atë donte, atë mori.

them sot, ju duket e pabesueshme. Kaq ka qenë i tmerrshëm kampi i Tepelenes!

Na ka ndjek mbrapa biografia! Babai prej familjes ka të vrarë, të djegun me benzinë axha, pasi e kanë vra, Frrok Mëlyshi; vëllain tjetër të babës, Llesh Mëlyshin, e kanë hedhur në gropën e 14 vetëve, kur është vrarë Bardhok Biba; Mark Mëlyshi po, është vrarë në mal po ashtu, 23 vjeç, jo më tepër. Por njeriu është më i fortë se guri dhe i përballon, i kalon...

ky vend.

A keni të vështirë të na tregoni çfarë ka ndodhur me bashkëshortin tuaj, që familja juaj u nda?

Bardha Mëlyshi: Ai ka vdekur tashmë, nuk jeton më. Per biografi jemi ndarë, se unë kisha biografinë e keqe. I kam rritur vajzat vetë. Këtë ka paraqitur kur ka qenë puna e divorcit. Kurse babai im ka hequr kalvarin e vet. Per herën e parë që kanë hyrë në Shqipëri, në 1949, ishte parashutisti i parë që ka hyrë. Me Xhevdet Billosin, me Alush Leshanakun, me Ndu Pjetër Gjonmarkin dhe Ndu Mëlyshi. Këta kanë qenë grupi i parë për veriun e Shqipërisë dhe për Shqipërinë e mesme. Janë tradhëtuar, por kanë shpëtuar. Kanë rënë në malet e Shqipërisë, në male me dëborë. Të gjithë atje kanë rënë. Janë lidhur me njerëz, se duheshin gjetur njerëzit e besueshëm, ndryshe ishte e pamundur.

Në gusht të 1949-ës u vra Bardhok Biba, dhe atëherë Mirdita është shfarosur prej komunizmit. Dhe 100 e ca vetë janë vrarë e janë dënuar me burg të përjetshëm. 14 veta i ekzekutuan në një gropë. Të tjerët i futën nëpër burgje. Dhe i çuan në kampin e Tepelenës.

Po, po, të gjithë kanë qenë në kampin e Tepelenës. A keni dëshirë t'ju përmend me kë kam nderuar në kampin e Tepelenës? Kam nderuar me familjet më ajka e Shqipërisë. Na ka mbajtur shumë kjo lidhje me njeri-tjetrin, shumë. Unë kam nderuar me Nush Topallin shumë. Me nanën e Gjonit dhe dajat e Gjonit, me Lukejt, me Mirakejt, me Gjonmarkajt, Bajraktarët e Mirëditës që s'i mbaj mend, pse me rrejtë. Me familjen Vasiajt, me të Abaz Kupit, Fiqiri Dines, Mustafa Krujës, Agollajt, me të shoqen e Qazim Mulletit, prefektit të Tiranës, Hajrien edhe djalin. I shkreti, ka vdekur me duket. Me priftërinjtë, padre Gardinin, Viktor Volaj, padër Ferdinandin, Mark Has Kaloshte, Kurt Kolaj. Me të gjithë kemi nderuar. Na mbanin përdore, na donin ne, fëmijëve. Rrinim me njeri-tjetrin. Priftërinjtë më kanë mësuar uratën, me thënë uratë. Tani, unë nuk e di se çfarë feje keni juve, por unë aty i kam mësuar, përmes priftërinjve. Vendoste dy gurë, tulla, çfarë gjenin, dërrasë edhe prifti rrinte andej, ne rrinim këtej. Na mëson-te edhe thoshim uratë.

A ka qenë kjo gjë kundër ligjit?

Bardha Mëlyshi: Jo. Atëherë s'kishim frikë, se nuk ishte akoma kundër ligjit. Në 1967-ën është bërë kundër ligjit. Janë prishur të tëra.

Kur na çuan në Savër, pasi ikëm nga Tepelena, kemi marre leje në Degën e Brendshme për të marrë priftërinjtë për meshë. Për meshë, pavarësisht kushteve, krijohej kori i kishës me gjithë fëmijët, të gjitha vajzat, se ishim gati një moshë, si me thënë.

Në Savër të Lushnjës, unë shkoja në këmbë, prej Savrës deri në Lushnje për në shkollën 7-vjeçare. 8 km ecja çdo ditë, verë a dimër, me një çantë peceje. Ma çepete nëna e shkretë. I fusja ato do libra atje, dhe nisesha.

Do ju dëftoj për Hamit Matjanin. Hamit Matjanin, e zenë këta. E tradhëtuan, e kapën, e preu komunizmi. E bënë kriminel, tradhëtar, diversant, ky ka vra, ky ka pre, ky ka bërë namin, thua se kishte shfarosur tërë Shqipërinë. Prej shkolle na kanë qitur pasdite, ta shikonim atë në stadium, që e kishim afër shkollës. E kishin varur. E kanë parë Hamit Matjanin fëmijët dhe u tmerruan. Ec e mos del atje, në ta mbajtë mos me dalë.

Në Lezhë më ka vdekur gjyshja, gjyshi. Nuk iu dihet varri se ku janë, s'e di. Çfarë t'u them tjetër? Nëna ime, jo veç nëna ime, por gjithë nënat, ditën që kena ikur prej Tepelene, është ulur në gjuhë e ka thënë: *-O Zot, çfarë të mire të kam bërë që me të tri vajzat hyra dhe me të tria dola prej këtij vendi?* Aty ka patur nëna që kanë hyrë me 5 fëmijë dhe kanë dalë pa asnjë prej epidemisë. Nuk i mbaj mend tani se vitet bëjnë edhe punën e vet, plakë jam tash, trutë janë shterrur, tash s'ka më tru. Kështu, s'di çfarë t'ju them më. Ka shumë...

Kam djemtë e axhës, ata s'jetojnë këtu, janë në Belgjikë. Mëlysh janë shumë. 35 vetë kemi qenë kur është djegur shtëpia, që u shkatërrua familja komplet. Ta dëfton edhe baba. Është djegur shtëpia me 5 dhoma, si me thënë, që ishin 5 meshkuj të martuar. Është shkatërruar komplet, edhe ne u shpërndamë. Të fundit krejt, jemi liruar prej kampit. Nëna ime me gjithë dy motrat e mia, të fundit prej shtëpisë së Mëlyshve që jemi liruar kemi qenë ne, të fundit. Jemi liruar, i thëncin, se

edhe kur ikëm prej Savrës, shkuam të dëbuar në Shkodër, se unë s'jam shkodrane, jam mirditore. Atje s'kishim ne vend! Shtëpitë na i dogjën, janë shesh, tokë. Nuk jeton më kush atje, janë shkatërruar.

A kujtoni ndonjë rast, në kamp, si ia keni dalë kur dikush nga ju ka qenë i sëmurë ? Çfarë keni bërë?

Bardha Mëlyshi: Do të dëftoj për vete. Unë kam patur një rast në Tepelenë. Ka qenë një infermiere, mos u gabofsha, Afërdita.

Ndërhyn në bisedë një i afërm: Jo, jo, ka qene një Aziz Ndreu. Aziz Ndreu, ishte i internuar. Kishte prirje. Kemi pasur edhe një doktor të qytetit, doktor Lluka.

Bardha Mëlyshi: Tani unë nuk i mbaj mend, mbaj mend vetëm një, Afërdita, që ka qenë infermierja e kampit. Unë kam pasur rast njëherë, kam rënë me fjet shëndoshë dhe, natën, jam çuar e bllokuar në fyt, komplet. Temperaturë shumë e lartë. Nuk mundeshatë kapërdija kurrëgjja: as ujë, asnjë send. I kane thënë difteri, ça tëthem unë, nuk e di tani. Plakat tona i kanë thënë hardhuca

Ushtari i detyroi t'i ngarkonin edhe njëherë drutë, të ngjiteshin atje lart e të zbrisnin, me gjithë dru, poshtë...U ulën ato edhe njëherë poshtë, dhe, kur i çuan drutë aty ku i shkarkonin, edhe i dënuan 24 orë pa ngrënë. Dënim!



Kanë ndejtur nëpër burgje njerëzit, jam plotësisht dakord. Edhe për ne ka qenë burg ai! Ka qenë një burg i cili, moshën tonë, e ka dënuar pa ligj, pa gjyq, pa asnjë send. A më kupton?

në fyt, që i dilte demek në një rën anë të fytit. Edhe unë jam shtrirë për vdekje. Nja 3 ditë më kanë mbajturja, ashtu, masandaj ajo, infermierja ndërhyri, më mori dhe më nxori prej kampit e më ka çuar në Gjirokastër. Ishte spitali i parë që u bë në Shqipëri, në Gjirokastër. 1 muaj kam ndejtur atje e shtrume. Në Gjirokastër, në spital. Bile aty gati mësova edhe greqisht, se andej flitej edhe greqisht. Isha fëmijë. Këtë fat që kam patur unë, mund ta kishin patur të tanë, si me thënë, ose s'e kanë patur.

Kanë vdekur dhe kanë mbaruar e nuk është interesuar kush për t'i mjekuar. Një Zot të shpëton!

Aty ishim në kamp. Flinim të tërë rresht kështu, kry më kry, dhe polici gjithë natën shëtiste me një fener në dorë dhe një pushkë në krah që na ruante. Nëse nuk na gjente tek vendi, aty ku kishim rënë për të fjetur, tërë kapanonin e çonte peshë. –Çohuni!-u thoshte të gjithëve. –Pse je çuar ti pa leje? Dhe të dënonte.

Mbaj mend njëherë, këto vajzat e mëdhaja, Gjonmarkajt, Suzen, motrat e Nikolin Destanishta, Albina, Zheta e tanë, mbaj mend këto ishin vajza të mëdhaja dhe i çonin me mbajt dru. Këto të reja 20 vjeçe, 22 vjeçe, 18 vjeçe. Shkojnë. I shoqëronte

ushtari të shkonin për të mbajtur drutë, por drutë nuk ishin për t'u nxehur ne. Ne s'kishim as ngrohje, as dritë, as kurrëgjja. Asnjë send ne! Veç çohu prej atyre zheleve qëna mbulonin, dil jashtë, ec, hajde prapë e hy në kamp. Të ushqenin me njëçfarë na jepnin aty dhe, mbaro punë. I kanë ngritur e shkuan, njëherë, ngarkuan drutë, dhe këto të shkretat, ishte një pjerrësi e madhe atje në kodër. Këto i lidhnin drutë me ato konopët, e nuk i mbajtën në kurriz, por i lëshuan dhe drutëshkuan drejt e ranë poshtë. Kur u ulën këto poshtë më këmbë, ushtari i detyroi t'i ngarkonin edhe njëherë drutë, të ngjiteshin atje lart e të zbrisnin, me gjithë dru, poshtë. A rrej gjë? Se unë mbaj mend shumë gjëra. U ulën ato edhe njëherë poshtë, dhe, kur i çuan drutë aty ku i shkarkonin, edhe i dënuan 24 orë pa ngrënë. Dënim!

Dëgjo zemër, kanë ndejtur nëpër burgje njerëzit, jam plotësisht dakort. Edhe për ne ka qenë burg ai! Ka qenë një burg i cili, moshën tonë, e ka dënuar pa ligj, pa gjyq, pa asnjë send. A më kupton?

Shkoj unë të nxjerr dokumentet për, demek, dëmshpërblim, që është ëndërr, mos ta mendoj kush, se, kur s'i kemi marrë tash 25 vjet, s'kena me i marrë më kurrë. Kur të vdes unë, mandej, t'i marrë kush të dojë. Neve na dridhet dora sot me 150 mijë lekë¹ pension për të pirë një kafe. Të dal të bëj një udhëtim. A është kështu a jo? Na ka ikur fëmëria, rinia, pleqëria, të tëra na kanë ikur. Ça të bëjmë, me kë të merremi, kush na ka në vesh?

Gjoni (i afërm): Na kanë thënë disa persona që, kur ju zbritnit ngarkuar me dru, nga të dy krahët e rrugës, rreshtonin qytetarët që t'ju gjuanin me gurë.

Bardha Mëlyshi: Jo, nuk e di unë. Tepelena-sit janë sjellë mirë me ne të kampit, të them të drejtën. Unë mbaj mend psh, mbaj mend djalin e axhës të Simonit, Zefin. Zefi i thotë nënës së vet që, shqep një send e bëj një tjetër, bënte çorape leshi, –më jep një palë çorape leshi, se dua t'i ndërroj me 1 kg miell kallamoqi (miell misri). Do i merre me vete, që kur të shkonte në shkollë, atje lart, t'i ndërronte me 1 kg miell kallamoqi, që nëna

1. Këtu lekët janë me sistemin e vjetër që ka mbetur akoma në përdorimin popullor. Sipas sistemit aktual të vlerësimit të lekut, pensioni i mësipërm është 15 mijë lekë. (Shënimi redaktore M.Sinani.)

e vet t'ia bënte më të trashë atë lëngun që merrte për tëngrenë. I mori ato çorape, i ndërroi me kilen e miellit kallamoq, por, kur vjen, vonohet, nuk vjen me turmën për të hyrë në kamp. Mbeti të hynte fshehtas nga telat. E sheh polici, e kap, miellin ia derdh dhe e lidh te dera e kampit, e le 24 orë lidhur te dera e kampit. Ne qitshim kryet prej derës aty ku hynim, tek ato kapanonet e mëdhaja të ushtrisë që ishin të tmerrshme, jo me banu në to, edhe e shikonim. Na dhimbej, qanim, s'kishim çka të bënim. Si mund t'i vinim në ndihmë ne?

Kurse ata, vendasit, janë treguar, për ne kanëqenë shumë të mirë, me thënë të drejtën. Unë nuk di asnjë send. Ndoshta edhe kam qenë e vogël, besa. Unë mbaj mend Karlet Llukën, me moshën e vet që i futnin në Vjosë, për të pritur trupat, se atëherë s'kishte transport si ka sot. Të prisje trupat që vinin, edhe në ujë deri këtu, e t'i nxirrje trupat matanë lumit. Nje aty. Kur bëheshe 16-17 vjeç, ta vinin syrin. Të kapnin aty edhe të fusnin në burg: agitacion e propagandë. S'linin gjë pa thënë, veç të të dënonin. I merrnin, i çonin të gjithë këta që bënin moshën, në Maliq të Korçës, nëpër vende për të punuar: Thanin kënetat, bënin punë. Nje aty ka ikur Nikoll Gjonmarkaj, prej Maliqit të Korçës ka ikur.

Gjoni (i afërm): Aty ka patur edhe shtetas të huaj. Unë kam njohur një personazh, Gardin, ka qenë prej njerëzve të mëdhenj të Shkodrës. A di të thuash, nëse ka patur ndonjë trajtim ndryshe për shtetasit jo shqiptarë, në sensin e racizmit?

Bardha Mëlyshi: Ai ka qenë italian; unë do të të dëftoj për dy gjermanë. A i kujton gjermanët ti? Ti je më i vogël se unë. Ti ke qenë 1 vjeç, unë kam qenë 7.

Vajza e Bardhës (e pranishme gjatë intervistës): Mos harro një rast tjetër që e dëftonte nënëdaja, kur kanë qenë dy tezet me gjithë fëmijë që shkolin në shkollë. Fëmijët s'kanë pasur këpucë. Kanë parë një grumbull të madh me xhaketa dimri ushtarake dhe këpucë dhe teza i ka tërhequr 2 palë këpucë, por, njëra një këmbë e tjetra ndryshe, a nuk e kujton? E mbaj mend që e ke dëftuar.

Bardha Mëlyshi: Pra, kanëqenë dy gjermane që ishin zënë robinja lufte. Atyre të shkretave u sillnin paketa. Paketat ju vinin përmes ambasada-

dave, si robinja që ishin. Alamet femrash! Ne i mbanim shumë afër. I kishin prurë në kamp te ne. Atyre u vinin paketa me çokollata. Letrat e çokollatave na bënin përshtypje, merre me mend tani. I mbledhim letrat se na dukeshin të bukura. Ato i kanë mbajtur disa kohë dhe masandaj, siduket nëpërmjet ambasadaeve, i patën larguar. Patën ikur.

Po kanë qenë edhe 3 italianë. Trajtimi ishte njësoj. Çfarë iu vinte tepër atyre, ishte tjetër gjë, ata e hanin me ne. Kur u mbyll kampi i Tepelenës, erdhën në Savër, dhe në 1955 u riatdhesuan.

Kurse këto, gjermanet, kanë ikur qysh prej atje, më herët. Por jo, ato u ambientuan me ne, krejt. Trajtimi ka qenë njëloj. Çfarë do që ka ndodhur në atë kamp, me cilëndo vajzë, me cilëndo djalë, aty ka qenë një vend që nuk mund t'i vesh faj kurkujt në botë për kurrjë. As nuk mund t'i përgojosh për të keq. Asnjëherë, kurrë! Asnjëherë s'mund ta përgojosh për të keq, se aty ka qenë i tillë, që ke qenë nën urdhërat e të tjerëve, e s'ke guxuar të marrësh frymë. Ka qenë njësoj si me pas qenë në burg. Je paraqitur në apel 3 herë në ditë, ke dalë për të marrë atë garuzhde, që ishte më e zezë sesa kostumi që ai vesh, prej fuçive të mëdha që i sharrnin e i vinim nën gurë. Mbledhim asi sendesh, i zienim, bëhej blu ai lëngu prej atyre fuçive, edhe na e ndanin me rradhë të tërëve. Gjithfarë enësh qëkishim, i kemi gjetur aty, se s'kishim enë se ku t'i fusnim. S'kishim as me çfarë të hanim, ku ta zienim, as ku ta mbanim. Asnjësend, veç çka na jepnin ata: 300 gramë bukë në ditë. Imagjinoni. Kjo ishte, skishte më!

Vetëm bukë keni ngrënë?

Bardha Mëlyshi: Atë bukë na jepnin, edhe atë gjellën që zienin në kazan, ta jepnin me garuzhde.

Gjoni: Ishte policia, qëndante dy herë të ashtuqajturën gjellë. Kazanët ishin aq të mëdhenj, sa kjo dhomë. Ishin fuçi që kishin patur vaj për makina. Dhe, siç tha Bardha, duhejtë kishe një mikroskop për të gjetur një kokërr groshë, 1 fije makarone. Uria ishte e tmerrshme.

Bardha Mëlyshi: Ose atë bollgurin me kryma, zoti ka dashur që kemi shpëtuar. Pa rrena. Unë me nënën time dhe me dy motrat e mia, ato kanë

qenë më të vogla dhe tërë këto gjëra që unë i mbaj mend, ato nuk i mbajnë mend të tëra kështu. Ato kanë qenë më të vogla se sa unë. Por ama, ai ka qenë kamp shfarosjeje, jo kamp internimi. Tela me gjemba!

Sot jam kjo që jam. Kam punuar vetë ditë e natë. Kam mbyllur gojën, se kam thënë dëgjojnë edhe muret.

Gjoni: A mund të kujtoni ku janë varrosur trupat?

Bardha Mëlyshi: Unë e di që i kanë varrosur në një si kodër, mandej, i zhvarrosën prej aty... në Turan a si i kanë thënë atij vendi.

Njëherë i kanë çuar jashtë kampit, jashtë telave, në faqe të malit. Pastaj i hoqën prej aty, i çuan te Ura e Bënçës. Pastaj, nga Ura e Bënçës i prunë, jashtë telave të kampit, buzë lumit. Buzë lumit nëmënyrë që lumi kur tëvërshonte, t'i merrte me vete.

Ajo ka qenë tmerr. Kur i kanë zhvarrosur, që i kanë hequr këta, ka qenë e tmerrshme. Ata prindër kanë patur trauma të mëdhaja në atë vend. Me kujtohet veç një kodër, në krahun e djathtë të kampit...

Pyeta kunatin, Vasilin, burri i motrës. Ai është 92 vjeç. Ai tha: në buzë të lumit, në fund të kampit. Janë varrosur aty, për arsye se e dinin që lumi kur të vërshonte, do t'i merrte me vete.

Bardha Mëlyshi: Kristina Gjonmarkaj duhet t'i dijë më mirë se unë dhe Simoni. Kristina është 85 vjeçe sot, nja 6 vjet më e madhe se unë.

Gjoni: Perceptimi i fëmijës 5 vjeçar, ai i një 13 vjeçari, i një 17 vjeçarika mundësi të jetë ruajtur saktë. Do ishte mirë sikurbaba Melyshi të mbante mend, po ai tashmë ka humbur shumë nga kujtesa e vet. Mund të krijohej njëmuze këndvështrimesh të ndryshme.

Bardha Mëlyshi: Unë kam hyrë 7 vjeçe në kamp e kam dalë 20 vjeçe. 13 vjet, edhe prapë se prapë kampeve kam qenë këtu, se kam vuajtur si Krishti për të shkuar për të punuar, me ardhë fermave e vendeve. Kush më ka dhënë punë. Shkoja kërkoi

punë, s'ka punë për ty më thonin. Ke këtë edhe këtë... Vetëm në tulla, në kanal e në fermë. Edhe ta zgjidhje njëren prej tyne se s'bënte të rrije në shtëpi.

Si fëmijë që ke kaluar këtë tmerr, ke parë nënën të vuajë, të tjerë, ke parë sa e sa vdekje dhe vetë ke shpëtuar për fije, a të ka shkuar ndonjëherë në mend të pyesje, përse ndodhte e tërë kjo? Përse shfarosej populli? Çfarë mund ta ketë shtyrë diktatorin në një urrejtje kaq të pamasë për popullin e vet?

Bardha Mëlyshi: Unë nuk shoh filma që janë me vrasje e me kështu, filma sovjetike që janë duke i marrë nëpër trena, nuk i shoh asnjëherë. Unë e mbyll televizionin, se e kam kaluar vetë.

Bardha Mëlyshi: Kush? Enver Hoxha? Prit, o Zot. Kush ia përmend emrin atij? Si e ndieja unë? Unë edhe sot që ka vdekur ai edhe kam shpëtuar prej njatyre kampevet, për shpirt, i shqyq të tërë që ndjekin rrugën e tij. Ashtu de!

Ndoshta nuk e kuptove. Atëherë, si fëmijë, që ishe i mbyllur e po kaloje gjithëatë tmerr, urrejtje, frikë dhe ke vuajtur edhe duke parë nënën dhe çfarë po i bënte popullit. A mendoje si mundej një njeri me e fut nëpër burgje e kampe shfarosjeje popullin e vet? A ke pyetur ndonjëherë: Vallë a është në rregull ky njeri?

Bardha Mëlyshi: Eeeee, ai s'ishte në rregull, po hajde të flisje. A ia mbante kujt të fliste se? Ku kemi guxuar të flisnim? As të shikonim. I thoshe komshisë njëherë "nadjë e mirë!", s'të ktheu përgjigje, s'kishe më të flisje me të. Kushedi? Jemi ruajtur!

Nuk i ke besuar kërkujt?

Bardha Mëlyshi: Kujt t'i besoja? Ne, shqyq që erdhi demokracia, e mirë a e keqe erdhi. Kam patur lepurin në bark, po sot më ka hyrë qeni. Bëj blla blla blla sa mundem. A është kështu? Të paktën s'më bën gjë kush. A jam gabim?

Je trimëreshë!

Bardha Mëlyshi: Jam mirditore, jam vajza e këtij 105 vjeçarit!

...kam hyrë 7 vjeçe në kamp e kam dalë 20 vjeçe. Edhe prapë se prapë kampeve kam qenë këtu, se kam vuajtur si Krishti...

Gjoni: Ke qenë me personazhe të famshëm në kampin e Tepelenës?

Bardha Mëlyshi: Unë s'mbaj mend asnjë. Ooo, kapter Selfoja, po tani i thonë, më falni, pyll pa derra s'ka. Edhe aty ka qenë si pyll. Trima vetë kemi qenë, i mbaj mend, bajagi, i mbaj mend.

Ju dua!

Bardha Mëlyshi: Edhe unë po ju them se jeni te lirshëm ju, edhe e lirshme unë, se ndoshta s'kisha mundur të flas kaq shumë. Isha rezervuar një fije. Kisha patur frikë.

Çfarë ndryshimi sheh tek të mbijetuarit, prej punës së institucionit tonë si Autoritet i hapjes së dosjeve të sigurimit, prej institutit?

Bardha Mëlyshi: Unë kam patur rast psh, të shkoj të kërkoj shkollë për vajzën. Më ka parë Lin Martini, Lini, më ka parë në gjithë atë kallaballëk aty, prej larg. I ka thënë njërit të çohet e më kërkoi mua të ulesha. Më ka respektuar, a më kupton? Kam shkuar te Sokoli në Tiranë. Sa më ka parë

tek dera, i ka qitur të tërë jashtë. Hajde, Bardha, rri këtu, se kishim vite pa u parë, se u shpërndamë ne, mandej. U rritëm, u shpërndamë, shumë gjëra, mandej. Duheshin rritur fëmijët, mbajtur shtëpia, duhej mbajtur nëna e të tërë. Se nënën e kam mbajtur unë. Nëna ime ka vdekur.

Familjes sime, Enver Hoxha i ka djegur 2 shtëpi. Nënës sime nuk i kanë dhënë asnjë hyrje apartament. Edhe kur ia kanë dhënë një dhomë, ia kanë dhënë me një komshi tjetër: Dy familje bashkë, në një hyrje, se ashtu ishte. Si të jemi ne tani e të jetojnë 2 familje në këtë vend. Janë shumë gjëra. Por s'na e ka mbajtur të flisnim.

Ne thamë, shqyrr, që erdhi demokracia, se i kena patur emrat në listat e zeza, se ishim rritur. Të hysh edhe njëherë atje ku kemi qenë!

Ka shumë e shumë sende. Unë iu thashë rrimë deri në mbrëmje të bëjmë muhabet. Ju qes edhe nga një gotë raki, edhe ndonjë gjësend...

Ju falënderojmë shumë për intervistën. Qofshi të fortë e me jetë!



“Për Zotin, nuk e kishim besuar kurrë, kurrë, kurrë, se nga ne të shtëpisë ndonjëri do hynte në burg”

Dëshmi nga **Nikollë Dojanaj**

INTERVISTOI KRISTALE IVEZAJ RAMA

Jam Nikollë Gjek Dojanaj. Lindur në fshatin Rapsh, Hot, në 07.04.1931. Më 26 gusht të 1948 më është arratisur vëllai në Jugosllavi. Më 20 shtator po të vitit 1948 na kanë internuar familjarisht në Tepelenë.

Kemi qenë në një magazinë të madhe të mullirit në Malësi të Madhe. Na kanë internuar prej andej, pa asnjë send, nuk ka patur as rrugë makine. Lidhur, trimat lidhur, gratë zgjidhur, derisa na kanë çuar atje. Hazif Shehu, i arratisur, Nikolla i vëllai, Lena, Deda edhe Gjoka në internim me ne, në fillim e deri në fund. Mark Frangaj, i arratisur jashtë në Jugosllavi, Rroku, Pjetri, Gjoni, Luigji. Po të kallëzoj se nuk gjindet histori me pleq e me fëmijë. Askush në botë nuk i beson vuajtjet e Tepelenës. Asnjë teshë, asnjë fije ushqim, as një fije çaji, as çfarë ka lerë falë zoti e kësaj toke nuk na kanë dhënë.

Ishim axha, axha tjetër, nënë Lena, motra Diella, vetë Nikolla, Frani, Dranja dhe Mria. Zefi ishte ushtar, e kanë arrestuar në ushtri, e kanë prurë tek ne në Tepelenë. Jetonim vetëm me 600 gramë bukë thatë. Deri në tetë vetë, pasha këtë kryq, i kam shtirë vetë në dhë me shokët e mi. Deri 8 vetë në ditë. Plus që i kam shtirë vetë, por krimet e komunizmit nuk i beson kurrkush! Dikur erdhën ata të inspektimit, e kanë parë vendin aty, pak vend, dhe kanë thënë t'i heqin prej aty e t'i çojnë në tjetërvend. I hoqën varret prej aty i çuan afër lumit, 100 apo 200 metra afër kampit. Varrimi nuk është asgjë, por t'i marrësh kocka zbërthyer... nuk shpjegohet tani, t'i marrësh e t'i lidhësh... Gjëja më e tmerrshme është të nxjerrësh të vdekurin për të dytën herë. Për të dytën herë është dhimbje. Vuajtjet e komunizmit nuk përfytyrohen e as nuk i beson kurrkush. Nuk i besoj vetë, e jo tjetër kush!

**Deri në tetë vetë,
pasha këtë kryq,
i kam shti vetë në
dhë me shokët e mi.
Deri 8 vetë në ditë.**

**Vuajtjet e
komunizmit nuk
përfytyrohen e
as nuk i beson
kërrkush. Nuk i
besoj vetë, e jo
tjetër kush!**

Varfëri, varfëri. Pleq e fëmijë. Kanë qenë kazer-mat ushtarake tri katëshe, e tri palë krevate. Nuk mund të rrije në shtrat drejt, por hyje në fund nga këmbët e po andej dilje jashtë saj, se nuk mund të rrije në shtrat.

Kemi qenë deri 4200 vetë, por prapë nuk e bëson kërkush. Deri në 4200 kemi qenë në Tepelenë. 600 gr bukë kollomoq. Duhej mbartur buka e të hidhej në lumë, se qelbej vendi.

Pas një viti na kanë prurë nja 20 fuçi hekuri. I kanë prerë përgjysmë, medemek për të na bërë gjellë. Kishte ndryshk hekuri; i kanë hequr e kanë prurë kazanë prapë, prapë po ato fuçia, vetëm se i kishin marrë në repart ushtarak ku kanë la teshat.

Atje, përgatit sëpata, bëj dru, nxirri në rrugën e makinës e bëji stivë, e ngarkoi për ushtrinë, për policinë, për degët e brendshme, për tërë Republikën. Mos të bëje gjë, nuk të rrihnin, por të fshiheshe nga puna, të mos punoje ... kur ulesh vetë duhej të ulja edhe drutë. Sa lindte dielli, të shihte polici e gjithë ditën e gjatë, e në darkë duhet të shkoje prapë atje, prapë natën, kur vinte makina, se duhej ngarkuar me dru.

Kur kemi shkuar sefte, kemi çuar nja 3-4 vetënë spital. Njëri nuk është kthyer, 3 janë kthyer, as ka patur infermieri, as infermiere, as spital.

Çfarë ngjarjesh ju kanë mbetur në kujtesë nga ajo kohë tmerri dhe e largët?

Nikollë Gjek Dojanaj: Motra shkoi në spital, e kemi çuar në Gjirokastër. Dy janë kthyer, dy nuk janë kthyer. Motra është kthyer veti dytë, dy nuk i dihet as sot. Kanë shkuar 4 fëmijë, dy kanë vdekur, vetëm motra ime me gjithë një tjetër kanë ardhur gjallë. Na kanë liruar atëherë, ne kanë ardhur e na kanë marrë njerëzit tanë që i kishim të afërt.

Nikollë Gjek Dojanaj: Ka vdek ai...prej Hotit...e kanë vu në makinë e ai ka vdekur rrugës. E kemi shtirë në dhë në Tepelenë.

Skamje. Pa kurrfarë ushqimi, pa kurrfarë gjëje, pa kurrë një gram gjëje. 4 gramë vaj, e kanë thënë, medemek, se 4 gr vaj e kemi patur me ligj...Kanë thënë 4 gramë e nuk kanë qenë as 2 gramë. 100 vetë 400 gramë.

Ka patur infermierë të vjetër, por jo, nuk vinte kush të bënte vizita. Jo! Nuk mbaroi me kaq.

Më pas si ndodhi që ju kanë arrestuar?

Nikollë Gjek Dojanaj: Sa u lirova më morën ushtar, e shkova në repartin e punës. Edhe aty, pa të drejtë arme, e u shoqërova me shokë të mi, një shok prej Kruje, një shok prej Malësie. Atij i kishin vrrarë babën edhe vëllaun. I thoshin Naim Kupi. Babën edhe vëllain, edhe nënën në burg. Edhe priste ta arrestonin. Më thotë mua,-nga është kufiri?Edhe një shok tjetër që i kishte vdekur babai në mal, i thoshin Llesh Grisha, janë bërë bashkë. E i kam marrë e i kam kaluar përtej kufinit. Pas 1 viti, jam zbuluar, se si u mor vesh, por u mor vesh e më internuan familjarisht në Lushnje. Edhe në Lushnje, pas 10 muajsh, erdhën më arrestuan, më çuan në Shkodër, e aty më dënuan me vdekje:- Pushkatim!

Cila ishte akuza?

Nikollë Gjek Dojanaj: Akuza, demek me diversantët, akt akuza ishte se përçolla 4 vetë. Përçolla, Naim Kupin me nënë e me motër edhe Llesh Grishën, që i kishte vdekur babai në mal. Më dënuan me vdekje, pushkatim. Kam bërë 14 vjetë e gjysmë në burg të Shkodrës, nga atje në kampe, në Laç e Fushë Krujë, Elbasan, në Fabrikë të çimentos, në sodën e në kripore tëVlorës, në Ballsh të Fierit, në kombinatin e mishit në Tiranë, në Uzinën e Traktorit, të gjitha në këto kampe.

Vdekje me pushkatim nga Gjykata Ushtarake e Shkodrës, vdekje me pushkatim nga Gjykata e Lartë, atëherë pas 59 ditëve, më ka ardhur vendimi prej Presidiumit të Kuvendit Popullor. Presidiumi më fali jetën, la dënim vetëm 25 vjet.

Ato nuk duhet me i përmend. Arsyeja pse nuk duhet me i përmend, gjithkush ... nuk di si ta shpjegoj. Gjithkush do që të hajë një kafshatë bukë. Të jesh e bindur se prokurori e ka pas urdhërin prej Komitetit nga larg. Gjyqi atë kohë, bëhej prej tavolinës, jo prej sallës së gjyqit. Jo, foli avokati, jo foli ky e ai... Gjyqet politike janë bërë në tavolinë! Ta ka çuar gjykata për ulje në 25 vjet dënimin nga vdekje me pushkatim, s'ka pas mundësi prokurori më shumë, as kurrkush. Ka qenë me vendim i tjetër kujt.

...kur m'i kanë
zgjidhur hekurat,
kam qenë 59 ditë
i dënuar me vdekje
me pushkatim.
Pasha Zotin, 10
gishtat e duarve dhe
10 gishtat e këmbëve
nuk mundesha me i
lëvizë prej hekurave,
veç kanë qenë të
vdekura, dru.

...kur s'ke këmbë e s'ke duar, me robtë të internuar ç'më duhej jeta? Kur shkon në atë mënyrë, thua, o Zot më merr. Tash, është gjynah!

Pasha jetën e Pasha Zotin që mbi jetën e mbi Zotin e mbi tërë dynjanë, kur m'i kanë zgjidhur hekurat, kam qenë 59 ditë i dënuar me vdekje me pushkatim. Pasha Zotin, 10 gishtat e duarve dhe 10 gishtat e këmbëve nuk mundesha t'i lëviz prej hekurave, veç kanë qenë të vdekura, dru. Kisha ndenjor në birucë edhe tri javë me ujë të nxehtë e me krypë. E merrnin në kuzhinë e ma sillnin në birucë. Nuk isha i zoti as të vishesha, isha bërë cung, derisa fillova të lëviz gishtat e duarve dhe të këmbëve e të çohem në këmbë, të flas me të burgosur.

Nuk jam gëzuar, kur s'ke këmbë e s'ke duar, me robtë të internuar ç'më duhej jeta? Kur shkon në atë mënyrë, thua, o zot më merr. Tash, është gjynah të hysh në gjynah, por i jam lutur zotit, i jam lutur zotit, o zot të iki nesër. S'ka kurrfarë shprese në këtë jetë. Unë 25 vjet në burg, robtë në internim, çfarë shprese të kisha? Lut zotin të ecja, s'ka! Të të marr e të të çoj atje, ti çmendesh!

Vëllai shkoi andej, neve na internuan. Bëra faje, prapë internova edhe të tjerët. Tani edhe të të bjerë tjetri te dera, o duhet të pritësh o të koritësh, por të koritësh nuk bën! Pastaj ka shkuar

në Gjermani e ka punuar. Ka punuar në armatën amerikane, ushtarak me Naton-n.

Në atë vit që vëllai iku në Jugosllavi, ne kemi qenë miq me Jugosllavinë. Tito me Enver Hoxhën e kishin bërë planin e për zotin nuk kemi mbjellë një kokërr gollmoç, as një fije groshë, as kërtollë, veç ka qenë plani ta fusnin në shishe këtë popull. U mboll vetëm luledielli. Mos t'i linin njerëzit të punonin, veç të mbillnin luledielli për t'i çuar në Jugosllavi e Jugosllavia, medemek, do na sillte gollmoç. Edhe luledielli nuk eci mirë aspak. Pra, Enver Hoxha ka qenë njeriu më i tmerrshëm në botë. Bashkë më klyshët e vet me shokët e vet.

Pasi keni kryer dënimin, ku keni punuar?

Nikollë Gjek Dojanaj: Pati dalë një vendim qeverie, kush ka bërë 10 vjet jashtë rrethit, si arsimtar, si oficer, si i burgosur, ka të drejtë që, nëse ka qenë nënëpunëtorë kthehet sërish në punë. Në fillim më lanë në kooperativë. Lutje pas lutje kam punuar në ndërmarrje të ndërtimit. Ky ishte vendimi i qeverisë. Kush ka qenë në punë të shtetit, kush është arrestuar në punë të shtetit ka të drejtë të shkojë në punë të shtetit. Pas disa vuajtjesh prapë në kufi, deshën

të na arrestojnë. Kërkova largim dhe kemi ardhur në Bushat të Shkodrës, dhe jetoj aty.

Tani unë jam tuj lyp nuse, tani më ka rënë në mend mue. Ne, për zotin, nuk e kishim besuar kurrë, kurrë, kurrë, nuk e kishim besuar se nga ne të shtëpisëndonjëri do hynte në burg. Një herë m'u internua familja për vëllain, herën tjetër për mua. Më vdiq nëna në internim. Me lënë grua e fëmijë... Joo, nuk bën. U ktheva në Malësi.

Më kanë nxjerrë datëlindja 2008! Me njëqind punë e vuajtje, me shoqëri e sakrificë, jam paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë, se Ministria e Financave e ka hequr emrin tim, e ka çuar në Ministrinë e Drejtësisë që nuk është i ditëlindjes 1931, është i ditëlindjes 2008. Me sakrificë, njërin e tjetrin, atëherë kam shkuar në Ministrinë e Drejtësisë, e u kam thënë hiqni datëlindjen e 2008. Qofshi të nderuar tërë jetën tuaj. Më duhet të filloj shkollën, se jam i datëlindjes 2008. Por dua datën, ditën dhe muajin. Duhet certifikatë.

Këto janë marrina.

Kam qenë i pakënaqur. I pakënaqur sepse Teatrin e Shkodrës, godinën e komitetit tëpartisë shkuan e dogjën, Radio Shkodrën e dogjën, është gjynah të djegësh. 99% unë e kam shpëtuar. Të thyeje dyqanet? S'kishe çfarë t'u thyeje se dyqanet i kishin boshatisur, i kishin shitur teshat e cigaret. I boshatisën ushqimoret e tërë gjërat, boshatisën magazinat, shko merr kavanoza salce. Unë një cigare nuk e kam marrë. As një palë këpucë. Me gjysmë çizmesh kam qenë, çizme 100-lekëshe, që kishin dalë jashtë përdorimit... Ai që ka bërë dredhira ka fitue. Ka marrë pare, ka marrë hyrje. Unë nuk kam marrë as pare, as kam marrë hyrje, asgjë. Çfarë ka lerë falë zotit. As kam thyer dyqan. Protesta është në rrugë, jo të shkosh të thyesh dyqanin e komunistit. Komunisti e ka boshatis dyqanin. Ose e shoqja e oficerit, ose djali i oficerit, ose vajza e oficerit. Mbrojnë njëri-tjetrin, ia mbulojnë njëri-tjetrit, hanë bashkë e bëjnë fjalë. Hanë në darkë, bëjnë fjalë nesër. Drejtësi është vështirë të ketë!

**Por i jam lutur Zotit,
o Zot të iki nesër!
S'ka kurrfarë
shprese në këtë jetë!
Unë 25 vjet në burg,
robtë në internim,
çfarë shprese të kisha?**



Piktori – dëshmitar që me forcën e artit hedh dritë mbi të vërtetat e krimit komunist në kampin e Tepelenës. Dëshmi e dhënë nga Lek Pervizi, përjetues i gjithë kohës së persekutimeve e dënimeve të pjesëtarëve të familjes së tij, për të hedhur dritë dhe saktësuar më mirë kohën e dënimeve, të cilat mund të mungojnë ose figurojnë të pasakta në dokumentat e Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Brendshme si edhe në zyra të tjera që merren me këto çështje.

Lek Pervizi

Të mos harrojmë, se internimet e dëbimet janë bërë pa vendime gjyqësore dhe duke i hequr barbarisht njerëzit nga shtëpitë e tyre, vetëm me rrobat e shtatit e ngarkuar në makina pa emra e lista, ashtu “rifuxho”, si t’ishin thasë me lecka e jo qenie njerëzore.

Edhe t’arratisurit politikë shqiptarë që vdiqën larg atdheut përfshihen në viktimat e diktaturës komuniste.

Gjeneral Prenk Pervizi

Fisi i vjetër e fisnik i Pervizit të Skurajve të Kurbinit, ishte një fis i njohur e shumë i rëndësishëm, me besim katolik. Rrënjët e tij dallohen qartë që nga koha e qëndresës heroike kundër pushtuesit turk, në periudhën e Gjergj Kastriotit, të cilit i ndejti përkrah gjithë kohën e luftrave.

Ishte kjo rrënjë e lashtë patriotizmi arsyeja kryesore përse fisi i Pervizit u persekutua nga turqit, dhe një pjesë u shpërnda e u largua nga vendi, deri dhe përtej detit, në Venedik apo në Pulje të Italisë. Vite më pas fisi e mori veten përsëri dhe u bashkua me lëvizjen e Rilindjes kombëtare, ku shquhet i pari i fisit, Gjijn Pjetër Mark Pervizi i Skurajve, që i priu në ballë luftës anti osmane të Kurbinit e Krujës, me një qëndresë të armatosur deri në shpalljen e pavarësisë. Pikërisht me 28 Nëntor 1912, në mëngjes ai ngriti Flamurin Kombëtar në Milot, me 300 e sa luftëtarë vendas, duke mbajtur pranë nipin 15 vjeçar, Prenk Pervizin që do t'ishte pasardhës i denjë i tij.

Prenk Pervizi, i datëlindjes 4 Maj 1897, kreu shkollën e mesme në Shkodër më 1914, dhe Akademinë Ushtarake në Vienë më 1918, dhe hyri në shërbim të ushtrisë shqiptare si komandant operacionesh për dëbimin e serbëve dhe qetësimin e vendit nga bandat grabitëse dhe rebelizmi politik. Dallohet në të gjitha detyrat e ngarkuara. Përkrahu Zogun, me të cilin kishte lidhë miqësi qysh në Vienë, dhe i qëndroi Mbretit Zog pranë që nga fillimi deri në fund të Mbretërisë, duke ia

zgjodhur të gjithë situatat kritike që rrezikonin atë vetë dhe shtetin e ri shqiptar.

Më 1929-1934, vijoi e kreu Shkollën e Luftës në Torino, shkolla më e larta ushtarake, e u gradua kolonel. U ngarkua me misione përfaqësimi ndërkombëtar në Luftën e Abisinisë (1935-1936) e në Manovra ushtarake në Itali e gjetkë.

Me ngjarjet e 7 prillit 1939, kur sulmoi Italia fashiste, i pa njoftuar nga askush veç nga radiot e huaja, vendosi të organizojë luftën popullore. Por i doli detyrë të mbrojë e të përcjellë Mbretin në Greqi, e me urdhër të cilit u rikthye në Shqipëri. Në kohën e pushtimit qëndroi në dsipozicion. Kur ushtria shqiptare u përfshi në Luftën Italo-Greke, mori qëndrim dhe urdhëroi braktisjen e frontit nga ushtria shqiptare, nga i cili veprim italianët pësu- an një disfatë të madhe, dhe më pas, nga frika e incidentëve të tjerë më të rrezikshme, e hoqën ushtrinë shqiptare nga fronti, kurse Prenk Pervizin e izoluan në Pukë. U gradua gjeneral me qëllim të zbutjes së acarimit për shkak të frontit grek, gradim formal pa rol komandues.

Aprovoi vendimet e Mbledhjes së Mukjes. Më 8 Shtator 1943, kur kapitulloi Italia, mori dorëzimin e komandës italiane nga gjenerali Dalmazzo, dhe më shtator 1943 u emërua Ministër i Mbrojtjes me gradën Gjeneral Divisioni. Nuk e njohu lëvizjen e ashtuquajtur nacional-çlirimtare, duke e ditur se udhëhiqej nga komunistë të lidhur me politikën ju-

Regjimi komunist dënoi dhe persekutoi përjetësisht familjen dhe të gjithë rrethin e tij familjar, fisnor e miqësor

gosllave e ruse. U përpoq të organizojë ushtrinë kombëtare shqiptare, por gjeti kundërshtim nga gjermanët. Iu kushtua përforsimit të frontit të luftës antiserbe në Kosovë, ku shkoi vetë disa herë, për organizim, me qëllim që mbarimi i luftës ta gjente Kosovën të bashkuar me Shqipërinë.

Me kundërvenien e Prenk Pervizit ndaj gjermanëve, këta nuk mundën të krijonin trupa SS në Shqipëri, por nuk lejuan që të krijoheshin ushtritë efektive shqiptare nën komandën e gjeneral Prenk Pervizit.

Kundështar i vendosur i komunizmit, qëndroi dy vjet në mal, me shpresën të organizonte një qëndresë të armatosur, në bashkëpunim me nipin e tij Mark Gjomarkun, e me t'arratisurit të tjerë. Kështu, në shtator 1946, u arratis në Greqi, me një aksion të guximshëm personal që mori përmasa legjendare, për strategjinë dhe guximin që u krye. Kaloi në Itali ku i propozuan t'ia njohin gradat dhe t'i japin detyra të larta në ushtri, me kusht që të merret nënshtetësinë italiane, gjë që ai nuk pranoi. U largua për në Belgjikë ku u bashkua me miqtë e tij të vjetër, Muharrem Bajraktarin, e të tjerë patriotë.

U sëmur befasisht dhe vdiq më 6 shtator 1977. Gjithë mërgata shqiptare e Belgjikës dhe Francës e përcollën duke e nderuar dhe e varrosën në parcelën e heronjve. Jeta e tij shpreh dramën dhe tragjizmin e një jete që iu kushtua krejtësisht çështjes kombëtare, nga fillimi deri në fund.

Për këtë përkushtim ndaj çështjes kombëtare, regjimi komunist dënoi dhe persekutoi përjetësisht familjen dhe të gjithë rrethin e tij familjar, fisnor e miqësor. Mos rikthimi i pronave dhe mos njohja e shkatërrimeve që shkaktoi qeveria komuniste, mos shpërblimi i viteve të dënimeve të familjarëve që e kaluan gjithë jetën në kushte skëterre, ky ishte shpërblimi ndaj një figure madhore të historisë së Shqipërisë dhe përfaqësues i një familjeje të madhe, të përmendur e të nderuar.

Të gjitha familjet e tjera të mëdha që kishin dhënë kontributin e tyre gjatë shekujve në mbrojtjen e atdheut dhe në fitoren e pavarësisë pësuan të njëjtin fat nga diktatura sllavo-komuniste që sundoi në Shqipëri një gjysmë shekulli sa për 500 vjet të pushtimit turk, por edhe më e egër e anti-kombëtare.

Terrori komunist mbi familjen e Prenk Pervizit

Fillimisht brigadat komuniste morën urdhër të lëshuar nga vetë diktatori Enver Hoxha për të sulmuar drejt Veriut të Shqipërisë, duke vrarë, djegur e pjekur. Këto brigada, në shembullin e hordhive barbare të Mesjetës së hershme, sulmuan në Laç të Kurbinit, ku, në mesin e shtatorit 1944, dogjën shtëpinë e Gjeneral Prenk Pervizit me gjithçka kishte brenda. Kjo shtëpi ishte goditur më parë disa herë edhe prej gjermanëve me artileri. Djegia përfshiu bashkë me sende me vlerë antike e artistike, edhe dokumenta të rëndësishme shekullore të familjes dhe të historisë së krahinës e të Shqipërisë. U plaçkitën pasuritë dhe gjëja e gjallë si dhe u konfiskuan të gjitha pronat tokësore.

Ditën e vdekjes së Skënderbeut, më 17 janar 1945, sulmuan edhe në fshatin historik të Skurajt ku dogjën tre palë ndërtesa të tjera që njiheshin si “Kullat e Gjini Pjetër Pervizit”, udhëheqës popullor, patriot e luftëtar i shquar, të djegura dy herë rresht prej turqve dhe që u dogjën kësaj here për së treti nga barbarët e kuq sllavo-ruso-shqiptarë. A ishte rastësi data? Njëra nga kullat ishte e Prenk Pervizit, dy të tjerat të kushërinjve, që u përfshinë edhe ata në valën e persekutimit. Burrat kishin marrë malin për të mbrojtur lirinë si dikur të parët e tyre përkrah Skanderbeut. Familjet e tyre u internuan bashkë me familjen e Gjeneralit, e disa prej tyre vdiqën në kushtet e internimit. Të tjerë u vranë e u pushkatuan. Njëkohësisht, në Tiranë, u konfiskua shtëpia-vilë dhe dy troje në qendër të kryeqytetit, etj., që nuk i janë kthyer akoma të zotëve.

Ky ishte terrori komunist mbi familjen dhe fisin e Gjeneral Prenk Pervizit, për ta shfarosur përfundimisht këtë familje si një nga kolonat e kombit shqiptar, me rrënjë të thella shekullore lidhur me emrin fisnik prestigjioz të Skurajve e hynte në rradhën e familjeve të mëdha të mbetura me dëshmi të dokumentuara në historinë e Shqipërisë e të kombit shqiptar, familje që provonin autoktoninë e kombit dhe luftën e pashterur të shqiptarëve për liri.

Më poshtë jepet një pasqyrë e detajuar për persekutimin e anëtarëve të familjes dhe të fisit me vitet e dënimeve faktike, të kaluar në gjendje dënimi, në kundërshtim me dokumentet e zyrove shtetërore, që tallen me fatin e atyre që sakrifkuan gjithçka për atë liri dhe demokraci që u kthyen pas një gjysmë shekulli, shqiptarve.

TERROR NË KATËR BREZA

Errok Prend Pervizi
(*djali i Gjin Pjetrit*)
Luftëtar i Pavarësisë



Martuar

Mrika Pervizi
(*internuar 5 vjet*)

Vdes në internim,
Berat në vitin 1950



*E ëma e Gjeneral
Prenk Pervizit dhe
gjyshja e Lek Pervizit*

**Gjeneral
Prenk Pervizi**
(*Lindur më 4 maj 1897*)

Objekt sulmesh nga
regjimi komunist.
Arratiset në Greqi
në vitin 1946.
Vdes më 6 shtator
1977 në Belgjikë

*Martuar
3 Djem*



Prenna Pervizi
(*internuar 32 vjet*)

Vdes në internim,
në Plug, më 1977

Valentin Pervizi
(*internuar 47 vjet*)

Oficer, vdes më 1999
në Itali pas ribashkimit
me gruan italiane



*Djali i
Madh*

Gruaja e Lek Pervizit

Gjulia Pervizi
(*internuar 42 vjet*)

E bija e Nikoll Prek Malaj,
jeton në Belgjikë nga 1990



**Lek
Pervizi**
(*internuar
40 vjet*)

*Martuar
3 Fëmijë
lindur në
internim*

*Djali i
Mesëm*



Genç Pervizi
(*internuar
43 vjet*)

Aviator,
Vdes më 1989
në Gradishtë
të Lushnjës

*Martuar
6 Fëmijë
lindur në
internim*




Albina Pervizi
(*internuar
40 vjet*)

E bija e Major Llesh
Marashit, i ekzekutuar
në Shkodër. Vrarë
edhe dy vëllezër

*Djali i
Vogël*

*Djali i vogël
i Gjeneral
Prenk Pervizit,
Lek Pervizi,
dëshmitari dhe
përjetuesi i
gjithë kohës së
persekutimeve*



Pjestarë të familjes që u dënuan me burgje e internime, ku disa vdiqën dhe të tjerët e kaluan gjithë jetën në dënime.

Mrika Pervizi, nëna e Gjeneral Prenk Pervizit, **5 vjet internim**, internuar në Berat e Tepelenë në 1945-1950 ; vdiq në internim në 1950 në moshën 90 vjeçe. **Nuk i gjendet varri.**

Nënë Mrika ishte nga ato gra, që, si nga familja ku lindi ashtu tek ajo që u martua njohu luftën kundër turqve dhe qëndresën e Kurbinasve me Gjini Pjetër Pervizin e Skurajve në krye. Qendroi pranë luftëtarëve në rrethimin e Skurajt, për t'i furnizuar me municione, ushqime dhe kujdesur për të plagosurit. Turqit i kishin djegur edhe shtëpitë prindërore kur ishte vajzë më 1881. Dëshmitare e gjallë e asaj kohe heroike, e nderuar dhe e respektuar prej të gjithëve, si në jetën e lirë ashtu edhe në kushtet e kampit të Tepelenës ku vdiq si martire e lirisë.

Prena Pervizi, 32 vjetë internim. Një grua me ndjenja të larta patriotike, që përballoi me krenari si jetën e lirisë ashtu edhe atë të dënimeve ndër kampet e internimit, veçanërisht të Beratit, Tepelenës e Porto Palermos ku ishte mbyllur, bashkë me dhjetra familje të mëdha e me mijëra të internuar të tjerë. Kurajoze dhe e vendosur, ishte mbështetja morale e gjithë grave e vajzave të reja, që diktatura kishte pllakosë në ato rrahë skëterore, ku disa prej tyre lanë jetën ose u mplakën pa krijuar familje dhe ku, një pjesë e tyre, humbën fëmijët që vdiqën aty prej vuajtjeve, mjerimit e sëmundjeve, viktima të pafajshme.

Valentin Pervizi, 47 vjet burgim- internim, djali i madh i Preng Pervizit, officer, kishte kryer studime akademike në Itali, në periudhën 1927-1942; I burgosur në Shkodër, 1944-1946; internim, në Berat, Porto-Palermo, Tepelenë, Çorovodë, Lushnje 1946-1954; Izolim në kampet e Shtyllasit të Fierit e Kuçit të Vlorës, 1954-1958; Internim në Gradishtë të Lushnjës, 1958-1991.

Pas 47 vjet bashkohet me të shoqen në Bolonja të Italisë, ku jeton e vdes më 1999. E shoqja, Gorizia Manini, vdes më 2004. Nuk patën fëmijë. Një shpresë e ardhme e ushtrisë shqiptare, officer i dalur nga shkollat ushtarake dhe akademitë e Italisë për t'i shërbyer atdheut, por që shteti ko-

munist nuk ia njihte meritat, si shumë të tjerëve kolegë të tij, dhe e degdisi në burgje e kampe për 47 vjet rresht, duke e ndarë edhe nga gruaja italiane për po aq kohë. I sprovuar në luftë kundër gjermanëve në mbrojtjen e Romës ku ishte caktuar me detyrë si komandant reparti tankist. Në tetor 1944 u kthye në Shqipëri për t'i shërbyer vendit, në dhjetor 1944, u arrestua e u burgos, dhe nuk doli më nga ajo gjendje dënimi, burgu e internimi për 47 vjet. Shembull qëndrese në ato kondita dënimi, e frymëzues i të rinjve për t'i bërë ballë terrorit e torturave të diktaturës. I pamposthur gjithmonë, u jepte zemër të tjerëve si një hero i vërtetë i asaj qëndrese e lufte të heshtur kundër ideologjisë shtypëse të atij regjimi totalitar e kriminel.

Genc Pervizi, 43 vjet burgim-internim, djali i mesëm i Preng Pervizit, aviator, arsimuar në Itali (1929-1944) ; U burgos në Tiranë e më pas në kampe pune për 10 vjet, 1947-1957 ; Internuar në Savër e Gradishtë të Lushnjës më 1957 deri 1989, ku vdiq.

Edhe Genci studioi e u formua në Itali ku kreu shkollën e aviacionit në Forlì, më 1943. I përfshirë në valën e terrorit komunist u arrestua dhe u dënua 10 vjet me burg, pasi kaloi disa muaj hetuesi të tmerrshme. Edhe më pas ai nuk njohu asnjë ditë lirie, sepse gjithë jetën e kaloi i internuar në kampin e Gradishtës së Lushnjës tok me familjen Pervizi plot 33 vjet, gjersa vdiq. Ky djalë me kulturë, por edhe trim, mori pjesë në organizimin e arratisjes së të atit, Gjeneral Prenk Pervizi, me mençuri e vendosmëri të pashoqe. Edhe pse u torturua, qendroi i pathyeshëm dhe i vendosur, si një shqiptar i mirë dhe si një pinjoll i një familje fisnike e patriote që kishte dhënë prova të lavdishme qëndrese kundër pushtimit turk, ashtu si edhe kundër regjimit komunist.

Albina Pervizi, 40 vjet internim, e shoqja e Gencit. E bija e Major Llesh Marashit, ekzekutuar me varje në Shkodër. Internuar në Berat në vitet 1945-1946, pastaj në Fier në vitet 1952-1958 e në Gradishtë në vitet 1958-1991.

156 vitet e dëbimit të fëmijëve : Që në moshën feminare internohet në Berat, më 1945 dhe, më vonë, në Fier e Gradishtë të Lushnjës, si vajzë e Majorit Llesh Marashit dhe si e reja e

Prenk Pervizit, Duke qëndruar gjithmonë e vendosur dhe duke u përballuar me sakrificë e mundime të mëdha tërë jetën për rritjen e fëmijëve në ato kondita të mjerueshme. Babain ia vranë. Një vëlla, dënuar me 20 vjet burg, vdiq sakat me këmbë të prera. Një vlla tjetër ia vranë në Paris agjentet e sigurimit. Çifti pati gjashtë fëmijë, dy vajza e 4 djem, lindur e rritur në kampin e internimit të Gradishtës. Ato kaluan pas '91 në Amerikë, dhe jetojnë në New York.

Lek Pervizi, 40 vjet burg internim, djali i vogël i Preng Pervizit, mbaruar shkollën fillore e të mesme në Romë në periudhën 1936-1944; I dëbuar më 1945-50. Internuar në Porto Palermo, Tepelenë, Lushnje, 1950-1954; Izoluar në Shtyllas të Fierit e Kuç të Vlorës, 1954-1958; Internuar në Gradishtë e Pluk të Lushnjes, 1958-1990.

I përfshirë që në moshën 15 vjeçare në valën e terrorit komunist, fillimisht mbeti në Tiranë. I përjashtuar nga të gjitha shkollat, me prishjen me Jugosllavinë, arriti të futet me konkurs në Liceun artistik, më 1948, ku menjëherë u dallua për talentin e tij të spikatur. Por, kështu nuk mendonte as partia e as qeveria dhe më 1950 arrestohet, e pasi kalon birucat e sigurimit degdiset e mbyllet me gjithë vëllanë e madh, Valentinin, në burgun-kala të Porto Palermos. Pastaj në kampin e Tepelenës dhe në Kuç të Kurveleshit, ku ishin izoluar elita e mbetur gjallë e intelektualëve të fundit shqiptarë të para luftës. Kaloi gjithë jetën në internim deri më 1990, duke u shquar për qëndresë, dallohet, ndonëse i dënuar, si piktor e poet i ndaluar.

Lek Pervizi është nga dëshmitarët e rrallë, është piktori që vuajti internimin në kampin e Tepelenës dhe që me talentin e tij, skicoi planimetrinë e kampit të Tepelenës, tablo-skica të mjedisit të brendshëm të kampit dhe të të internuarve, disa tablo për ngjarjet e rënda të ndodhura në kamp realizuar drejtpërdrejt aty, duke i kthyer ato në një instrument të së vërtetës së hidhur të krimit komunist të mbuluar për vite e vite në Tepelenë. Ky fakt, që piktori ka qenë ipranishëm, pra, bashkëvuajtës dhe që skicat-tablo janë realizuar drejtpërdrejtë kur ka ndodhur ngjarja, ka vlerë të jashtëzakonshme, sepse ato luajnë rolin e fotografisë së kronikës apo filmimit që nuk mund të ishin të pranishëm. Tablotë –skica të piktorit Lek Pervizi janë një dokument unikal në shkallë

kombëtare e ndërkombëtare, që nxorrën në dritë kampin e tmerrshëm të Tepelenës.

Pasi përfundoi mbylljen në kampe, ai vijoi internimin në fushat e Myzeqesë, në Pluk të Lushnjes, ku u martua, në 1965, me një vajzë gjithashtu të internuar, Gjulina Malaj, nga Vermoshi, ish fëmijë- foshnje e kampit të Tepelenës, të cilën, për faktin se shpëtoi për mrekulli nga vdekja, e mbiquajtën dhe vazhduan ta thërresin Beba, ndër të rrallat bebe që i shpëtoi vdekjes që kositi njëherësh shumë foshnje të tjera.

Gjulina Pervizi, 42 vjet internim –debim, e shoqja e Lekës. E bija e Nikoll Prek Malaj, i arratisur politik jashtë shtetit më 1948; Internim në kampin e Tepelenës, nga 1948-1954, në Plug të Lushnjes, internim dëbim, në periudhën 1954-1990.

72 vitet e dëbimit të fëmijëve: Pas kampit të Tepelenës, ku Gjulina ishte një nga fëmijët që i shpëtoi vdekjes dhe për këtë arsye e mori emrin Beba, ajo e kaloi gjithë jetën në Pluk të Lushnjes, ku ishte internuar me të ëmën. Aty u martua me Lek Pervizin, duke siguruar përfundimisht dënimin e saj deri më 1990, vit që shënoi rënien e diktaturës, fillimin e demokracisë dhe kur u mundësua që ajo të largohet familjarisht për në Belgjikë. Gjatë asaj kohe pësoi edhe një demaskim e gjyq para popullit, ku vërtet i shpëtoi burgut, por u damkos me epitelin armike (!). Çifti pati tre fëmijë, djem, lindur e rritur në kampin e Plukut deri më 1990, kur u larguan për në Belgjikë.

Zorka Malaj, 21 vjet internim, nëna e Gjulianës, vjehrra e Lek Pervizit, internuar me të bijën në Berat e Tepelenë nga 1948-1954, për arratisjen e burrit të saj, Nikoll Malaj. Internuar në Pluk të Lushnjes në vitet 1954-1969; Dëshmitare e tmerrit të kampit të Turanit ku vdiqën 33 fëmijë në një natë, e shumë të tjerë, pothuaj gjithë fëmijët e shoqeve te saja nga Vermoshi.

Duke mos rezultuar me nënshtetësi shqiptare, por malazeze, familja dhe vëllai i të shoqit (i dyti, vdekur në Pluk) arritën ta tërheqin dhe kështu u largua nga Shqipëria për në Mal të Zi, ku kishte prindërit, në 1969 dhe pastaj në Belgjikë, ku kishte vjehrrin e vajzës së saj, Gjeneral Prek Pervizin. Por 21 vjet i kaloi në kushte internimi.

482 vjet dërr

Shuma e përgjithshme e dënimeve, për gjithë familjen dhe fisin e Gjeneral Prenk Pervizit arrin në 750 vjet, shtatë shekuj e gjysmë!

burg e inter

Shuma e përgjithshme e dënimeve, për gjithë familjen dhe fisin e Gjeneral Prenk Pervizit arrin në 750 vjet, shtatë shekuj e gjysmë!

trungut fam

Me të njëjtën egërsi, regjimi enverist komunisto-sllavist goditi familjet veriore dhe familjet e tjera që u internuan duke u trajtuar si “armiqtë e popullit”

të Prenk Pe

Internim me

Vitet e dënimeve, ku përfshihen ato të burgjeve, të internimeve dhe të dëbimeve janë si më poshtë :

482 vjet dënime me burgje, internim e dëbim vetëm për trungun familjar të Gjeneral Prenk Pervizit.

Kushërinj e nipa të Gjeneral Prenk Pervizit, të vrarë, pushkatuar e vdekur në burgje për arsye

Internime

politike e qëndrese të vendosur antikomuniste, luftëtarë e dëshmorë të lirisë janë si më poshtë :

Zef Gjok Pjetri vrarë nga Sigurimi i Shtetit më 1946.

Pjetër Mark Pjetri pushkatuar nga partizanët më 1945.

Familjar

Ndue Pal Gjini vrarë nga Sigurimi më 1952.

Gjin Pal Gjini vdekur në Tepelenë më 1951.

Nikoll Pal Gjini vrarë nga UDB në Prishtinë më 1950.

Ndue Gjergj Lleshi vrarë nga Sigurimi më 1951.

Pervizit

Mhill Gjergj Lleshi pushkatuar në burgun e Tiranës më 1949.

Preng Llesh Gjergji vrarë nga Sigurimi më 1952.

Zef Hyseni vrarë nga Sigurimi më 1951.

Të gjitha familjet e këtyre, gra e fëmijë, pleq e plaka, u mbajtën në internim në kampin e Tepelenës deri në vrasjen e burrave, nga 1945 deri 1952, por edhe në vazhdim, të persekutuar egërsisht në krahinën e tyre.

Pavarësisht nga mbiemrat e ndryshëm ata i përkasin fisit Pervizi.

Janë burgosur edhe disa kushërinj të tjerë 10-12 veta, me afro 40 vite dënime.

Pati dhe dy gra e dy fëmijë të kushërijve që vdiqën në kampet e Beratit e të Tepelenës.

Shuma e përgjithshme e dënimeve, për gjithë familjen dhe të fisin të Gjeneral Prenk Pervizit arrin **në 750 vjet, shtatë shekuj e gjysëm !**

Viktimat e vërtetuara janë 23 vetë, të vrarë, pushkatuar e vdekur në burgje e kampe, prej tyre pesë gra e pesë fëmijë.

Këto fakte jetësore të familjes së Gjeneral Prenk Pervizit, janë dëshmi e saktë për egërsinë, barbarinë dhe urrejtjen antishqiptare e antikombëtare me të cilën regjimi enverist komunisto-sllavist goditi një nga familjet shekullore atdhedashëse e kombndërtuese shqiptare.

Me të njëjtën egërsi, regjimi enverist komunisto-sllavist goditi të gjitha familjet veriore dhe familjet e tjera që u internuan duke u trajtuar si « armiq të popullit » pikërisht ata që ishin thelbi i kombit dhe i atdhedashurisë.

Dëshmoi Lek Pervizi, djali i vogël i Gjeneral Prenk Pervizit, i mbijetuar, sot 89 vjeç, në kuadrin e njohjes së krimeve të komunizmit dhe krimet e bëra mbi familjet e mëdha të Shqipërisë, ndër të cilat ajo e Pervizit është ndër më të masakruarat.

Lek Pervizi, Bruksel, më 20 korrik, 2018



“Kampi i Tepelenës u inauguruua me vdekjen e prindërve të mi” Seit Petrela

INTERVISTOI: MIRA TUCI

Më quajnë Seit Fadil Petrela, i datëlindjes 25 shtator 1947. I kam kaluar 70 vjet. Babai, Fadil Petrela, ishte biri i Selman Agë Petrelës. Nëna ime quhej Xhuma Petrela Kupi, e bija e Abaz Kupit.

Menjëherë pas çlirimit, me një dëshmi nga Ministria e Drejtësisë, të cilën ne e disponojmë, vërtetohet që më datë 4 dhjetor të vitit 1944, pra, 5 ditë pas datës së “çlirimit”, 29 nëntor 1944, babai im u arrestua, kurse gjyqi u zhvillua në gusht-shtator të 1946: E dënuan me 2 vjet burg. Babai doli nga burgu në vitin 1946. Në këtë periudhë gëzimi pas kthimit nga burgu, ishte fati im të vija në jetë në shtator 1947.

Por as gëzimi i lirimit nga burgu, as gëzimi i ardhjes në jetë të një fëmije tjetër nuk zgjatën shumë, sepse në janar të vitit 1949, për arsye të kësaj biografie të familjes, të kësaj prejardhje familjare, na internuan në kalanë e Beratit. Aty kishte edhe shumë familje të tjera të internuara. Qeveria e asaj kohe nuk u mjaftua me burgun për babain, por dënoi edhe gjithë familjen me internim.

Unë isha pak më shumë se 1 vjeç, pra, nuk jam dëshmitar okular i ngjarjes, por janë shumë ngjarje të faktuara me dokumente dhe fakte të tjera tragjike të pakundërshtueshme si vdekja, që nuk kanë nevojë të provohen nga dëshmitarë okularë.

Kemi ndenjtur në Berat deri me datë 13 maj 1949. Me datën 13 maj të 1949, vonë në mesnatë pothuaj, erdhi një autokolonë me shumë mjete, kamionë, dhe sipas një vendimi të gjithë të internuarit në Berat, Kuçovë, etj, do të përqendroheshin në kampin famëkeq të Tepelenës. Rrugës nga Berati për në Tepelenë, duke ndjekur rrugën malore nga Urë e Goricës që vazhdon në Këlcyrë, njëra nga makinat që ishte në autokolonë, në të gdhirë të datës 14 maj të 1949 gremiset në humnerë. Nga ky aksident automobilistik, prindërit e mi humbën jetën.

Në ato rrethana, duke qenë se ishte natë, ishte udhëtim për në kamp, me shumë vështirësi, siç dëshmojnë pjesëtarët dëshmitarë okularë të kësaj ngjarje te dhimbshme, me mjete rrethore siç vërtetohet edhe në një vendim gjyqi i zhvilluar në vitin 1994, për të dëshmuar për këtë fakt që ka ndodhur, varrimi ose groposja e prindërve të mi është bërë me mjete rrethore. Dikush ka thënë një shprehje “kemi hapur varret me kapakë tenxheresh”, duke mos patur veglat e nevojshme për atë punë.

Pasi është kryer ky rit, autokolona ka vazhduar rrugën dhe kemi përfunduar në Tepelenë. Në makinë me ne ka qenë edhe gjyshja ime dhe halla, motra e babait, e cila, ishte vajzë në moshë, por ende e pamartuar, prandaj quhej se bënte pjesë në familjen prindërore tok me vëllain. Kështu edhe ajo u dënua së bashku me gjithë familjen. Nga aksidenti gjyshja pësoi goditje në shtyllën kurrizore dhe e nisën për në spitalin e Gjirokastrës, e më pas mbeti uloke. Halla ime pësoi tronditje të fortë nervore nga tragjedia që goditi familjen dhe vuajti tërë jetën nga shqetësime të tilla. Deri në fund të jetës, 6-7 vite më parë, ajo kishte tmerr të hypte në makinë.

Nga familja ime në Tepelenë mbërritëm vetëm ne, 4 fëmijë dhe halla. Prindërit i varrosën rrugës, kurse ne si fëmijë, duke u rritur e duke kuptuar, na ka munduar mendimi se ku ishin varret e prindërve. Vëllai i madh, Bujari, që për mua u bë edhe babë, edhe nënë, pra, gjithçka, me iniciativën e tij, duke qenë që diçka mbante mend, e ka fiksuar pamjen e vendit. Mbi ato varre kishte vetëm një gur si shenjë.

Ne e kishim dëshirën e pashuar për të gjetur vendin ku preheshin prindërit tanë fatkeqë, që edhe neve na lanë në mes të internimit, por ishim shumë

të vegjël dhe pa asnjë përkrahje. Rreth vitit 1971 apo 1972, për të mirën tonë, një banor i asaj zone, të cilit i jemi mirënjohës për gjithë jetën, na njoftoi se po hapeshin tokat e reja në zonën ku kishte ndodhur aksidenti dhe ku ishin varrosur prindërit tanë dhe nga kjo gjë do zhdukeshin shenjat e varreve. Atëherë, vëllai me një mikun e tij, që nuk gjejmë fjalë ta falenderojmë përjetësisht, shkuan natën, gjetën varrin, i nxorrën nga varri eshtrat e prindërve dhe i sollën në shtëpi. Për një kohë të gjatë i kemi mbajtur në shtëpi eshtrat e prindërve, se kuptohet, në atë kohë ishte e pamundur edhe mundësia e varrimit ligjor, ngase ata vazhdonin të ishin të dënuar (!).

Me mundësinë e një mikut tonë që punonte në atë kohë në varreza, i varrosëm për të pasur një shenjë përgjithmonë, pa vendosur emrin te kryet siç është zakon, pra, pa ditur njeri se çfarë ishte ai varr. Më vonë, me kalimin e kohës, përmirësua pak varrin, derisa erdhi koha që u bë e ligjshme që ata të kishin një varr me emrat e tyre sipër. Sot, prindërit e mi prehen pranë njëri-tjetrit, me kujdesin tonë për ato varre.

Vëllai i madh që është për mua gjithçka, quhet Bujari, i datëlindjes 1938, dhe në fund të këtij viti ai feston 80-vjetorin; Vëllai i dytë, Ylber, i datëlindjes 1942, para tri ditësh ka festuar 76-vjetorin; vëllai i tretë Halil, është 74 vjeç; Unë i kam kaluar të 70, po afrohem të 71.

E vërteta është se kam qenë në kampin e Tepelenës në një moshë që nuk kuptoja asgjë. Edhe vëllai im më i madh, Bujari, ishte tejet i vogël. Kur kam dashur të mësoj ndonjë gjë më shumë si më i vogli dhe më fatkeqi në këtë fatkeqësi, nuk kam mundur t’ia nxjerr dot nga goja. Ai ka qenë në një moshë që e ka kuptuar vdekjen e prindërve, aksidentin e gjyshes, ka kuptuar që ne papritur mbetëm fare vetëm 4 fëmijë jetimë, mes një kampi me të internuar, 4 fëmijë nga të cilët njëri pothuaj foshnje mes një turme të internuarish! Çfarë duhet të them më? Kishim ndonjë faj? Vëllai ka pësuar tronditje të thellë, prandaj ai nuk flet, nuk i bën zemra. Ishte ai që kujdesej për ne.

Pastaj, ne kemi ndenjtur në kampin e Tepelenës vetëm dy javë e pak, sepse edhe vetë drejtuesit e kampit e panë të pamundur të kujdeseheshin për 4 jetimë. Gjyshja jonë, pra, nëna nga babai ishte në spital e paralizuar, motra e babait pësoi krizë

...prindërit e mi humbën jetën. Groposja e tyre është bërë me mjete rrethanore. Dikush ka thënë një shprehje “hapëm varret me kapakë tenxheresh”

nervore. Mendoj që, për aq kohë, të gjithë ata njerëz që na njihnin, janë kujdesur për ne me aq sa kishin mundësi.

Ne na mori në kujdestari xhaxhai i babait, Gani Petrela, atij iu dha e drejta nga organet e pushtetit, jo se ai e bëri, vullnetin e kishte, por nuk kishte shumë mundësi. Erdhëm në Tiranë tek xhaxhai i babait, por edhe ai pati pjesën e vet të fatkeqësisë. Edhe xhaxhai i babait, Gani Petrela, nga viti 1951 u dënua me burg; U dënua për mos kallëzim të vëllait të tij, domethënë të gjyshit tim, i cili vazhonte të ishte i dënuar që nga viti 1945, por faktikisht ai kishte 6 vjet që fshihej i strehuar në një shpellë tek një miku i tij nga Zall Herri. Kur u mor vesh që gjyshi im ishte gjallë, atëherë dënuan edhe vëllain e tij, pra, xhaxhain e babait, për mos kallëzim të të vëllait të vet te organet e pushtetit. Vëllain e gjyshit e dënuan 12 vite; ai kreu 10 vite. E nxorrën në vitin 1962. Mesa duket kishte qenë shumë i sëmurë në burg, sepse jetoi vetëm 1 muaj pas lirimit dhe vdiq.

Kështu kaloi jeta jonë nën kujdestarinë e njerëzve të afërm, hallat, dy motrat e babait, te njerëzit e mi në Lushnje, se në atë kohë ishin të internuar në kampet e Lushnjes, Gradisht, Grabian, Savër, Plug. Atje kaluam një pjesë të jetës.

Nga familja e babait tim, në burg ka qenë babai dhe xhaxhai i babait, që e përmenda më lart Gani Petrela. Nga familja e nënës në burg ka qenë daja im, Fatbardh Kupi, i biri i Abaz Kupit, si edhe njëra nga tezet, Hyjrie Kupi Dosti, pikërisht sepse ishte e shoqja e Viktor Dosit. Dy dajat e tjerë u larguan nga Shqipëria bashkë me të atin, Abazin, në 1944. Në Shqipëri mbeti vetëm njëri dajë, Fatbardh Kupi, i cili gjithë jetën e tij e kaloi në burgje e internime.

Teze Hyjria ka qenë në burgun e Tiranës tek Fabrika e Tullave. Daja ka lëvizur burgjeve gjithandej: në Maliq, në Qafë Bari, në Tiranë, në Ballsh, nga viti 1944 – 1990, pra, plot 46 vjetë. Praktikisht kaloi gjithë jetën në burg-internim, hyri djalë fare i ri, doli plak pa fuqi.

**Për një kohë
të gjatë i kemi
mbajtur në
shtëpi eshtrat
e prindërve, se
ishte i pamundur
varrimi ligjor,
ngase ata
vazhdonin të
ishin të dënuar**



PRINDËRIT E SEIT PETRELËS, FADIL DHE XHUMA PETRELA

I jam mirënjohës gjyshes sime nga babai, Alie Petrela, që me stociçizëm na rriti, na edukoi dhe u bë busull e jetës sonë, jetë të cilën, në katër vëllezërit e kemi justifikuar me sjelljen tonë, me punën tonë dhe me qëndrimet tona. Mirënjohje për dy hallat e mia, Kaje Vorpsi Petrela, të cilën e patëm edhe në internim në Tepelenë dhe Vaje Këllezi Petrela, e cila ishte martuar qysh më parë, prandaj shpëtoi nga internimi në Tepelenë. Ato janë kujdesur për ne, barabar me fëmijët e tyre, pavarësisht se të dyja në familjet e tyre kanë patur probleme e vështirësira. Dhe ne i kemi patur si prindër. Sa i takon gjyshes nga nëna apo tezet, ato, si familje e Abaz Kupit ishin të internuara dhe të shenjua si armike të betuara të partisë e popullit! Ato, me aq sa mundeshin, na mbanim në stinën e verës. Na kanë mbajtur pranë me shumë dashuri dhe dhembshuri.

Thonë, sytë shohim më mirë pas lotimit. Pas asaj që hoqëm, ne shikonim shumë më mirë! U bëmë shumë të kujdesshëm edhe pse e dinim se ishim nën vëzhgim. Por me mënyrën se si u sollëm, me mënyrën se si punuam i detyruam njerëzit të na vlerësonin.

Për mua dhe vëllezërit e mi kanë qenë njerëz të mirë ata që nuk na kanë rënë në qafë, sepse me kushtet në të cilat u rritëm, nuk kishim ndonjë pretendim që të na ndihmonin. Boll një qëndrim, një vlerësim i asaj që isha, për mua ishte mjaftueshëm.

Pas rënies së diktaturës kam punuar në Ministrinë e Brendshme nga viti 1994 deri në 2004. U largova me dëshirën time për arsye shëndetësore, pasi u operova tri herë dhe me shëndetin e lig,

nuk e përballoja dot ngarkesën e punës.

Kampi i Tepelenës, me vendim qeverie njihet si kampi i telave me gjemba, është barazuar me burgun. Pra, prindërit e mi quhet që kanë vdekur në burg dhe deri tani nuk kemi marrë akoma asnjë kompensim! Jemi interesuar, kemi plotësuar çfarë kërkohet. Ka pasur disa pengesa, për dosje të vonuara, do shihet... Por, nuk na është thënë ndonjëherë që nuk e meritoni.

Është fakt se kampi i Tepelenës u inaugurua me vdekjen tragjike të prindërve të mi, dhe unë foshnjë tok me vëllezërit jetimë brenda në të!

Beso, me kaq, i kam thënë të gjitha. Me këtë intervistë që dhashë nuk bëj rolin e viktimës, as të detyroj ndokënd që, si të thuash, të mbushë sytë me lot me jetën time. Do kisha përballuar shumë më tepër se kaq vuajtje, vetëm të kisha ndër një dorë nëne apo babai mbi kokë. Pra, peng i jetës sime, janë prindërit e mi.

Arsyeja është Fakulteti Suprem, është diploma supreme që zoti i ka dhënë njeriut dhe ia ka dhënë njeriut arsye që me të, të mposhtë ngulçet e zemrës, dhe t'i nënshtrohet asaj që është më e drejta dhe më e mira. Nuk mund t'i imponosh dikujt të të thotë "më fal". Më duaj me zor, në këtë botë, nuk ka!

Në mendësinë time fjala *intelektual* nuk cilëson një njeri që merr një diplomë, siç thuhet rëndom duke e turpëruar vetë intelektin. Të qenët *intelektual* lidhet pazgjydhshmërisht me cilësitë *i njerëzishëm*, pra, *zemërmadh*, *i drejtë*, *i ndershëm*. Uroj që kjo mendësia ime të mirëkuptohet, sepse kështu mund të njihet ç'qenë këto fatkeqësi tonat, që ato të mos përsëriten kurrë më.

Të ecësh përpara, është gjëja më e mirë, por të ecësh pa e kujtuar të shkuarën, gjithmonë do kesh ndonjë mangësi. Nëse ju më pyesni, a ka të ardhme vendi im, është kjo bindje që më ka mbajtur në Shqipëri pas vitit 1990, megjithëse i kisha të gjitha mundësitë për të emigruar. Kam pasur dëshirë të rri në këtë vend dhe me punën time të ndiej se po e vendos një tullë, që ai që do të vijë pas meje, të mos heqë tullën time, por të vejë edhe ai një tjetër mbi të. Kështu tullë, tullë mund të ngrihet ky vend.



“Tronditjen
shpirtërore që ka
kaluar nëna ime e di
vetëm ajo...për mua
sakrifikoi jetën”

Eugen Merlika

B

Babai im kishte studiuar inxhinieri elektrike në Granobël të Francës, ndërsa nëna letërsi në Universitetin e Napolit, laureuar me notë maksimale, në moshën 21 vjeçe, prandaj kishte shumë perspektivë në fushën e saj. Relatori që ka qenë filozof italian, Rodolfo Amadeo, i pati ofruar mbështetjen që, nëse qëndronte në Itali, brenda 10 vjetëve do ta merrte në katedër. Ajo ishte 21 vjeç dhe në moshën 30 vjeçe të arrije këtë ishte një gjë e jashtëzakonshme. Por ajo u kthye. Dha një vit mësim në liceun e Barit, në të cilin kishte qenë vetë nxënëse deri para 4 vjetësh.

Përmes miqësisë që kishte babai i saj Sotir Gjika, gazetar i njohur, me gjyshin tim, Mustafa Krujën, i cili ishte kryeministër i Shqipërisë, mamaja u njoh me babain tim dhe krijuan familje.

Pas luftës filluan problemet. Babai punonte në ministri si përgjegjës për marrëdhëniet me ndërmarrjet italiane që kishin punuar në Shqipëri: të përcaktonte me to shpenzimet që ato kishin bërë për shtetin shqiptar, për të cilët shteti shqiptar ishte debitor, ishte borxhli për këto gjëra.

Në marsin e 1946 e arrestuan edhe babain për shkak se ai kishte diskutuar me disa vetë për krijimin e një partie opozitare liberale. E dënuan me 15 vjet burg. Familjen tonë, pra, gjyshja, nëna ime dhe unë, e shpërngulën. Babai ka qenë në Burrel, në Orman Pojan, në Tërbuf. Është liruar nga Burreli në 1960.

**Babai im kishte
studiuar inxhinieri
elektrike në Granobël të
Francës, nëna letërsi në
Universitetin e Napolit.
Në marsin e 1946 e
arrestuan babain. E
dënuan me 15 vjet burg.
Familjen tonë, pra,
gjyshja, nëna ime dhe
unë, e shpërngulëm.**

Nga vjeshta e 1947 na dërguan vendin e njohur si Katër rrugët e Shijakut, në një kasolle ku nuk kishte asnjë orendi të nevojshme për jetesë. Njerëz të farefisit tonë, na morën dhe na çuan në Krujë, ku u strehuam disa kohë. Pastaj erdhi vendimi i internimit nga Ministria e Punëve të Brendshme pa përcaktuar vendin se ku. Kampet e internimit ishin ngritur dhe funksiononin: jugorët i çonin në veri, në Krujë, ndërsa veriorët i çonin në jug, në Berat, Gjirokastrë.

Ne na mbajtën në një qeli të seksionit të degës së brendshme të Krujës. Ishin dy familje aty, ne dhe familja e Abaz Kupit. Aty kemi ndenjur disa muaj. Aty kam filluar edhe shkollën, në moshën 5 vjeç. Mbaj mend, vinte mësuesja më merrte përdore dhe më çonte në shkollë. Mësuesja ime e klasës së parë. Në drekë më sillte prapë aty. Hapej dera e hekurit dhe më fuste prapë. Kjo vazhdoi disa muaj, bile më shumë se një vit.

Në nëntorin e vitit 1949 na vunë sipër një makine, ne dy familjeve dhe na nisën për në Tepelenë.

Tepelena ishte kampi i shfarosjes: Nuk kishte asnjë të drejtë, mundësitë e jetesës ishin të pakta, shumë të kufizuara. Jeta e atyre që punonin ishte shumë e lodhshme, sepse kishin zëvendësuar mushkat. Njeriu ishte kthyer në mushkë për të mbajtur dru nga mali për t'i sjellë aty; ecnin 2 apo 3 orë rrugë me dru në kurriz. Nganjëherë me rrasa guri, ndërsa ushqimi ishte shumë i keq. Lëng me krimba brenda me një kokërr fasule. Çaj në mëngjes, ujë me ngjyrë. Racioni për ata që punonin ishte 600 gramë. Për ne që rrinim aty ishte 400 gramë. Uria ishte dukuria më e zakonshme, në atë mjedis në atë kohë.

Bashkë me gjyshen e prisnim tek telat. Asaj sikur i lehtësohej kur më shihte mua. Në fund të fundit, për mua ajo po bënte atë jetë, sepse ajo e kishte pas mundësinë e saj. Mjaftonte të ndahej nga babai im. Por nuk e linin të më merrte edhe mua me vete, si fëmijë i armikut, prandaj mamaja ishte e detyruar ta përballonte gjithë atë kalvar për hir të fëmijës së vet.

Mbaj mend njëherë, në një natë të Vitit të Ri kur gratë erdhën nga mali, erdhi një polic me një listë me tri emra: E para ishte nëna ime dhe dy gra të tjera, vajza nga familjet e njohura më parë. Poli-

Njeriu ishte kthyer në
mushkë për të mbajtur
dru nga mali për t'i sjellë
aty; ecnin 2 apo 3 orë
rrugë me dru në kurriz.
Nganjëherë me rrasa guri.



**Natën e Vitit të Ri
i kërkuan për të
ngarkuar prapë dru për
t'i çuar në Tepelenë,
sepse familjet e
oficerëve kishin
mbetur pa dru.
I kanë ngarkuar
nëpër shi, dhe i
çuan në Tepelenë. U
detyruan t'ua prisnin
drutë me sëpatë, sepse
i donin të gatshme
vetëm për t'i futur në
sobë dhe janë kthyer
në mesnatë.
Kjo ishte nata e Vitit të Ri!**

ci i njoftoi se këto kërkoheshin në komandë. Ne u shqetësuar, sepse ishte natë. Pastaj morëm vesh që i kërkuan për të ngarkuar prapë dru për t'i çuar në Tepelenë, sepse familjet e oficerëve kishin mbetur pa dru. I kanë ngarkuar nëpër shi, dhe i çuan në Tepelenë. U detyruan t'ua prisnin drutë me sëpatë, sepse ato i donin të gatshme vetëm për t'i futur në sobë dhe janë kthyer në mesnatë. Kjo ishte nata e Vitit të Ri.

Një herë si fëmijë duke lozur me gurë, i gjuajta një derri, aq pak sa kafsha nuk u tund vendit. Polici më pa dhe zbriti nga vendi i rojës. Më kapi dhe më futi në birucë. Ndenja rreth 10 orë. Qaja, bërtisja se kisha frikë në errësirë. Gjyshja erdhi aty afër, dhe më fliste t'i dëgjoja zërin "mos ki frikë, jam unë këtu. E mbyt unë gogolin, nuk të ha gogoli, jam unë këtu". Derisa erdhi polici tjetër që ndërroi turnin dhe më nxorri. Isha 6 vjeç.

Pas disa kohësh, nënën time e transferuan që nga Tepelena. Duhej ndërtuar burgu i Vlorës dhe duhej fuqi punëtore. Atje nga kushtet e punës ishte më mirë se sa në grykën e Tepelenës. Një inxhinjer italian që zbatonte punimet, duke parë se nëna fliste rrjedhshëm italisht, e mori si ndihmëse dhe e caktoi me detyrë normiste. Largimi i saj ishte shumë i dhimbshëm për mua. Isha ende shumë i vogël dhe nuk isha mësuar të rrija larg saj. U kacavira tek makina, të shkoja bashkë me të, polici më binte duarve. Bija poshtë, ngrihesha, vrap te makina. Gratë e vajzat që thonin: lereni atë se ka fëmijën ë vogël. Por, ishte vendosur. Ajo duhet të shkonte. Ajo iku dhe unë mbeta vetëm me gjyshen.

Pas pak kohe, u mor një vendim që fëmijët që ishin në Tepelenë, ato që kishin mundësi të largoheshin, mund të largoheshin, pra, të liroheshin, të shkonin nëpër familje që mund t'i mbanin. Në

Si në Tepelenë nuk ka pas në asnjë vend komunist, nuk ka pas as në Bashkimin Sovjetik

fillim, nuk pata ku të shkoja. Mbete edhe pa shokë se shumica dolën. Pastaj, erdhi xhaxhai i babait tim, nga Korça, doktor Hasan Merlika. Më morën në shtëpinë e tyre në Korçë. Aty kam jetuar dy vjet; kreu klasën e tretë dhe të katërt të shkollës. Ato dy vjet i kam nga vitet më të bukura të jetës time. Gjeta prindër të dytë. Më donin shumë. Megjithatë malli për gjyshen dhe nënën më mundonte shume. Kur gjeja ndonjë rast të isha vetëm, qaja duke i kujtuar.

Kur vajta në Korçë kam qenë 8 vjeç e pak, në 1952. Në fund të 1953 u mbyll kampi i Tepelenës. Arsyeja: Presioni ndërkombëtar. Pati raste që njerëzit iknin nga Tepelena dhe tregonin se çfarë ishte. Veç asaj filloi të ndryshojë kursi në Bashkimin Sovjetik. Pas vdekjes së Stalinit, Hrushovi filloi ta liberalizojë pak sistemin edhe në Bashkimin Sovjetik, pra, ta zbuste luftën kundër armikut të klasës. Kjo erdhi edhe këtu.

Pasi kampi i Tepelenës u mbyll, i çuan në Lushnje. Nga Korca erdha në Lushnje, ku u bashkuam bashkë me gjyshen, nënën dhe xhaxhain. Aty kemi filluar një jetë tjetër. Nuk kishte krahasim me Tepelenën, por gjithmonë ishte një kamp internimi dhe ishe i detyruar çdo mëngjes e çdo darkë të paraqiteshe para një polici. Aty njerëzit filluan të punojnë dhe paguheshin për punën që bënin. Nuk kishte më kazana ushqimi, secili bënte jetë me familjen dhe organizohej sipas forcave dhe mundësive që kishte. Kështu vazhdoi që nga 1954 deri në 1991, kur kemi dalë nga kampet e internimit. Grabiani i Lushnjes, ka qenë kampi i fundit.

Kampi i Tepelenës ka qenë pjesë e terrorit komunist kundër popullit shqiptar, të cilin e ndanë duke sajuar armiq të popullit. Të gjitha kampet dhe burgjet u ndërtuan në mënyrë abuzive.

Shqipëria u mbush me burgje dhe mijëra shqiptarë burgoseshin përditë e vuanin gjithandej në Spaç, Qafë Bari, Vlashuk, Ormapojani, Bedeni -një tjetër kamp i llahtarshëm, ku kanë vdekur 300 e ca vetë. Në të gjitha veprat kryesore, tharje kënetash, hapje kanalesh kulluese-vaditëse, rrugë, ura, banesa, miniera, vepra industriale dhe prodhim bujqësor gjatë 45 viteve të diktaturës sllavo-komuniste të socializmit shqiptarë janë përdorur të burgosurit dhe puna e papaguar e tyre. Diktatura prodhoi një sistem gjenocidues ndaj popullit shqiptar duke shtuar për ditë numrin e njerëzve të shpallur armiq të popullit, derisa arriti kulmin me dënim për Agjitacion Propagandë dhe rrëzimin e Pushtetit Popullor, përmes nenit famëkeq 55.

Tepelenë nuk ka pas në asnjë vend komunist, nuk ka pas as në Bashkimin Sovjetik: Gra dhe fëmijë të futur në tela me gjemba nuk ka pas në asnjë vend tjetër, gra e fëmijë në tela me gjemba pa asnjë vendim gjyqi, pa kurrëgjë!

Turani ishte një kamp tjetër, pranë Tepelenës. Atje kanë vdekur fëmijë me epidemi. Epidemi që bënin të vdisnin 20 deri 30 në ditë. Nuk kishte as shërbim mjeksor, asgjë. Fëmijët vdisnin ndërsa nënat ishin në male për të mbartur dru deri në Tepelenë. Ato e merrnin lajmin e zi, kur ktheheshin të rras-kapitura në mbrëmje. Fëmijët e vegjël mbaheshin nga plakati që nuk shkonin në punë, dhe kujdese-shin për ta, pavarësisht se nuk i kishin të vetët. Këto fëmijë edhe kanë shpëtuar, por edhe kanë vdekur shumë.

Tronditjen shpirtërore që ka kaluar nëna ime e di vetëm ajo. Mua më ofroi gjithnjë dashuri. Sado që unë rrija më shumë me gjyshen dhe njeriu më i dashur në jetën time ka qenë gjyshja, nëna është ajo, që për mua sakrifikoi jetën e saj.



Valbona Çoku Mirakaj dhe Sokol Mirakaj

“...Me gjithë hallet tona,
kemi pasur njerëz të
mirë rreth e rrotull”

INTERVISTOI KRISTALE IVEZAJ RAMA


U

Unë quhem Valbona Çoku. Jam vajza e Mentor Çokut. Babai im ka qenë shumë patriot, ka luftuar për bashkimin e Shqipërisë. Ai ishte nga Ohri, nip i Iliaz Dibrës, kryetar i Lidhjes së Prizrenit. Gjithë familja e tij, gjithë jetën e tyre, punuan, luftuan për këtë vend, që të ishte bashkë.

Kur erdhi fundi, humbën edhe eshtrat e gjyshit, patriot të madh, që gjithë jetën e çoi nëpër internime, burgjeve të Turqisë, Serbisë, Maqedonisë. Në vitet 1943-1944, babai, Mentor Çoku, ishte deputet i Ohrit dhe i Strugës, shumë aktivist

kundër komunizmit. Në ditët e fundit të 1944, më saktë, fillimi i nëntorit 1944, babai u detyrua të largohej, nga ata të fundit që ikën nga Shqipëria, se i ikte koka. Kam qenë vetëm 1 muajshe. Nuk mund të na merrte tok me mamanë, sepse një bebe aq e vogël do i prishte punë tërë grupit që iku. Mamaja u bë keq: një grua e re, e bukur. Ikja e burrit e tronditi shumë, e përjetoj dhe u sëmur keq.

Ishin muajt e parë dhe akoma nuk kishin filluar ato gjërat e tmerrshme që ndodhën më pas. Një shok i saj i shkollës që studioje në Korfuz, e ndihmoi dhe i siguroi leje që të shkonte për kurim. Unë isha disa muajshe dhe s'mund të më merrte. Më la me gjyshen dhe dajën. Mamaja shkoi dhe nuk dinte a do e takonte babain. U takuan. Më pas, u mbyllën rrugët e ata mbetën atje. Unë mbeta këtu, me një fëmijëri, me thënë të drejtën me hal-



le, si të gjithë. Daja im ishte shumë i pasur, por ia morën të gjitha deri plaçkat e shtëpisë. Megjithatë unë kisha përkëdheljen e gjyshes e të të gjithëve.

Kur mbusha 16 vjeç-moshë madhore atëherë, sa kisha mbaruar vitin e 3-të të shkollës pedagogjike, një ditë më thonë: - Ti je internuar në Lushnje. Them, tani, po më ngatërrojnë me ndonjë tjetër, megjithëse e dija çështjen e prindërve, por nuk më shkonte mendja, si të rinj që lexonim dhe i ndiqnim pak këto punë e dija që ata,

njerëzit shumë të rëndësishëm, mund të internohen, jo një kalama.

Më prunë makinën te dera. Erdhën më morën vetëm fare. Vetëm se unë isha vajzë e vetme e babait tim! Ata nuk bënë asnjë fëmijë tjetër. Kështu që unë mbeta gjithmonë vajza e tyre e vetme. Pashë makinën te dera. Më morën, më çuan në Savër të Lushnjes. Një ndodhi e tmerrshme për mua. Fillova të bërtas, obobobo, o nëna ime. Pashë gjithë komshinjtë që u mbledhën. Më thotë ai që erdhi të më marrë: Mos thuaj, o nëna ime, se për mamanë e babanë po internohesh. Atëherë, thashë, nuk qenka gabim. Qenkam unë

tamam ajo që... nejtë, më çuan në Lushnje. Në momentin që më morën në makinë, isha te disa njerëzit tanë. Duhet të merrja dyshek e ku e di unë s'ia kisha idenë. Më thonë, po të çojmë në shtëpi te daja t'i marrësh. Unë, si fëmijë mendoj, t'i çoj te shtëpia e dajës do t'i tmerroj, prandaj u them, - jo, s'ka nevojë, se nuk e kisha idenë fare ku po shkoja. Më në fund, më çuan në Lushnje. Ndejta nja 2 ditë te një kushërira ime, derisa më erdhën nja dy tessa, një batanije, një dyshek.

Më çuan në një kamp, në një fshat të Lushnjes. Në disa fshatra të Lushnjes, sektorë ferme, jo fshatra, kishin kampe internimi. Më çuan në këtë vend, ku ka qenë edhe babai im, më futën në një kazermë, ku çonin beqarët, pa familje. Familjet ishin në barraka, dikush një dhomë, dikush 2 dhoma. Ishte e tmerrshme. Vetëm fare. Barrake ishte mirë, po aty ishte një si magazinë e madhe, që kishte vetëm njerëz beqarë.

Çfarë ndodhte aty, si organizohej jeta juaj?

Valbona Çoku Mirakaj: Na bënë një apel në mëngjes edhe në darkë, një kapter, që banonte aty, se fshati banohej gjysma nga banorë vendas

Veç një mendje si kjo e jona mund t'i bënte fëmijët në kamp. Më e fortë se dashuria, marria. 22 vjeç kam qenë baba.

që punonin në fermë e gjysma tjetër ishin barra-ka ku strehoheshin të internuarit. Po ky polic na bënte apelin edhe në darkë, a ishim prezent. Ajo ditë ka qene e tmerrshme. Në ato 2 ditë që ndejta në Lushnje, dikush nga njerëzit e mi, më sygjeroi një familje shumë të mirë, ishin të gjithë shumë të mirë, më thanë, do shkosh tek ata, mbase të mbajnë tek dhomat e tyre. Kisha shumë turp, por kur e pashë veten atje u tmerrova, sa i thashë atij policit: A mund ta shkoj te ajo familje? Atij i erdhi keq, se s'kishte parë, s'kishte ndodhur ndonjëherë, kurrë që një vajzë vetëm të internohej. Ishin nëna me fëmijë, se baballarët i kishin nëpër burgje, por vetëm fare, kurrë! Dhe me thotë: Nëse të mbajnë, shko. Shkova atje dhe u thashë: A mund të rri me juve? Ajo ishte një grua e moshuar, me tre vajza të mëdha në moshë. Ngaqë i ishte arratisur djali, i kishin sjellë aty. Më thotë, posi, ti do të rrish me ne.

A ju njihte ajo? E kishte vënë në dijeni ndokush?

Valbona Çoku Mirakaj: Jo, nuk më njihte, por nusja e dajës tim, që më kishte rritur dhe që unë i thërrisja mama, kishte folur diçka me to. Thanë

ato vajzat, po ne nga një krevat kemi për vete. Thotë ajo, në atë krevat do rrijë dhe kjo me ne. Dhe kështu, ndejta me ato. Ishte një gjë e madhe për mua.

Sokol Mirakaj: Emrat e tri vajzave janë Handal, Nerivan dhe Suzan me mbiemër Hoxha. Kishin qene profesoresha. Qe nje fat i madh! Vehib Hoxha dhe Lalo Hoxha, janë prindërit e tyre.

A mund të na përshkruani si ishte dita juaj e punës?

Valbona Çoku Mirakaj: Dita fillonte me apelin. Prezantoheshim atje. Pastaj secili vraponte në fushë, siç ishin punët e ditës: Një ditë do korrije grurë, një ditë do hapje kanal, një ditë në prashitje, një ditë në misër ,pra, gjithë punët e bujqësisë. Unë nuk kisha kapur ndonjëherë as çadër me dorë, asgjë të fortë, ashtu zvarrë –zvarrë, si të themi. Vitin e parë, shkova në shkollë, të mbaroja maturën. Më lejohej dalje deri në Lushnje. Vetëm në darkë duhet të ishim në apel. Sokoli bënte maturën, unë përsërita edhe një herë vitin e tretë, se ai ishte gjimnaz. Sokoli ka qenë qysh 2 vjeç, që nga 1945, kurse unë në 1961.

Sa herë u lirohej
ndonjë birucë, vinin
të arrestonin dikë
tjetër. Në një familje
arrestuan të zotin e
saj. Mbeti vetëm e
shoqja me vajzat e
vogla.

Vajzat ku ndenja më thanë, – Vali, po të bëjmë bashkë me një djalë shumë të urtë dhe e bëni rrugën bashkë. Kështu. Puna e rregullt për ditë. Me atë punë të zorrshme... Lindën edhe fëmijët, jeta më e zorrshme...Duke u rritur fëmijët, të kapte një brengë e madhe se mendoje që ata do të kishin fatin tënd. Kemi 3 fëmijë: Dy vajza dhe një djalë. Sot, më e madhja është 52 vjeç. U martuam në kamp. Isha 20 vjeçe, edhe fëmijët të tre lindën në kamp.

Jeni martuar në kamp? Dashuri e madhe!

Sokol Mirakaj: Veç një mendje si kjo e jona mund t'i bënte fëmijët në kamp. Më e fortë se dashuria, marria. 22 vjeç kam qenë baba.

A keni patur ndihmë nga mjeksore për lindjen e fëmijëve?

Valbona Çoku Mirakaj: Po, po, i linda në spital. Pastaj na hoqën nga ai fshat i Lushnjes, se u dukej favor i madh që kishim një qytet afër. Kishte periudha që shtrëngoheshin aq shumë gjërat, pastaj jo se lirohej, por disi. Qe një periudhë që na hoqën dhe na shpërndanë, se ishim shumë familje të mira. Familja e Sokolit kishte që në 1945, familja Markagjonit, Tomi Rakaj, Fiqiri Dine, familje eksponentësh o të ballit, o të legalitetit, ishim bërë si një familje e tërë. Mendo që nga 1944, këta fëmijë u rritën, u martuan, lindën fëmijët e tyre, gjithmonë bashkë. Ky bashkim nuk u pëlqente, dhe na ndanë 5 familje në një fshat, 4 në një tjetër. Ne Mirakajt, Makagjoni, Dine, disa familje, 4 a 5 na çuan shumë thellë. Filloi jeta shumë më e vështirë. Shumë e vështirë. Nga Savra, edhe shkoje deri në Lushnje për doktor, kurse atje...

Sokol Mirakaj: Ato 16 vjet në Savër, ishin pjesa më e bukur e jetës sonë, kurse 23 vjet të tjera... shumë, shumë e vështirë.

Këtu ku qemë 23 vjet a sa ishim, ambulancën e fshatit e kishim në vijë ajrore 500 – 600 m, ose rreth 1000 – 1500 m. Për të shkuar në ambulancë, do merrje një leje nga ai që bënte apelin, oficeri, kryetari i lagjes ose anëtari i këshillit, kryetari i këshillit. Do shkonim në degën e punëve të brendshme ta firmoste oficeri i rojës, dhe na thoshte – do të shkosh nga kjo rrugë, jo nga rru-

ga tjetër, nuk lejohet në atë rrugë. Do shkosh në rrugën për spital, jo rruga tjetër. Të caktonin orarin e lejes për të shkuar tek mjeku psh, ora 9 -11 për nevoja shëndetësore si të heqë një dhëmballë, për dhimbje barku etj. Zakonisht, atje kishte njerëz sa të duash, kështu që nga ora 9 – 11 nuk mbarojë punë, dhe ktheheshe , se nuk mund ta thyeje rregullin, ndryshe dënoheshe me ligj, 3 -10 vjet burg. Kur ktheheshe, ishe i detyruar ta dorëzoje. Unë çfarë bëja? Ishin vitet 70 – 80, kërko letra, “u, paska hup, paska hup”. Më thoshte Vali – A je në vete, more, po jepja, more, pse të duhen këto letra? Dhe i kam ato letra, edhe me firmën e atyre që i lëshonin. Kam dëshirë t’i ekspozoj diku. Nëse do të ketë Shqipëria një Nuremberg, i kam ruajtur ato letra.

Valbona Çoku Mirakaj: Me fëmijë ishte vështirë. Ata donin, që ne të martoheshim, të bënim fëmijë dhe të lëkundeshim. Ka dashur zoti, i kaluam mirë hallet tona. Të betohem, thosha sa herë, e le me firmë të rri gjithë jetën e internuar, vetëm mos të na fusin në burg. Të futej burri në burg, mbeteshin fëmijët. Mos o zot, se ka edhe me keq! Djemtë e xhajës së Sokolit i arrestuan, njërin sot, tjetrin pas 3 muajve, lanë 5 fëmijë vetëm me nënat e tyre të lodhura të këputura. Për 9 – 10 vjet i kanë rritur vetëm fëmijët.

Sokol Mirakaj: E la i ati 7 muajsh, e gjeti 9 – 10 vjeç gati. Ka qenë një fenomen: shumë fëmijë që i lanë baballarët nga 1 vjeç, 5 muajsh, 7 muajsh, nuk u bënë kurrë miq me baballarët e vet. I shikonin si armiq që u kishin sjellë të këqia edhe nënave. Kur e kujtoj me dhemb. Nëse kjo intervistë shërben për të vënë një gur sado të vogël, një prag, një kufi për të ndalur të keqen, le të jepet gjithkund. E keqja është gjithmonë në pritë të jetës së njeriut. Iku komunizmi, ka një të keqe tjetër në demokraci. Një mundësi për të folur, është mundësi për t’i thënë së keqes “hajt, këput qafën”.

Një këngëtar shumë i mirë italian i kohës sime, këngët e të cilit i kemi dëgjuar fshehurazi, Sergio Enrico, thotë: Të kesh një mik, do të thotë të jesh dikush. Takohesh një mbrëmje në kafe, për të kujtuar një histori të bukur ...Ne nuk kemi nga këto histori të bukura, ne kemi histori të rënda, kështu që, do doja që kjo histori t’u tregojë çfarë është bërë.

Ky është qëllimi. Një e kaluar shumë e errët që mbaroi pak a shumë në 1991. Nuk u fol, nuk u reflektua mbi atë. Njerëz nuk patën kohe të shohin qartë, a thua se nuk kishte ndodhur asgjë. Brezat e rinj nuk janë te vetëdijshëm që tragjedia u ka ndodhur shqiptarëve prej një shqiptari. Të flasim për zërat “pa zë”, jo se nuk kanë zë, por sepse nuk dëgjojen.

Sokol Mirakaj: Në vitin 1991, kur erdhi il delegato apostolico për herë të parë pas shpëputjeve të marrdhënieve diplomatike prej 70 vjetësh me Vatikanin, patëm një intervistë në TVSH, ku përktheva, dhe më kujtohet një shprehje: Po hap intervistën për t’ju dhënë zë atyre që s’patën zë.

Valbona Çoku Mirakaj: –Ne grave dikur na lanë pak më lirshëm, nuk po e bënin më apelin, të kishim një hall pasdite mund të lëviznim. Simoni rrinte asokohe me ne dhe u sëmure nga veshi, i dhanë leje për në Tiranë. Hypim në tren dhe Simoni...uaa treni, nuk ishte fëmijë, ishte 30 vjeç, u hutua. Mbërritëm pranë detit...uaa deti. Ai bënte ashtu mua më shkonin lotët.

Sokol Mirakaj: Nuk të linin atëherë. Divjakën e kishim 20 km larg. Tre kampe ka patur Myzeqeja me të internuar. Kushërinjtë e Valit i kishim 15 km larg. Betohem, ka ndenjur 5 vjet pa i parë.

Si kanë qenë kushtet në kamp?

Valbona Çoku Mirakaj: Barraka të mbuluara, psh, në Savër ishin dy barraka të mëdha ku banonin njerëzit edhe këtej, edhe nga ana tjetër. Banjot ishin të gjitha bashkë në fund të barakave. Dy baraka kishin 20 familje. E degjoje tjetrin si merrte frymë, nga ana tjetër e murit. Dikush hynte nga dera, dikush vinte një shkallë, dikush kishte një dhomë, por ato komunikonin me njëra-tjetrën... njerëzit thonim, aman, kështu të jemi, vetëm mos na marrin burrat në burg, se u bë masive burgosja e burrave.

Njerëzit kishin frikë nga arrestimet. Ishte një tmerr kur vinte xhipsi i degës së brendshme dhe merrte personat. Sa herë u lirohej ndonjë birucë, vinin të arrestonin dikë tjetër. Në një familje arrestuan të zotin e saj. Mbeti vetëm e shoqja me vajzat e vogla. Pas 3 muajve, vjen prapë xhipsi i degës, se do merrte ndonjë tjetër. Vajza e vogël e asaj famil-

Mamaja kishte vdekur në 1988. Për dy vjet nuk e takova dot. Nuk e pashë kurrë. Vdiq e depresuar për fëmijën e vetëm, jo vetëm që nuk e shikonte, por që e kishte në kamp, dhe duke menduar që ishte për faj të saj

Valbona Çoku Mirakaj

je shkon vrap te e ëma dhe i thotë: - Mami erdhi xhipsi, se kë do marri. Shyqyr, ne kemi shpëtuar, se babin e morën. Aq ishte tmerruar fëmija.

Jo vetëm fëmijët, edhe të rriturit. Sokoli me Simonin kishin një radio dhe rrinin e dëgjonin, më shumë muzikë. Ndodhte vinte kunati, burri i motrës së Sokolit, Vasil Kokali quhet, nga fshati Aliko i Sarandës, i internuar në një kamp tjetër. Kishte bërë 10 vjet burg, kot fare. Doli njeri krejt tjetër: nuk shkonte kërrkund, as në dasma, as në vdekje. Kur këta hapnin radion, ai nuk u thoshte dot “mos e dëgjoni”, por thoshte: - Po dal pak jashtë për pak ajër, dhe sillej rrotull shtëpisë për të parë a po na përgjonte kush.

Në një kazermë ku kishte edhe burra pa familje, ndër ta Mikel Koliqi që u bë Kardinali i parë shqiptar. Vjen një ditë te Sokoli dhe i thotë: - Sokol më është prishur radioja; kam dëgjuar se të vjen doresh, se s'mund të kërkoh leje t'u them po shkoj në Lushnje të rregulloj radion. Unë, si e re, nuk e mendova shumë dhe i them: -Mikel, mos thuaj do iki të rregulloj radion, thuaj te doktori. Dhe ai thotë – Po unë nuk po du me rrejt. Ai ishte prift dhe unë po e mësoja si të gënjente. Më erdhi zorr. – Ua, më fal - i thashë, më doli, ashtu.

Në atë moshë, 87 vjec, vijnë e arrestojnë për të tretën herë. Kishte qenë në burg 1 herë, doli e çuan në internim. Këtë herë hapën fjalë që me një radio transmetuese, lidhej me Vatikanin, dhe, populli s'dinte çka ishte Vatikani...E vunë në makinë atë burrë që dridhej dhe i mësuan të gjithë fëmijët e fshatit ta pështynin priftin, edhe ta gjuanin me gur.

Valbona Çoku Mirakaj: Ne jemi liruar në 1990. 5 vjet më pas vdekjes së diktatorit.

Sokol Mirakaj: 600 dollarë e kam blerë unë pashaportën e gruas, dhe të djalit.

Valbona Çoku Mirakaj: Mendova, të blej një pashaportë të heq djalin, se djali 22 vjec e do fillojë edhe ai me burgje. Akoma nuk na besohej që shpëtua. Unë me djalin andej, lashë Sokolin me dy vajzat këtu...

Nejse, kam shkuar ate natë. Ishte tmerr, se edhe pashaporta u ble, dhe na thoshin edhe ne avion

mund tju kthejnë. Të dy me djalin të ngrirë. Kur zbritëm, një gjë e çuditshme më ka ndodh. Në aeroport m'u duk errësirë, s'kishte drita. *Fytyra e babit kishte një dritë për mua*, -pas 47 vjetëve, se baba më la 1 muajshe, unë e kisha parë veç në fotografi,- e gjë vetmja që unë pashë në gjithë atë grumbull njerëzish!

Mamaja kishte vdekur në 1988. Për dy vjet nuk e takova dot. Nuk e pashë kurrë. Vdiq e depresuar për fëmijën e vetëm, jo vetëm që nuk e shikonte, por që e kishte në kamp, dhe duke menduar që ishte për faj të saj. Arriti një moment që nuk njihje më kërkënd, 75 vjeç, nuk ishte shumë e vjetër... Babai, për të larguar emocionet e veta, gjithë rrugën në makinë fliste e fliste, dhe unë thoja, po, ky është babi im që flet. Hyra në shtëpi. Ai ndali, hyra vetëm. Kishte vënë një fotografi të mamit përballë dhe një tufë me lule, me një letër "Mir-seerdhe, e zonja e shtëpisë". Shtëpia m'u duk e errët, e errët. Të nesërmen në mëngjes, më solli gjithë kujtimet e saja. – këto janë tujat. Atëherë fillova ta shoh, sa i dashur qenka ky babai im. Shkuam në varreza, i them babit që të rrinte larg, se dëgjohej zëri nuk e di deri ku...

Më kujtohet, një foto timen, 13 vjeçe, në baltin e shkollës, para internimit, ia kishim dërguar asokohe prindërve të mi në Itali. Unë i kisha vënë një shenjë vetes sime që të më dallonin. Babai më tregoi se prej kësaj fotografie, mamaja kishte ndenjur 3 javë në shtrat. I kish thënë:-Mendo, vajza jonë, ka venë shenjë të tregojë ku është, se ne nuk e njohim akoma. Dhe ishte sëmurur shumë keq. Unë si fëmijë doja t'u tregoja ku jam, por nuk imagjinoja dot atë efekt tek mamaja. Një fëmijë nuk është një mama!

Kalova ditë të mrekullueshme me babain. Pothuaj 80 vjeç, dhe në një formë të paparë: i mençur, i ditur, aktiv shumë. U hapën rrugët dhe ai kishte ëndërruar gjithmonë të jepte kontributin e vet këtu. Erdhi dhe ndihmoi shumë, shumë. Sigurisht nuk është se e donin shumë ate ndihmën e këtyre njerëzve, por gjithmonë thoshte: - Ne do bëjmë gjithmonë atë që mundemi, na duan s'na duan, nuk ka rëndësi fare. Bënte për Kosovën shumë. Kur kam shkuar në Kosovë thoshin, uaa, vajza e Mentorit. Kalova nja 5 vjet e gjysëm shumë të lumtura me të. Dhe më thoshte: Vali, ti je 1 vjeç për mua, sa herë kalonte viti, je 2 vjeç, 3 vjeç

dhe kur unë bëra 5 vjeç, ai iku... Vdiq nga zemra, dhe u mbyll ajo histori e tij, histori e rrallë, e trishtueshme.

Për në Itali ju blëtë biletat vetë i dytë, por thatë se blëtë edhe pashaportat, me pagesë nën dorë... A kishit para nga kursimet tuaja?

Valbona Çoku Mirakaj: Jo, ku dilnin lekët që merrnim nga puna jonë, lekët m'i dërgoi babai. Babai ishte i dënuar me vdekje nga komunistët, nuk mund të vinte as këtu as në Maqedoni. Ai ka lindur në Ohër. Në Ohër dhe Strugë kishte pasurinë e vet, por nuk mund të shkonte se ligji për dënimin e tij vazhdonte edhe andej. Në Itali, gjithë shqiptarët e Maqedonisë, të Kosovës e vlerësonin dhe e nderonin shumë. Kur erdhi në 1992 a në 1994, shkuam në Pogradec dhe donte të shihnte anën tjetër të Ohrit, por kishte frikë. I them: -A po shkojmë, kush po të nje? Ti ke ikur djalë i ri. Prej dashurisë së madhe që kishte, iu mbush mendja dhe shkuam. Qysh në kufi, një makinë prej Kosovës, e njohën, na erdhën te makina. – Ti që ke bërë aq shumë për ne,- e përqaftuan.

Valbona Çoku Mirakaj: Shëtiti shumë gjatë. Kur po ktheheshim, ndalua në Pogradec, aty dëgjuam se ishte hapur lajmi në Ohër, që ka qenë Mentor Çoku.

A keni ndonjë mesazh për rininë?

Valbona Çoku Mirakaj: Brezat e rinj duhet ta njohin çfarë kemi kaluar ne, të reflektojnë, të dallojnë të mirën nga ekeqja. Historia duhet mësuar ashtu siç ka qenë vërtet, jo gabim siç ua kanë thënë. Edhe nëpër shkolla, akoma vazhdon po njësoj historia.

Sokol Mirakaj: Prandaj thonë "Historinë e bëjnë fitimtarët". Po ç'fitimtarë? Fitimtarë të një morali të shkatërruar, morali i tejkaluar.

Valbona Çoku Mirakaj: Edhe në televizion, që i dëgjojmë, historianët vazhdojnë po ashtu me te kaluarën e tyre. Djalin tim kanë qenë duke e përjashtuar nga shkolla, pse veshi pantallona doku xhins, të thjeshta fare, jo si këto me xhingla. Një mësues i tij i mirë, i thotë, hiqi shpejt, mos i vish më, se të përjashtojnë nga shkolla. Një i ri sot nuk e kupton këtë, nuk e kupton që po të dëgjoje

një këngë mund të futeshe në burg. Ky mësuesi i fshatit diskutoi njëherë për një libër, Shopenhauer. Kur i bënë gjyq dhe ia nxorën dëshmitarin që tha, ky më ka folur për

Shopenhauerin. Të flisje për Shopenhauerin, ishte e ndaluar. Mori 10 vjet burg. Një ditë te dyqani i bukës paskësh thënë: – ku hahet kjo bukë?, se kishte bukë misri të keqe. Edhe kjo ishte në akuzën e gjyqit për ta dënuar.

Vjehrra ime e kaloi Tepelenën 4 vjet. Kur bënte bënë thoshte “pasha hallet e Tepelenës” ose, kur uronte për një Pashkë a Vit të Ri “Zot, faleminderit që nuk lashë asnjë fëmijë atje”, se vdisnin fëmijë, përditë, nga uria dhe nga e keqja, këto të dyja thoshte, gjithmonë. Vazhdimisht flisnin për burrat, edhe pse nga burrat u ndodhën ato që u ndodhën.

Sokol Mirakaj: Po të flisje për babën, të tria kunatat që kanë qenë, thonin, -S'i ngjave pak atij babait, po si ka qenë i gjatë, i pashëm, të thojë ti, nuk ka pas burra të tjerë në botë! Veç këta kanë qenë!. Burrat më të mirë, të pashëm!.! them, – nënë, prej mallit për babin, je duke e bërë babin sikur ka qenë ndonjë katallan...Kurrë ndonjëherë edhe me gjithë ato halle që kishin, nuk i mallkuan burrat e tyre!

Valbona Çoku Mirakaj: Ajo ishte e mira e atyre grave. Ato nëna ishin heroina. Me një mundim të paparë. Unë thashë që në fillim se historia e ime është e rrallë, se nuk kishte bërë vaki për një vajzë të ndodhte. Por vuajtjet që kanë hequr ato, nëpër Tepelenë e ku di unë... Unë kisha fotografinë e mamit dhe të babit. Çdo mëngjes, thosha, mjerë ju, si jetoni pa mua. Nuk shikoja çfarë halli kisha vetë, si jetoja vetë. Sidomos, kur u bëra me fëmijë! Tani i kam dy fëmijë në Itali. Vajzën e vogël dhe djalin. Më shkulet zemra kur ikin ata. Mendoj, si kanë bërë prindërit e mi që s'më panë kurrë, nuk i thashë as “mama”.

Sokol Mirakaj: Sa herë, thoja, s'ka mundësi, na i bënin baballarët më të mirë në botë! Si është e mundur, mor zot, të na ketë ardhur një e keqe kaq e madhe? Ka një të keqe diku. -Nuk është e mundur të na ketë gjetë gjithë kjo e keqe e madhe pa e bërë diçka ata, -i thoja. E kanë bërë diçka! Nuk ka mundësi! Nëna më thoshte: Po të them këtë,

ndoshta nesër do dilni të lirë. Ju e dini si është në malësitë tona, kush ka gjak, do të lajë gjakun. Unë të them që baballarët tuaj kanë qenë burra të mirë. Ju mund të dilni të bridhni tërë Malësinë e veriut, dhe kërkujt nuk i keni borxh dhe nuk ju ka borxh. Dhe kjo është një e mirë që tregon se kush kanë qenë baballarët tuaj. Se kanë qenë burra të mirë, të pjekur, të pashëm.

Babai ka vdekur në 1978, 64 vjeç në burg. Nuk e pamë kurrë! I kam parë veç gurin e varrit.

Në 1996, na fton një mik kanadez në Kanada për 2-3 javë. Kur merr vesh që unë në Neë York kam varrin e babës, më thotë: - Sokol, do shkojmë të shikojmë varrin e babës. Edhe vemi tek një kushëri në New York. Na priti ai, te nesërmen shkuam tek varrezat. Të them të drejtën, kur isha i ri, mendoja me vete, more, çfarë njeriu jam, s'më dalin lot as në raste vdekjesh. Kur kam shkuar atë ditë tek varri i babait, kam rënë para atij guri, e s'kam ditur të çohem. Aty e kam parë për herë të parë dhe të fundit.

Sokol Mirakaj: Babai im është njeriu i fundit që e kaloi Shqipërinë me armë në krah. Në 1950, 7 vjet ka luftuar bashkë me shokë. Ngelën nja 5 vetë në fund. Vëllai i madh iu vra në mal; nipi i vet, u vra në mal në 1949. Pas shumë kohësh, kam gjetur një ditar të babës. Një ditar pa fillim e pa fund...Ka një episod shumë, shumë prekës, që më ka tronditur. *Vëllai i vet, i plagosur për vdekje u lë amanet: – Mos më varrosni këtu, në tokë të komunistëve se do më hapin varrin dhe do më përdhunojnë edhe për së vdekuri.* U kishte kërkuar ta çonin në një vend diku në bjeshkë. Këta u detyruan ta ngrenë me vigj (lloj barelash në malësi me mbajt njerëzit) dhe udhëtuan natën nga një vend në tjetrin. Babai shkruante se ishte një i ftohtë i tmerrshëm dhe shpesh rrinte pas që pesha më e madhe t'i binte atij. Gjithë gjaku i të vëllait i ra mbi trup. Teshat që kishte vesh dhe i gjithë trupi iu mbuluan me gjakun e vëllait. Dhe për 3 ditë rresht i kishte mbajtur teshat pa i hequr.

Kam dy libra, jeta e axhës tim “Vetëvrasja e një Kombi”. Ju lutem ta lexoni, të jeni të sigurtë që nuk është kohë e humbur. Është i hapur për çdo lloj diskutimi, sepse ka qenë ministër në kohën e Italisë për 5 vjet. Duke qenë ai ministër atë kohë, neve na nxorrën fashista e ballista. Ky ka qenë

faji ynë. Ç'të keqë kisha bërë unë 2 vjeç, ai tjetri që s'ka le hiç? Këtë u them njerëzve: - E keqja e madhe është në pritje që mund të vijë nga të katër anët, nga çdo anë. Mundohemi mos ta pranojmë të keqen, ta shmangim. Por për fat të keq të këtij mileti, është investuar aq shumë për të shkatërruar moralin e këtij mileti, për të kompromentuar çdo karakter, çdo njeri në një mënyrë apo tjetër, me thashetheme, me poshtërime, për t'i bërë siç ishte vetë, një bishë që hante gjithë këlyshët e vet!

Një mik yni, që kishte hyrë në burg që 21 vjeç, pastaj e internuan dhe e mbylli internimin 70 vjeç, tregonte se në burgjet politike kishin kohë të lexonin, mësonin edhe gjuhë të huaja, kurse puna në kampet e përqëndrimit nuk të linte kohë, ishte punë skllavi, nuk ke mundësi të lexosh, se nuk ke takat. Do hiqje sa m³ dhë ishte norma, do merrje ato lekët e ditës së punës. Edhe atë copë bukë, të betohem, sa herë, e haja shtrirë.

Unë po them, jeta ime deri në 1991 ka qenë vetëm me dheun dhe me lopatë.

Valbona Çoku Mirakaj: Prandaj kishin nxjerrë si moto "Njeriun e ri", po me çfarë vlera?

Por, me gjithë hallet tona, kemi patur njerëz të mirë rreth e rrotull. Na vjen vizitë një shoku ynë që e kemi patur në internim. Vajza, duke qenë më e vogla e fëmijëve, i thotë duke e përçafuar: - Jam aq e lumtur që kam kaluar fëmijërinë time me njerëz kaq të mirë. **Ka qenë një** fat i madh.

Sokol Mirakaj: Pozita dhe grada në Shqipërinë tonë, për fat të keq, nuk ishte për meritokraci, se ke bërë një gjë të mirë, përkundrazi, sa keq ke bërë. Sa më shumë keq të bëje, aq më shumë ngriheshe, sa më mirë të bëje, aq më i humbur ishe. Ka qenë krejt e kundërta e moralit elementar të jetës!

*Por dua ta mbyll me disa rreshta të mrekullueshme të Mitrush Kutelit:
Jam shqiptar/ jam kosovar/ k'tu kam qenë e k'tu do jem / dembabadem/
gjersa mali t' bëhet hil e hini mal përsëri!*

Ju falënderojmë për gjithçka, për gjithë kohën që na vutë në dispozicion dhe gjithë kujtimet që ju ndatë me ne. Faleminderit edhe një herë.

Të them të drejtën, kur isha i ri, mendoja me vete, more, çfarë njeriu jam, s'më dalin lot as në raste vdekjesh.

Kur kam shkuar atë ditë tek varri i babait, kam rënë para atij guri, e s'kam ditur të çohem. Aty e kam parë për herë të parë dhe të fundit.

Sokol Mirakaj



U përfolën tërë jetën në komedi, ndërsa vuantin të internuar Fatbardha Saraçi

INTERVISTOI: MIRA TUCI

U

Unë jam sot, i kam mbushur 78 vjeç. Jam e datëlindjes 1939, d.m.th. kam hyrë në vitin e 79-të të jetës sime. Që në moshën 5-vjeçare kam provuar ç'do të thotë të jesh fëmijë i një shtrese që është quajtur armik i popullit. Që 5 vjeç kam përjetuar gjyqin e babait që u dënua me grupin e Tiranës, shpronësimin, nxjerrjen nga shtëpia dhe largimin nga Tirana. Na çuan në Kavajë, ku na strehuan në bodrume, barraka dhe kasolle.

Familja ku jam lindur është familja Mulleti. Në histori Mulletët përmenden për ndihmesën në ndërtimin e Tiranës. Babai im, Haki Mulleti, dy xhajat, Qazim dhe Hysni kanë studiuar të gjithë jashtë. Babai ka studiuar në Vienë. I vetmi që ka jetuar në Shqipëri është babai im. Xhaxhai që u mor me politikë, Qazim Mulleti, më tepër ka provuar emigracionin jashtë Shqipërisë. Xhaxhai tjetër, student i Korçës, edhe student i Montpeliesë, ka jetuar jashtë. Babai im ka qenë nëpunës i shtetit në Komunitetin Musliman shqiptar. Mamaja ime ishte me origjinë shkodrane. Unë jam vajza e tretë e Haki Mulletit. Kemi qenë 5 fëmijë. Motra e madhe ka vdekur 18 vjeçe, kur ishte maturante në gjimnazin e Shkodrës. Më i vogli është vëllai i lindur më 30 shtator të 1944.

Mbaj mend barrikadat, gjurmët e luftës, si mund të kujtojë një fëmijë 5 vjeçar bodrumin ku strehoheshim ne dhe gjithë pjesëtarët e rrugës tone. Pritëm lirinë. Mamaja bëri ëmbëlsirë se u çliruam. Fillova klasën e parë tek shkolla "Avni Rustemi", ishte afër shtëpisë sonë. Mbaj mend që recitoja një vjershë të bukur, "Gështenja e Vogël", se si një vajzë e vogël zbriti nga mali në qytet. Filluan të vinin njerëz të tjerë në shtëpinë tonë. Në fillim na lanë në një dhomë, pastaj na nxorrën fare nga shtëpia, për shkak se babai u dënua dhe gjithë pasuria na u muar.

Babai nuk merrej me politikë, por u dënua për shkak të vëllait të tij. Ne u quajtëm shtresa e tradhtarëve ose e armiqtë të popullit: ata që kishin pasuri, tokë, shkrimtarë, etj.

Kam parë babain tim që doli nga burgu dhe u detyrua të punonte punë krahu kur ai vuante nga arterioskleroza. Çfarë mbaj mend nga Kavaja? Në oborrin e shkollës 24 maji, në një qerre, na kanë pas prurë një njeri të vrarë, thoshin se kishte 72 plumba në trup.

Kurse tek manat e Kavajës, që ishte si pazar pas xhamisë, kam parë njerëz të varur, mbështjellë me çarçafë të bardhë me një tabelë ku shkruhej "armik". Një tmerr kur kalonim aty, mbulonim sytë edhe ecnim. Vetëm mos t'i shihnim ato trupat sesi i lëkundte era, trupa të varur. Tmerr, tmerronin edhe fëmijët!

Familjen e xhaxhait, pra, gruan e tij dhe djalin, e çuan në internim në kampin e Tepelenës. Dëgjuam që ishte rrëzuar një kamion dhe kishte vdekur një çift, ndërsa fëmijët e tyre kishin shpëtuar, por ishin të tjerë. Kam qenë 8 vjeçe, ne qanim. Para se të flinim, baba na vinte t'i luteshim zotit, për Shqipërinë dhe e dyta për Shitin dhe Hajrien.

Por ne kemi patur edhe një lidhje tjetër me atë kamp. Daja i kushëririt tim, familja Kusi kishte një djalë të ri. Shkonte të shihte motrën në kampin e Tepelenës. Dhe kur udhëtonte, ndalonte një natë në Kavajë, pastaj shkonte në Tepelenë, dhe kur kthehej, prapë ndalonte tek ne, pastaj për në Tiranë. Ai tregonte se ç'ishte kampi i Tepelenës.

Kushëriri im, Reshiti, e ka përjetuar kur është shfaqur komedia "Prefekti" për herë të parë.

Ishte në klasë, dhe i bënte ruisht Nina Potapova. Duke qenë se ishte djali i ish prefektit të Tiranës, ai ishte tërë kohës nën goditjet e moshatarëve, prandaj kishte ndërruar disa herë shkollat dhe gjithnjë ishte në fund të listës në regjistër.

Profesoresha ruse kishte parë premierën e shfaqjes, sepse ajo u mësonte ruisht drejtuesve të qeverisë asokohe. Kur po bënte apelin, në fund të listës lexoi, Reshit Qazim Mulleti. Uaaa – tha, emër i vërtetë ky?! U çua klasa e tha- po, ky është Shiti. Shiti i shkretë thoshte, deri dje kisha qenë Shiti, por sot, u bëra një Shit tjetër. Ai tregon se si pedagogia e thirri afër vetes dhe e mbajti aty e çuditur si mund të shkruheshin pjesë komedi me emra realë. Po atë natë, i morën me kamion dhe i internuan në Tepelenë.

Ai ishte rreth 15 vjeç, datëlindja 1931, kur e çuan në Tepelenë dhe e përfundoi kalvarin e internimeve 62 vjeç. Gjatë periudhës që ai ishte në Tepelenë, 1944-1955, ne nuk kemi asnjë fotografi me të. Kur unë për herë të parë shkova ta takoj, më thirri në emrin e motrës time që ishte 4 vjet më e madhe se unë, Vera. Nuk më njohu!

Ai më ka treguar që brenda natës kanë vdekur 30 e ca fëmijë në kampin e Tepelenës. Me duart e mia, thoshte, kam hapur 200 varre. Na vinin t'i zhvarrosnim nga varret që kur kufomat ishin ende të padekompozuar, 2 muajshe, 3 muajshe apo 1 vit varrosur, pa mjete mbrojtëse.

Një nga shokët e tij, kur po hapnin varret, hyri te njeri e me shaka kishte thënë se ai varr ishte tamam për atë. Ai u infektua keq dhe të nesërmen vdiq. E vunë në varrin që kishte provuar. Kapanonet ishin të mbipopulluara, banorët ishin të strehuar pa dallime, domethënë burra, gra, pleq, të rinj, fëmijë, të gjithë ishin të përzierë tok në ato kapanone. Ushqimi mungonte, mungonte higjiena, kushtet e punës ishin rraskapitëse.

Gratë dhe vajzat transportonin drutë nga mali për në qendër të ngarkuara në shpinë. Djemtë e rinj i pritnin drutë, nëpër male. Puna nuk ndërpritej as në shi e në të ftohtë. Ushqimi ishte në kazanë të mëdhenj ku kishte më tepër lëng, ndopak groshë, dhe shpesh të mykura.

Apeli bëhej pa zbardhur drita që në 4 të mëngjesit.

Thashë të shkruaj
vetëm jetët e grave, çfarë
është bërë me femrën
shqiptare, se burrat i
thonë njëri-tjetrit armik,
tradhtar... Pashë sa
rezistencë kishte femra
shqiptare për rritjen e
fëmijëve dhe edukimin.
Më ngjanin me ato
femrat shqiptare të
periudhës së sundimit
otoman, që burrat u
shkonin në luftë, por ato
mbanin kombin gjallë.

Por ai që lexonte në apel ishte analfabet dhe mezi lexonte. I mbante me orë aty.

Një nënë nga ato që qysh në rini përjetuan kampin e Tepelenës më ka treguar: I preva flokët dhe bëra konopin që të mos këputej kur transportoja drutë, por siç forcova konopin që nuk m'u shkëput asnjëherë, u forcova edhe unë. Ajo ishte 23 vjeçe, me dy vajza të vogla. E kishte për detyrë t'i rriste dy vajzat dhe i rriti e i nxorri gjallë. Sot ato janë nga 75 vjeçe dhe kanë nga 5 fëmijë dhe secili fëmijë ka nga 2-3 fëmijë. Ky është heroizmi i një nëne. Mbi-jetesa! Se në atë kushte çfarë mund të bënte ajo?

Kur kam qenë e vogël në Kavajë, mbaj mend gra të ngarkuara që vinin nga Shkodra në Kavajë, qëndronin atë natë tek ne, se mamaja ishte shkodrane dhe, të ngarkuara, shkonin në Beden të shihnin djemtë e tyre që punonin në atë kamp. Unë thoja, ç'janë këto gra?! Ku shkojnë? I shihja, të lodhura të raskapitura. Dëgjoja që thonin se kishin parë fëmijët e tyre të dobësuar, të keqtrajtuar. Një moment kur unë po qaja, dhe babai mori vesh përse qaja, më tha: Ruaji në kujtesë, ruaji në zemër se kurdo mund t'i shkruash.

Sigurimi i shtetit mernte babën në darkë, sa herë thonin që ka banda. E mbanin gjithë natën nën dhunë, se mendonin meqë ishte një djalë i familjes Mulleti, mos kishte ardhur i vëllai. Por xhaxhai nuk ka ardhur asnjëherë në Shqipëri, që pas 1944. Megjithatë ata ushtronin dhunë dhe babai im i provoi të gjitha; ne rrinim duke pritur nëpër natë kur po vjen. Shkoja në shkollë dhe mendjen e kisha atje: erdh baba, nuk erdha baba? Në pushimin e madh kthehesha shpejt në shtëpi, kur shihja babën shtrirë me dorën në zemër, se vuante nga zemra. Paska ardhur baba! U rritëm me frikën e sigurimit.

Kaluan vitet, e quaj veten me fat që më mori gjyshja dhe tezet për të vazhduar shkollën në Shkodër. Kavaja nuk kishte gjimnaz në atë kohë. Aty u rrita, por edhe aty u takova në një rrugë që ishte rrugë me të pushkatuar dhe të internuar, si familja Pipa, Kazazi, etj. Gjithë jeta me këto përjetime.

Unë kam takuar shumë prej këtyre, edhe pa rënë sistemi komunist. Një nga nënat e familjes Dine, vinte tek motra ime se motra është martuar me një djalë të asaj familjeje.

Kur binim në mbrëmje për të fjetur, më tregonte se ç'ishte kampi i Tepelenës, dhe kampet e tjera të punës. Ajo nënë, rriti një djalë që të vogël, por kur u rrit, ai provoi burgun e Spaçit, dhe fatkeqësisht, ajo nënë vdiq pa e parë djalin të lirë. Unë jam rritur me këto ngjarje.

Ndërsa komedia "Prefekti" shfaqej pambarim sikur të kish marrë çmimin Nobel. Njerëzit na fyenin, nuk thonin asnjëherë vajzat e filanit, por mbesat e filanit. Kjo gjë më ndoqi pas edhe kur punova në rrethin e Lezhës. 17 vjet në ato fshatra të largëta, por pastaj më larguan nga puna për biografi të keqe. Unë kisha studiuar kimi, mund të kryeja punë të kualifikuar, por më lanë në punë fare të pakualifikuara, me rrogën më të ulët.

Me të thënë të drejtën, kur desha të shkruaj, thashë të shkruaj vetëm jetët e grave, çfarë është bërë me femrën shqiptare, se burrat i thonë njëri-tjetrit armik, tradhëtar... Unë pashë sa rezistencë kishte femra shqiptare për rritjen e fëmijëve dhe edukimin. Më ngjanin me ato femrat shqiptare të periudhës së sundimit otoman, që burrat u shkonin në luftë, por gratë mbanin kombin gjallë.

Në vitet 1990-1992 këto nëna ishin të moshuara, por ishin gjallë dhe të qarta mendërisht.

Ka shumë dhimbje në kampin e Tepelenës. Historia e Pashkës së vogël që vdiq aty. Njera nga kurnatat ishte çuar në burg, tjetrën me gjithë fëmijë në kampin e Tepelenës. Po me Pashkën e vogël çfarë patën? Pashka, nuk mbijetoi dot. Këto gra kanë treguar se si niste vaji pa mbarim në ato kapanone, kur brenda natës vdisnin fëmijë. Qanin nuset e reja, por qanin të tërë bashkë me to. Të nesërmen të tërë, edhe ata të besimit musliman thonin Lutjen, për Shenjtën Mëri, nëna e Zotit. Ka lloj-lloj dhimbjesh, po me fëmijën e vogël është më e zorrshme.

Një nënë nga Nikaj-Mërturi, heroinë, mundi ta nxjerrë nga kampi të vdekur fëmijën 3 vjeç të shkojë ta varrosë atje. Historia e nënës Gjellë Gjikota ende gjallë tani, 94 vjeçe, që bashkë me kurnatën arritën pas 55 vjetëve, t' i rivarrosin dy vajzat e vogla që u vdiqën në kampin e Tepelenës. Janë të vetmet që i kanë gjetur dy varret e vogla, sepse i kishin varrosur pranë një varri monumental italian dhe e kishin si shenjë orientimi.

Terrori komunist filloi me goditje të familjeve të mëdha, pastaj tregtarët, familjet e pasura në fshat, intelektualët, profesorët hynë në burgje; u shtua numri i armiqve të popullit. Vazhduan me ushtarakët para vitit 1944 e më tej, kushdo mund të bëhej armik.

A e di si më thoshte djali i xhaxhait, Reshiti? A ka më fatkeq se unë? Që i vogël e sa u plaka duke më sharë e duke më tallur në komedinë “Prefekti”. U tallën me fëmijën, u tallën edhe me të ëmën zonjë. E bënë injorante. Shkonin aktoret ta takonin në fushat e Myzeqesë. Çfarë menduan se ishte Hajrie Mulleti?! Një grua e thjeshtë, një grua e mirë, me humor, një grua që provoi gjithë ato internime dhe nuk pranoi ta ndante asnjëherë burrin e saj. Rriti e vetme nëpër

kampe djalin dhe e mbylli jetën e saj në internim. U nda nga jeta e mundimshme në Savër, në moshën 72 vjeçare. Mbajti ngarkesë me dru si gjithë gratë e tjera në kampin e Tepelenës. Pa edhe si i vuante aty, para syve, djali i vetëm duke hapur gropa varresh.

Dhe në momentet e fundit të jetës, kur e pyeta, “ku je nëna Hajrie?”, ajo me inteligjencë mahnitëse plot humor tragjik u përgjigj: Ahhhh, jam tek shtëpia e babait në Tiranë. Oborri me lule dhe dhoma është me jorganët e atllazit të bardhë! Ndërsa i biri plot dhimbje rënkonte: Jemi në kasolle, në llucën e Myzeqesë, ajo përgjigje aq delikate dhe e pafajshme dëshmonte sesi shpirti jetonte me imagjinaren për t’i mbijetuar peshës së rëndë të baltës dhe përbaltjes. Ajo e çoi veten atje ku donte të ishte, mes luleve dhe bardhësisë vezulluese.

Unë nuk mbaj shpresë. Se u bëra 50 e ca vjeçe duke ëndërruar se do më vijë liria.

Liria nuk vjen nga jashtë, liria vjen nga brenda. Të kulturohet populli, Të mësohet populli të zgjedhë njerëzit më të mirë që të drejtojnë vendin.

Shumë shqiptarë, kanë rritur fëmijë të mirë, fëmijë të ndershëm, i shkollojnë, janë të drejtë dhe lum ata që kanë rrit këta fëmijë!

“...u bëra 50 e ca vjeçe duke ëndërruar se do më vijë liria. Liria nuk vjen nga jashtë, liria vjen nga brenda. Të kulturohet populli, të zgjedhë njerëzit më të mirë”



Kalvarari i 8-vjeçarit që u internua më 9 maj Kurt Kola

INTERVISTOI KRISTALE IVEZAJ RAMA

U

Unë jam lindur në 6 maj 1937, në një fshat që quhet Macukull, në afërsi të qytetit të Burrelit. Aty kam jetuar deri në moshën 8 vjeç.

Duke mbaruar klasën e parë, ka qenë 9 maj, siç kemi qënë në mësim kanë ardhur dy partizanë të armatosur brenda në klasë. Ne ishim fëmijë. Mësuesi u tremb, sepse mendoi se kishin ardhur ta

arrestonin. U krijua një, gjendje frike. Njëri nga partizanët pyeti: - Kush është filani? U ngrita në këmbë: - unë. Ti do të vish me ne.

Sa vjeç ke qenë?

8 vjeç .

Dy njerëz të armatosur kërkojnë një fëmijë 8 vjeç në shkollë?

Mora librat. Mësuesi sikur u çlirua. Me këta dy partizanë shkuam tek shtëpia. Atje ishte plot partizanë. Shtëpia ime ishte djegur nga gjermanët. Kishim bërë një mbulesë sa për të jetuar aty. Par-

tizanët kishin nxjerrë rrobat jashtë dhe neve na marrin për internim. Ne ishim një familje me 13 veta: 4 gra dhe 9 fëmijë. Më i madhi i fëmijëve isha unë, 8 vjeç, pastaj ishin të tjerët.

Ishin të gjithë vëllezërit dhe motrat tuaja?

Arsyeja e internimit ishte sepse babai ishte në mal, me vëllezërit e tij, me dy djem, me dy nipa dhe shumë të tjerë. Ai nuk ishte dorëzuar tek komunistët, vazhdonte të ishte në mal, kundër regjimit. Ne na internuan nga Burreli në Peshkopi, ku na mbajtën deri në fund të gushtit, përballë burgut, me policë te dera. U bëmë shumë familje. Gjatë qëndrimit aty ra sëmundja e fruthit. E kaluam këtë sëmundje pa asnjë lloj kurimi. Prej aty na dërguan në Berat. Në Berat ishin shumë familje. Nga veriu me qindra familje. Ishin ndarë në dysh.

Dukej që nuk kishte asnjë interesim nga autoritetet e shtetit, por do t'i dilje zot vetes tënde. Ky ishte kampi i internimit. U strehuam nëpër kazerma të djegura nga lufta, pa dritare, me një mbulesë me letër katërma që jepte shumë nxehtësi, rreth 30 familje bashkë. Dimrit jepte të ftohtë. Që aty për shkak të kushteve pati sëmundje të ndryshme, epidemi, vdekje fëmijësh edhe të moshave të kaluara.

Sigurisht në gërmadhat e luftës nuk mund të flasim për kushte higjieno-sanitare, po elementët më të thjeshtë të nevojshëm për pastrim, si i realizonit? A kishte çezma me ujë, a kishte nevojtoje.

Në një jetë kolektive rreth 100-150 vetë në një kazermë është e paimagjinueshme për higjienë. Uji nuk ishte i mjaftueshëm. Për t'u larë shkonim në banjot kolektive për gjithë gazermën. ku ngrohnin ujin me kazan dhe na lanin në fëmijëve. Nga mungesa e higjienës u përhap morri. Ata në moshë 16 – 17 vjeç, kryenin lloj-lloj punësh të detyruar, nga punë në bujqësi deri luftë kundër karkalecit. Kishte plasur karkaleci. Shtronin çarçafë dhe ata sulmonin aty sa nxihej çarçafi. Mbusheshin çarçafët me mijëra. I merrnin dhe i digjin.

Sa keni qëndruar në Berat?

Në Berat kemi qëndruar nga 1945 deri në prill

të 1949. Para se të na lëviznin nga Berati, na bashkuan. Sollën edhe të internuarit e jugut që ishin në Krujë, tek Fabrika e Tullave në Tiranë dhe në Shijak. Tri kampe internimi ishim. Atëherë u bëmë rreth 3 mijë vetë. Erdhi edhe një komandë e re. Na lajmëruan të bënim gati plaçkat për në Tepelenë.

Në Tepelenë u shfrytëzua për kamp sistemi i kazermave ushtarake që kishin ndërtuar italianët për të mbajtur municionet luftarake. Këto kazerma kishin shërbyer në frontin e luftës Italo-Greke. Pasi mbaroi lufta, gjermanët e hodhën në erë dhe municionet e papërdorura, shumë bomba e mina u shpërndanë kudo. Nga kjo pikëpamje, kampi i Tepelenës ishte që në fillim një kamp i minuar.

Kampi ndodhej në një shesh dhe rreth e rreth sheshit, vinte kodra, një lumë dhe në mes të lumit e kampit ishte plot me bomba.. Kazermat kishin krevate me dërrasa. Krevatet e ngjitura radhë pastaj një korridor, 1,2,3,4, pra katër rreshta poshtë dhe katër reshta sipër dhe dy korridore. Dhe aty jetonim ne deri 500 veta në një kazermë. Nuk kishe as zjarr, as dritë, asgjë. Kishim kandil. Në kamp ishin dy italianë: Një elektrikist dhe një mekanik. Një mulli aty pranë e bënë central të vogël dhe i jepnin dritë Tepelenës dhe kampit.

Italianët ishin me forcat partizane apo të zënë robër?

Italianët ishin të internuar aty. Ata kishin bërë 5 vjet burg, dhe pas burgut i kishin sjellë aty. Veç familjeve ishin edhe persona që mbaronin burgun, por konsideroheshin me rrezikshmëri, dhe i sillnin aty, psh, kishte klerikë katolikë. Kishin bërë priftërinjtë nga 5 vjet burg, i lironin dhe nuk i dërgonin më në kisha ku kishin qënë por i sillnin aty. Ishte një kamp i përzier, familje dhe beqarë.

Në atë kamp ishte ftohtë në maksimum. Tepelena ishte vend i ftohtë me borë, binte gjysmë metër borë. Ne nuk kishim asnjë lloj ngrohjeje, fëmijët e vegjël të porsa lindur, me mosha të ndryshme, pleqtë e vjetër deri në 80 vjeç, rrinin kruspull. Ishe i sëmurë, vdisje aty. Kishte lloj-lloj sëmundjesh. Tani veç mungesës së higjienës, larjes pastrimit, larjes së plaçkave, kishte metoda të tjera për të shkaktuar vdekje masive. Tepelena si qytet ishte rreth 500 vetë, ne në kamp ishim 3000 vetë. Filli-

Kazermat kishin krevate me dërrasa. Dhe aty jetonim ne deri 500 veta në një kazermë. Nuk kishe as zjarr, as dritë, asgjë. Kishim kandil.

misht, buka na vinte nga Berati. Bukë misri. Gjatë verës, ishte nxehtësi e madhe, sa vinte buka nga Berati ne kampin tonë, ajo prishej krejt. Bëhej me penj të gjatë, thartohej. Por nuk kishim ç'të hanim tjetër. Fëmijët e vegjël, të moshuarit, i kapi dizanteria. Çdo ditë kishte 5-6 vdekje, në ditë.

Ku i varrosnit të vdekurit?

Përpara se të hynim në kamp, tek porta e kampit, ishte një shesh i vogël, pra, para kampit hapëm varrezat

A kishte shumë?

Aty pranë ishin dhe varret e italianeve të vrarë në luftë me grekët. Brenda 3 muajve, varrezat tona ishin më shumë sesa ato të italianëve. Pastaj, hapën një furrë aty në kamp. Sollën një furrxhi nga qyteti i Përmetit. Vinte mielli nga Tirana. Por kontingjentin e miellit tonë, ia çonin derrave në Gjirokastër, kurse miellin e derrave na e sillnin ne. Mielli i derrave ishte gjysmë miell e gjysmë miza. Furrxhiu, ishte burrë i vjetër, i mirë, vajti tek zyra e Frontit dhe tha: Ky miell është vdekjeprurës, i helmuar. Ata ia kthyen: Shko e piq bukën ti, se nuk të kemi marrë ty të na japësh mend. Furrx-

hiu nuk ishte i internuar. Nuk bënte pjesë tek ne. Derisa mbaroi mielli, në 3 muaj kanë vdekur mbi 200 fëmijë e pleq. Kryesisht fëmijë. Nuk kishte nëna t'i jepte gji, merrte bukën e fuste në gojën e saj, e përçapte në gojë, e bënte të butë si lla-pa dhe ia jepte fëmijës. Fëmija e kalonte. Ajo i bllokonte stomakun, i bllokonte zorrët dhe të nesërmen vdiste. Nga 5-6 fëmijë, ditë për ditë, deri kur mbaroi mielli. Mbaroi mielli, sollën miell tjetër. Njësoj ishte edhe ushqimi, makaronat ishin me krimba. Nga uria njerëzit e hanin.

Unë, bashkë me 4-5 fëmijë të tjerë, 10-12 vjeç, gjtëm një vrimë me tela, se ishim te rrethuar me tela dhe me ushtarë. Ishte prill, dolëm zbritëm poshtë. Poshtë kishte ferra dhe sipër ferrave kishte dalë gjeth- një si tip rrushi i egër. Rrush i egër kishte nxjerre gjethe të vogla. U ngjitëm nëpër ferra, hipëm atje sipër, dhe filluam të hanim gjethe. Ai gjethi ishte i mirë se ishte i tharët, mirë-po tani instinktivisht menduam ne, si puna e fëmijës, mirë po hamë tani, po pastaj? I futëm në gji, dhe mbushëm gjirin kaaaq me gjethe. Të gjitha i hëngrëm, nuk lamë asnjë gjë. U kthym po nga ajo vrima, hymë në kamp fshehurazi. Ishim përsëri të uritur. U themi nënave tona, na i zieni gjethet. I futën në një kazan, i zjenë. Nga i shijshëm si i

Miellin tonë

Furrxhiu, ishte burrë i vjetër, i mirë, vajti tek zyra e Frontit dhe tha: Ky miell është vdekjeprurës, i helmuar.

derrave në

Ata ia kthyen: Shko e piq bukën ti, se nuk të kemi marrë ty të na japësh mend. Furrxhiu nuk ishte i internuar. Nuk bënte pjesë tek ne.

miellin e de

Derisa mbaroi mielli, në 3 muaj kanë vdekur mbi 200 fëmijë e pleq. Kryesisht fëmijë.

na e sillnin

ë ia çonin

Gjirokastër,

errave

ne.

thartë kur ishte i gjallë, bëhej helm i hidhur, i zierë. Ne ishim të uritur, atë brumin me lugë e hanim. Na kapi barku, dizanteria, një javë desh kemi vdekur. As mjek, asnjëri, por na shpëtoi zoti. Kishte shkuar uria që, thonim, o zot, na ngop njëherë me bukë, e të vdesim.

Në Berat isha 8 vjec, në kamp në Tepelenë qëndruam deri në 1954 dhe unë mbusha moshën 16 vjeç me këtë lloj trajtimi. Të mëdhenjtë punonin. Gratë, vajzat, mosha jote, më e vogël se ti, shkonin për dru në male. Burrat i pritnin drutë me sëpata, i pritnin i bënin të vogla. Gratë ngarkoheshin dhe i binin mali në xhade ku do i merrte makina. Një motër e Simonit, ishte 17-18 vjeçe, e këputur nga lodhja. I themi të çante këmbën, të fuste një gjethe, ai gjethe ishte i helmuar, që të merrte raport, pushim. Ajo e futi gjethin, mirëpo këmba filloi u ënjt keq, u ënjt, dhe pa ilaçe e pa gjë, ajo mbeti sakate përjetë. Përjetë mbeti me shkop.

Çfarë pune bënit ju ku ishit 16 vjeç?

Një punë ishin drutë. Pasi i zbritnin nga mali, në darkë do i sillnin në Tepelenë, nga një barrë dru. Për moshat mbi 16 vjeç, vajza, gra, burra gjatë verës ishte kjo punë. Gjatë vjeshtës, dimrit mblid-

hej plehu i bagëtisë. Zona ishte plot bagëti , të cilat gjatë verës shkonin lart në mal. Atje bëhej edhe shumë pleh bagëtie. Këtë pleh shkonin e mbledhnin të internuarit. Ngarkonin thasët, edhe e sillnim nga maja e malit në Tepelenë. Kur binte shi plehu lagej dhe kullonte. Burra, djem, gra e vajza që e ngrinin në kurriz lageshin me lëngun e plehut. Në kamp nuk kishin ku të laheshin, nuk, kishin as ndërresa të shumta të ndërroheshin. Me ato rroba flinin gjumë. Kazerma qelbte erë plehu. Kishte shumë sëmundje të lëkurës, ekzema, zgjebe, puçra.

Kishim një vajzë që kishte mbaruar universitetin në Romë, e martuar me djalin e ish kryeministrit të Shqipërisë, Mustafa Kruja. Kur mbaroi lufta, kryeministri iku jashtë me njërin nga djemtë. Dy të tjerët që mbetën këtu, i futën në burg. Burrin e kësaj, e dënuan 15 vjet, kurse vëllain e tij e dënuan me 10 vjet burg. Familjen ia sollën në internim në Tepelenë. Kjo "italiania", i thoshim ne, kishte një djalë, i vogël fare. Italiania në internim ishte si të tjerët ishte njësoj.

A e mbani mend si quhej vajza?

Helena Merlika, një vajzë me universitet në atë kohë, e vetmja femër në Shqipëri, se nuk kishte universitet. Ngarkohej me dru dhe ishte e para e grave. Ngarkohej me pleh, e para, kjo. E gjatë, e bukur, se po të mos ecje, ishte polici. Femrat, vajzat për të mos i prekur polici, ecnin shpejt. Ky ishte trajtimi i njerëzve të pafajshëm, të pa dënuar.

Çfarë i ndodhi kësaj vajzës? Është akoma gjallë? Shpëtoi?

Nuk e di. Vështirë pas kaq vjetësh të gjesh gjallë vajza të asaj moshe. Aty në kamp kanë qenë shumë familje që kishin edhe lidhje me njëra-tjetrën. Ka qenë familja e Simon Mirakajt. Simoni kishte edhe vëllain Sokolin dhe motrën Adelajde, pikërisht vajza për të cilën pak më parë, thashë se shkaktoi një plagë në këmbë, por mbeti sakate përjetë.

Familja e Mirakajve, një xhaxha e kanë patur ministër të brendshëm, ai ishte jashtë. I ati i Simonit dhe një tjetër ishin këtu brenda. Të një familjeje. Një kushërirë e Simon Mirakaj, kushërira e tij, vajzë xhaxhai, Klora Mirakaj ishte në kamp. Kur djali i Mustafa Krujës, pra, kunat me Helena

Mërlikën, mbaroi dënimin me burg, e sollën në kampin e Tepelenës. Aty u njoh me Klora Mirakajn dhe u martua në internim me të.

Çfarë ndodhi kur ishit 17-18 vjeç, pas Tepelenës?

Atje do kishim vdekur të gjithë, pa përjashtim. Asnjë nga ne nuk shpëtonte! Erdhi shpëtimi, sepse e vranë Stalinin. Dhe ndryshoi situata atje. Hypi Hrushovi në pushtet. Ai i fali të gjithë të burgosurit politikë. Edhe atë që i kishte bërë atentat Leninit e fali. Kishte bërë 30 vjet burg ajo. Doli nga burgu 60 vjeç. Bëri reformë atje, e zbuti edhe komunizmi këtu. Si pasojë kampin e mbyllën. Por ne mbetëm në internim në fshatrat e Lushnjes. Atje ishin krijuar kampe të vogla, por atje kishe një lloj kasolleje a shtëpie për familjen më vete nga të tjerët. Për ne ishte gjë e madhe, dukej si vilë ajo përpara kazermave ku kishim jetuar 500 vetë bashkë. Edhe nëpër këto kampe, përsëri ti ishte i dënuar. Pa gjyq. Ishe i dënuar 5 vjet. Mbaronte 5 vjetëshi, vinte 5 vjetëshi tjetër. Komunikim: Je edhe 5 vjet i dënuar. Nga 1945 deri kur ra sistemi ky cikël dënimesh nuk u ndërpre ndonjëherë.

Janë 200-300 familje që e kanë filluar në 1945 dhe e mbyllën kur ra sistemi. Rreth gjysmë shekulli me dënime, 5 vjet e 5 vjet, vazhdimisht. Atje pastaj filluan, martesat. Të internuarit që kishin qenë në kampin e Tepelenës, tani ishin në tip qendra të vogla të ndara. Filluan fejesat. Mirëpo kur filluan fejesat, na dukej gjë e çuditshme. Duke jetuar për vite të tëra bashkë në vuajtje e mbijetesë ishim bërë si një familje e madhe kazermë, ishim bërë vëllezër e motra. Ndaj na dukej çudi, u fejuam filani me filanen. Kështu filluan u krijuan familje.

Unë me disa shokë të tjerë ishim në klasë të shtatë dhe na shoqëronte polici në shkollë. Na arrestuan dhe përfunduan në burg në Gjirokastër.

Sa vjeç ishit kur u arrestuat?

Ishim 15-16 vjeç.

Përse u arrestuat? A ishit në kamp?

Po, po ishim në kamp. Mundoheshin njerëzit të iknin nga kampi. Sa dilnin kapeshin.

Kush ka vdekur në burg dhe në internim nuk ka varr. Nuk ka varr!

U përpoqët të arratiseshit edhe ju? Tentuat?

Mosha 15-16 nuk duron më njeriu i lidhur. Tentativë arratisje, ishte akuza. Nga kampi në burg, pastaj prapë në kamp...Shokët e mi filluan me rradhë u martuan. Unë jo! Unë doja të ikja. Doja botën e lirë. Po nuk dija kufijtë. Nuk dija nga të shkoja. Më kupton? Tani, nuk kisha hallin se më kapin e më futin në burg. Por do më pushkatonin. Në momentin që do më kapnin do më pushkatonin. Kërkoja të gjeja një njëri që dinte kufirin. Kisha një të internuar aty, që e kishte shtëpinë mu në kufi me Jugosllavinë. Edhe bisedat bëheshin me shumë ndrojtje. Mund të të denonconte. Po edhe ai tjetri nuk të kishte besim, se dyshonte kushdo. Rastisi që ai u divorcua. Unë përfitova nga rasti dhe i them atij, a të ikim, arratisemi? E ke shtëpinë në kufi ti?- i thashë. E di kufirin? Po, -tha, - e di. Por është shpejt.

Ishte maj. Kishte dalë gjethja. I them, jo, ore, është kohë e mirë shumë, ka gjethë. Marrin ca gjethë, dhe ca kripë dhe, po ndenjëm shumë, gjethen e bëjmë me kripë dhe kalojmë 3-4 ditë. Rezistojmë për bukë. Ai më pa, - të presim edhe pak tha. E kuptova që nuk ka qëllim ky, po thashë, ishalla nuk më denoncon tani. Nuk më denoncoi. 5 vjet rresht, unë nuk u martova. Ama, kisha rënë në sy të Sigurimit të Shtetit. Kur dola nga burgu dhe shkova në kamp në Lushnje, dorëzova fletën e lirimit të burgut në degë. Kur lirohesh nga burgu të japin një fletë lirimi, për udhëtim, që gjatë kontrolleve mos të të ndalojë policia. Më thotë kryetari i degës, martohu..

Burgu në Gjirokastrë ishte në kështjellë?

Në Gjirokastrë, burgu i Gjirokastrës është burg nën tokë.

Nën tokë apo nën kështjellë?

Sipër vetes ke 10 metër dhë apo 12 metër dhë. Ka sipër tunele, tunele. Ai nuk ka qënë burg. Ka qënë galeri. Galeri katakomb. Atje na mbajtën deri në 1953.

Sa vite kaluat ju atje?

Një vit na ra, se shkuam në mbarim të 1952. Po të tjerë kishin që kishin ndenjur edhe 10 atje, derisa kishin vdekur. Nuk mund t'i thuash të huajit, se thotë qenka i çmendur, që vdiste njeriu atje. Para se të vdiste, e çonin në një tip biruce të rrumbullakët. Të çonin për të vdekur atje. Të futnin atje brenda. Ishte kaq me ujë. Të hidhnin në ujë. Ishte një zinxhir, 100 kg zinxhir dhe ta fillonin ta varnin për qafe. Edhe vdisje atje. Po mirë, si e çonin në varrim? Ishte një mulat, ne i themi jevg, ishte 100 kg ai. Atë e kishin pajtuar me lekë. Vinte ai, e këpuste në mes. E bënte dysh. E fuste në thes, e ngarkonte dhe e çonte, e hidhte në një gropë.

E keni parë vetë këtë?

Pasi kishim dalë nga nëntoka, ishim sipër, ishte sallë e madhe, me dritare, dhe shihnin nëpër dritare atë kur shkonte e hidhte thesin në një gropë.

E shihnit kur e varrosnin?

Kush ka vdekur në burg dhe në internim nuk ka varr. Nuk ka varr! Nuk ka varr! Nuk dihet ku e ka varrin! Të kthehemi përsëri në Tepelenë. Të kthe-

hemi në Tepelenë. Të gjithë ata që kanë vdekur në Tepelenë, nuk kanë varre! Tani, shih çfarë bënë; ishin varret para kampit, aty ku i patën varros. Po aty u vritnin sytë, policit, komandës, u vritnin sytë sepse para kampit ishte plot me varreza. Varreza fëmijësh. Urdhër!! T'i heqim prej këtu! Morën një grup burrash aty në kamp. Shkuan hapën gropat e në një vend andej pas. Do zhvarroseshin këta këtu, por kishte të vdekur nga 3 vjet deri në 3 ditë. Si do zhvarroseshin? Urdhër!! Secila familje të vijë me batanije pranë varrit, me batanije. Dhe fillonte zhvarrimi. Aty dilte trupi i fëmijës i pa prishur, e merrshin e hidhnin mbi batanije. Pa mbrojtje, pa garza, pa gjë. Sa vazhdoi?! Ditë për ditë mbaroi e gjithë varreza. I çuan atje, te varreza që hapën nga pas. Pas një viti, duhet t'ua humbnin gjurmët varrezave. Mos të kishte varreza. Atëherë jo ne, atëherë me ushtarë i shkulën prapë prej atje, i çuan poshtë, në breg të lumit. Kur erdhi lumi i dimrit, fiuuu. Po të shkosh sot në Tepelenë nuk ka varr. Atë vendin afër kampit që ishte me varreza, e bënë kopsht. Kopsht! Domate, specia, nuk merrnin të burgosurit. Të internuarit nuk pranonin të merrnin aty.

Jemi i vetmi vend, i vetmi vend, nga kampi komunist që të vdekurit në kampe nuk kanë varreza. Nuk ka varreza fare, fare, fare. Një nga kryeministrat e Shqipërisë, që kishte firmosur ndërtimin e burgut të Burrelit, atje vdiq. Nuk vdiq. E mbytën. E kanë mbytur me të gjitha torturat. Ata që kanë qënë atje, dëgjonin, e linin 10 ditë pa bukë fare. Pas 10 ditëve pa bukë, i çonin makarona. Makaronat ishin gjysmë për gjysmë me kripë. Ai hante nga uria. Hante nga uria. Pastaj donte ujë. S'ka ujë!! Derisa e kanë vdekur. Pra, një nga kryeministrat ka vdekur atje. Kush ka vdekur nëpër burgjet e Shqipërisë nuk ka varr! As në internim nuk ka varr!

Ka ndodhur një çudi. Një grua nga Tropoja, nga Lekbibaj i Tropojës, i kishte vdekur një fëmijë. E kishin varrosur. Nuk kishin filluar akoma zhdukjen e varreve. I erdhi lirimi. U komunikua lirimi sot në mëngjes, të nesërmen do ikte. Kishte edhe dy fëmijë të tjerë. Më i vogli i kishte vdekur. Natën, natën kjo, ka dalë nga kampi, ka shkuar te varret. Ka gërmuar, me duar, bam-bam-bam. Ka gjetur eshtrat, i ka marrë eshtrat, i ka mbështjellë eshtrat, i ka mbajtur natën me vete, në dyshek, i ka marr me vete, i ka varros atje. Një rast i tillë, nuk gjendet! Sepse një nënë që humbet fëmijë, një, dy, tre fëmijë, i lë atje

dhe prapë ka, si të thuash energji të jetojë. Kur po i zhvarrosnin varrezat, një grua nga Shkodra, duke qarë shikon se kur nxorrën fëmijën e parë, doli fëmija i pa prekur, akoma nuk ishte tretur. Shkoi ta kapte e ëma, Një grua, shpërtheu në të qeshur. Të tjerat qanin, ajo qeshi me të madhe. Dhe njerëzit e panë me çudi, ajo ishte çmendur... Shikonte fëmijën dhe qeshte.. Më vjen shumë keq që t'i them unë ty këto gjëra, sepse janë të pa imagjinueshme. Të pa imagjinueshme!

Unë kam emigruar në Greqi, një vit e ca, fill sa kam dalë nga burgu. Më 10 janar 1991 kam dalë nga burgu dhe më 20 mars 1991 kam ikur në Greqi. Burgu im i fundit ai ishte, i Gjirokastrës... Pastaj u riktheva.

Tri herë jam dënuar në burg brenda, duke qënë në burg. Sa afroja dënimin unë, më futnin edhe 10 vjet të tjera. Sa afroja atë përsëri. Jam i fundit në Shqipëri, i fundit, jam dënuar në burg. I fundit. Jam dënuar më 28 tetor 1990, në burgun e Elbasanit dhe më 10 janar të 1991, kam dalë.

Kur shkova në Greqi unë, shkova si refugjat. Më pajisën me kartën e refugjatit të OKB-së. Kur panë ata, kisha dënimet nga Gjykata e Lartë, dënime gjithë jetën burg, dhe më pajisën, isha refugjat i OKB-së, nuk kishte punë policia të më merrte. Nuk kishte punë policia fare. Vajta në ambasadën amerikane, bëra edhe dokumentet, më caktuan datat për të marrë vizë, më 24 korrik. Unë më 1 korrik në Shqipëri. Djali i vogël e kishte ëndërr të rrinte atje. Ëndërr për punën e shkollës. Donte të mbaronte shkollën atje. Këtu, mbaroi shkollën e ciklit të ulët, nuk e çonin në gjimnaz. Nuk e çonin në gjimnaz. Kishte dalë me të gjitha 10-ta. Nuk ka gjimnaz. Nuk e çonin. Mirëpo unë u ktheva në Shqipëri.

Po pse u rikthyet ju?

Ata, po mos të isha unë nuk i çonin. Po erdhën edhe ata pastaj, nga Greqia erdhën këtu. Ai u fut në shkollën e gjuhëve të huaja në anglisht. Dy vjet, se ishte i madh. Ishte 18 vjeç. U fut në vit të tretë të shkollës se mesme. Dy vjet, para dy vjetëve me të gjitha 10-ta. Unë isha në burg, burg shtëpie unë. Sepse edhe demokracia më futi në burg mua. Bëmë një grevë urie ne të burgosurit. Bëmë një grevë urie, na nxorën jashtë ligjit. Si në diktaturë. Unë drejtoja grevën e urisë aty ku kemi zyrat ne.

Çfarë punuat pas diktaturës?

Pasi ra sistemi? Unë kam qënë kryetar i shoqatës të të burgosurve politikë. Kryetari i të burgosurve politikë të Shqipërisë..

Si u zgjodhët kryetar?

Me konferencë kombëtare. Kishte përfaqësi në gjithë qytetet, degë në të gjithë qytetet. Siç organizohet një parti politike. Në të gjithë qytetet dhe qendra ishte këtu në Tiranë. U bë delegatë nga e gjithë Shqipëria, me votim dhe më zgjodhën mua. Mirëpo, ne kërkonim disa të drejta. Disa të drejta tona, që i pranonte jo vetëm sistemi i demokracisë, por ishin të drejtat e njeriut. Këta nuk na lanë të vdisnim, këta na hynë në dru. Edhe mua më burgosën përsëri. Kam ndenjur përsëri 4 muaj i burgosur, me këtë demokracinë, pse drejtova grevën e urisë. E kupton tani?! Djali atëherë, unë duke qënë në burg, djali ...

Kur jemi bashkë mundohemi mos t'i kujtojmë. Jo me i harru, por mos t'i kujtojmë. Sepse janë trishtim.

Si ndiheni ju, për mënyrën se si e ka trajtuar qeveria e sotme kohën e komunizmit?

Dëgjo, unë flas personalisht, e kam jetuar të ashtuquajturën demokraci me pak ndryshim nga diktatura. Cili është ndryshimi? Ndryshimi është se në diktaturë kam pasur më shumë vuajtje fizike, mundime fizike, kurse në demokraci, shpirtërore, mendore. Ai njeri që vuan, ai ka prirje të fali. Ai që vuan fal. Dhe ne, që atje në burg, atje ku ishim, nganjëherë na hipte urrejtja dhe thonim t'i hamë, t'i shkrijmë, kur dolëm, ne u treguam humanë. Këtu u bënë vrasje njerëzish më shumë se në diktaturë! Shqip-tarët, bam-bam-bam. Anarshi, ra shteti. Te burgosurit asnjë. Asnjë hakmarrje, fare.

Po ju vetë, personalisht i keni falur dëmet që janë bërë?

Ne kërkonim që hakmarrja të bëhet, por me drejtësi. Me drejtësi,

A do donit të ishin në burg këta oficerët e Sigurimit?

Jo. Dëgjo. Ki para sysh, në burg i burgosuri me ofi-

cerin e sigurimit, është njësoj sikur në pyll njeriu takohet me ujkun, me ariun. Ballafaqohesh me ujkun me ariun në pyll, ashtu ishte ballafaqimi jonë me oficerin e Sigurimit në burg. Ashtu e shihnim ne atë, ose ai në. Sepse ai thoshte, "Për ideal të Partisë". Ne e urrenim Partinë. Ai Partinë e kishte Perëndi, jetë e kishte atë Parti. Por megjithatë, kur ne dolëm jashtë, ne kërkonim që gjykatat të merrnin nën hetime ata që kanë bërë krime. Prokurorë, oficerë sigurimi, kush ka bërë krime të japi llogari para gjyqit. Thonim ne! Kurse sistemi, sistemi i ashtuquajtur demokratik, i vuri në poste. Atë gjyqtarin e la prapë gjyqtar. Atë prokurorin prapë prokuror. E kupton?! Atë oficerin e sigurimit, prapë oficer sigurimi.

A keni parë ndonjëherë ndonjërin nga këta? Njihni ndonjë?

Ne tani ballafaqoheshim me atë që e kishim patur në burg, ballafaqoheshim prapë. Dhe na shihnin, na shihnin përsëri me syrin e armikut. Derisa ne pastaj arritëm në një grevë urie dhe mua disa herë më kanë arrestuar. Bënim grevë urie ne, bënim demonstratë ne, përplaseshim me policinë. Edhe këto 25 apo 27 vjet që janë, unë i kam kaluar luftë. Luftë! Luftë me sistemin.

Po sot? Sot si jeni? A jeni në luftë?

Tani jam elektron i lirë. Tani kam hequr dorë nga të gjitha.

Pse?

Sepse u lodha shumë. U lodha shumë.

Cili është mesazhi për brezin e ri? Për rininë?

Mesazhi im për njeriun është; mundësisht në asnjë rrethanë mos të bëjë keq, po ka mundësi të bëjë mirë, bravo! Keq mos të bëjë, kurrë!

Jeni zënë ndonjëherë fizikisht? Jeni rrahur ndonjëherë me policët?

Jo, nuk është çështja e asaj. Është çështja se tani Shqipëria ishte e hapur dhe ti ishe në burg! Në burg! Ka kaluar jetë, më ka lodhur shumë. Kam humbur kohë. Kam humbur energji. Kam humbur shumë kohë! Dhe nuk kam arritur t'i justifikoj këta që përfaqësoja. Nuk i justifikoja dot, ç'të bëja?



...ka qenë shtëpi e mirë e punës. Vinin kosovarët u jepnin bukë. Kjo bukëdhënia i ka shpëtuar të gjithë... Kurrë nuk të gjen gjë prej bukës dhe nderës që kemi dhënë. Ka qenë shtëpi e madhe: 36 vetë kanë jetuar të gjithë. Në atë kohë ishim 36 bashkë!

E kam falënderuar se ma ka çu' babën në burg Age Mirash Noja

INTERVISTOI KRISTALE IVEZAJ RAMA

Unë i kam
falënderuar, edhe
baba i ka falë.
Baba i ka falë!
Pse i ka falë?
Sepse ka pasur
fatin me ndejtë
me njerëzit më
të zgjuar të
Shqipërisë!
Edhe unë kam
fituar vlera aty.
Kam mbaruar
universitetin më
të bukur në botë,
me këta njerëz
me kulturë
shqiptare!

Familja e Sadri Lukës, kurrë në botë nuk kishte pas nevojë për me ikë me banim dikund tjetër, të kishte ndejtë këtu, tek shtëpia e vet.

Kush është Sadri Luka?

Luk Sadria, Sadri Luka, Noel Mirakaj, brezi i fundit ka vuajtur. Ata kanë qenë të parët që kanë thyer disa rregulla.

A mund të na tregoni përse shteti i asaj kohe ju ka përndjekur?

Baba im, Mirash Mirakaj, nuk ka qenë dakord me sistemin. I kam gjet' dëshmitarët... Njeri ishte kushëriri jonë. E kam falënderuar se ma ka çu babën në burg.

E keni falënderuar?!

Ka ndejtë me burra të zgjuar. Me Atë Zef Pëllumbin ka bërë burg, por ky na ndihmoi, ky kushëriri që ishte oficer në Lezhë.

Ai që ka spiunuar babën?

Unë i kam falënderuar, edhe baba i ka falë. Baba i ka falë! Pse i ka falë? Sepse ka pasur fatin me ndejtë me njerëzit më të zgjuar të Shqipërisë! Edhe unë kam fituar vlera aty. Kam mbaruar universitetin më të bukur në botë, me këta njerëz me kulturë shqiptare!

A të ka treguar babai çfarë i ka ndodhur në burg?

Zonat fetare katolike kanë qenë baza kryesore e sulmit...Ja, Çertifikatë Mirënjohjeje, Unioni i Parë Kombëtar i Integritit i Ish të Përndjekurve dhe Burgosurve Politikë të Shqipërisë. Bazuar në ligjin kaq, kaq e datës 29.07.1993, statusi i të Përndjekurve Politikë, i jepet z. Marash¹, Nderi i Përndjekjes Politike të Shqipërisë, për qëndrim dinjitoz në burgjet politike të sistemit komunist

1. Në çertifikatën e Mirënjohjes figuron emri Marash Mirakaj, kurse vetë e bija përdor emrin Mirash për të atin. Ajo është prezantuar si Age Mirash Mirakaj. Noja është mbiemri i saj nga burri. Ishte zakon në zonat e veriut të Shqipërisë që emrat thirreshin dhe nguliteshin në përdorim pak më ndryshe, si në këtë rast Marash Mirakaj dhe Mirash Mirakaj. (Shënim i redaktore M. Sinani.)

dhe kontribues në lëvizjen demokratike duke u bërë shembull frymëzimi për brezat e rinj. Edhe daja i madh e ka pas kështu.

Age, si filloi ky kalvar vuajtjesh për ju? Sa vjeç keni qenë? A mbani mend gjë? Çfarë kujtoni nga fëmijëria?

Unë jam e datëlindjes 1940. Isha 7 vjeç. Vëllain, Palin, më i madh se unë, nuk e mbaj mend mirë; ka shkuar me babën, e mori ai me vete. Pali ishte 12 vjeç...

Ku iku babai juaj dhe përse? Çfarë ndodhi?

Në atë kohë, baba ka patur shoqëri me të gjithë. Shtëpia jonë i ka dashur e pritur të gjithë. Paska qenë një polic kuksian në postë dhe i ka thënë babës: Ty duan me të arrestu. Pse?- i ka thënë baba, -unë nuk kam bërë gjë. Po,- i ka thënë polici, - kam dëgjuar vetë kapedanin që do me të arrestu. I ka thënë baba:-Unë gjë nuk kam bërë, por, mirë. Ma sill urdhërin vetë. Polici ka shkuar në postë, ka shkruar, i ka vënë vulën e kapedanit, që dikujt ia ka marrë dhe ia ka sjellë babës. Policin, i paskëshin ikur njerëzit e vet që kishte në Kukës. Ai e dinte që tani do e arrestonin. Donte të ikte, po nuk e dinte rrugën me shku pas tyre, prandaj kishte hall me e marr babën pas vetes dhe me ik me të, sepse ky e dinte rrugën. Prandaj ky, erdhi të nesërmen, ia solli ato deklaratat që i kishte shkruar vetë, vulosur vetë, dhe i ka thënë babës: Ty duan me të arrestu, e ke të sigurtë.

Atëherë baba i ka thënë, mirë. Mirëpo polici i tha se edhe ai nuk mund të rrinte më në postë, meqë ai i kallëzoi babës për arrestimin, prandaj duhej të shkante dhe ai me babën me kalu kufirin. Baba pranoi, e kur polici u kthye sërish për në postë, baba u tremb e mendoi se po vinin ta arrestonin. Baba kishte dy vëllezër: njëri quhej Dedë dhe tjetri Gjelosh. Tre vëllezër qenë. Gjeloshin, shpejt, e mori me vete, kurse Deda ishte në Shkodër dhe nuk kishte kohë ta priste.

Me nxitim, baba i çoi njoftim nanës: Po largohem se po më kapin. Po marr Gjeloshin, pra, vëllain, dy vajzat e mëdhaja, dhe djalin, që ishte 12 vjeç. Nëse vjen policia mos më tradhto! Dhe janë larguar në një vend të fshehtë, se baba nuk ia ka patur besën atij policit.

U largua baba, erdhi nata, dritë nuk ndiznim, gjumi nuk më merrte. Kisha frikë se po vjen e po më merr polici. Duke ndejtur, kur vjen polici me tri armë në krah: Një për vete, një për babën dhe një për axhën. Ua kishte marrë shokëve, në postë, atyre që kishin shërbim roje, a kush e di sesi, po, armët aty i kishte marrë. Kur erdhi me pushkë në krah, mori vesh se baba ishte nisur. Ai nguli këmbë se kishte lënë fjalën të shkante me babën, prandaj edhe i kishte marrë armët. Atëherë nëna i ka kallëzuar se po fshiheshin në filan vend. Ai shkoi atje, u dha armët dhe tok ikën për në Jugosllavi. Kanë shkuar maleve në këmbë, se nuk ka pas rrugë makine atëherë. Por dhe të kishte, po të shkonin rrugës, i kapnin. Dhe kanë mbrurit në Jugosllavi.

Axhën që ishte në Shkodër, baba u përpoq ta lajmëronte. Ka pas gjetur një shok të vetin e ka paguar dhe i ka thënë t'i dalë përpara t'i dëftojë vëllait kur të kthehet prej Shkodrës çfarë kishte ndodhur dhe që ishte rrezik ta kapnin dhe axhën, prandaj duhej të largohej dhe ai. Mirëpo ai shoku, i mori lekët dhe nuk e kreu punën. Ne e kemi patur repartin ushtarak shumë afër shtëpisë. Axha nuk dinte gjë dhe u kthye. Mu te reparti e ndaluan. E lidhën dhe e mbajtën atje. Ai ka vuajtur nëpër burgje, s'di sa vjet. Nja 13 vjet ka ndejtë. Nuk mbeti asnjë që t'i shkante ta shihte, se, pa u bërë java, si ikën ata, neve na internuan.

Çfarë ndodhi me ju?

Në mbrëmje kanë ardhur e na kanë marrë. Kemi fjetur në postën e policisë, se e kishim edhe postën e policisë afër. Të nesërmen, na nisën për në postë të rrethit. Na lanë tri javë në kodër të Shën Gjergjit. Kam qenë 7 vjeç. Kam pas qenë me nënën, gjyshen, nusen e axhës Gjelosh, me motrën -Pashkën. Nëna e babës quhej Lorja. A e ke njohur Gjeloshin? Andej ka vdekur edhe ai.

Po, Gjeloshin e kam njohur.

Veç atë martesë ka pas dhe ka lënë dy varza të vogla: Tinën dhe Prenën. I ka marrë krejt gjyshja. Bashkë kemi qenë. Prej Thethit na kanë çuar në Shkodër. Tri javë ndenjëm atje në burg.

Kanë qenë vetëm femrat?

Ne si familje, gra e fëmijë, po kishte edhe të tjera. Në Shkodër, në burg, ishte shumë rëndë, nuk kishim as ujë, asgjë. Edhe kur na çonin për të mbushur ujë tek çezma, nuk dallonim as rrugën nga duhej të shkonim. Pastaj erdhi një kamion, e mbushën plot dhe na nisën për në Tepelenë: atje ishte kampi. 6 kazerma të mbushura plot me njerëz të internuar. Kishte plot të tjerë edhe para nesh. Na lanë të flinim drejt e përtokë, tri muaj veç përtokë. Më pas na futën në një kazermë. 800 vetë një kazermë. Ku merrej vesh aty. Flinim në krevate për ushtarë, me kate njëri lart e tjetri poshtë. Fëmijët mezi hypnin. E binin përtokë prej aty. Kemi ndenjtur aty 5 vjet. 5 vjet në Tepelenë. Gratë i mblodhën t'u bënin gjyq. Keni dashur dhe ju të ikni, u thonin. U keni dhënë bukë për të ngrënë. Po ç'bukë, ata ishin në Jugosllavi. E kanë munduar nënën, edhe nusen e axhës, Dilen.

Çfarë mbani mend prej kampit të Tepelenës?

Nëna Rinën e kanë shti në punë. Shkonin për të mbajtur dru rrethuar me policë. Të gjithë punëtorët që ishin pak të fortë, atje i çonin të tërë bashkë. Mbanin dru dhe i ulnin tek rruga.

Si ka qenë fëmijëria juaj në kamp?

Nuk mbaj mend shumë. Bukë 500 gr, me miza, me kryma. Fiknim dritat kur uleshim për bukë. Nëna na lutej, hajt more, hani. Na kujtonte se baba kur u detyrua të ikte, kishte thënë, a është më mirë me shku baba në burg apo me ik? E Pashka i kishte thënë, jo, më mirë me shpëtu. Tash, kur na jepte për të ngrënë, nënës i binin lotë, se nuk kishte çfarë të na jepte. Na jepnin me racion gjithçka, ishin 9 kazanë, aty zienim për të ngrënë grurë bollgur.

Më kujtohet nusja e axhës e kishte vajzën e vogël, 3 vjeç. Nuk kishim as zjarr, as shihnim dritë kund. E shkreta, shkonte të lante teshat e vajzës, po nuk kishte me se ta ndërronte se s'kishte tesha të tjera. I shtronte për t'i tharë aty ku flinte. Atëherë edhe u sëmur keq. Kemi ndenjtur 5 vjet në Tepelenë, më pas na çuan në Lushnje. Kur erdhën të na merrnin, kanë qarë të gjithë. Thonim: Po na çojnë edhe më zi, boll zi ishim. Na transferonin sipas rretheve. Ishin makinat nga rrethe të ndryshme. Na çuan në Lushnjë, në bujqësi.

Një oficer, kurrë nuk e harroj, tha, pse qani, pse mërziteni, më mirë keni për të qenë. Lum kush ka shpëtuar! Vdisnin nga dhjetë, mu në mesditë. I kishte kapur sëmundja, dizanteria. Fëmijës nga goja i dilte gjak. Ai tha, lum kush shpëtoi, se tani më mirë, po shkoni në Lushnje. Ne nuk e besonim. U bënë nja 7 a 8 makina me rrethin e Shkodrës. Të gjithë nga Shkodra, Tropoja e Kukësi. U mbushën 8 makina me shkodoranë. Shkuam në Lushnje. S'dinim ku po na çonin. Po mirë, boll mirë ishim. Na çuan në do shtëpira, në fermë. I kishin caktuar ata, sipas rretheve. Kur mbërritëm edhe ne, na caktuan një shtëpi e kemi shkuar atje. Atëherë kemi ndenjtur edhe 3 muaj prapë aty. Edhe në Lushnje ishim me apel të mos ikte kush. Dy herë në ditë. Në mbrëmje sërish duhej të paraqiteshin të gjithë.

Domethënë, si ishte rregulli i paraqitjes për kontroll, në ç'orë?

Në orën 7 të mëngjesit ende pa shkuar në punë. Edhe në mbrëmje, pa u errur. Aty prapë ushqimin e kishim me kazan. Tri muaj me kazan si ushtri. Pas 3 muajsh, na thanë të punonim si të lirë, punë në bujqësi, në fermë.

Kështu, pra, ju ishit ende fëmijë e parritur kur filluat të punoni "e lirë"?

Po, në Lushnje mbërrita 12 vjeçe. Dhe, besa, kur na kanë thënë duhet me punu të lirë, nuk mundesha ta ngrija bishtin e shatit dhe lopatës për të bërë kanale. Këto ishin punët më të vështira.

Një fëmijë vetëm 12 vjeç i japin punë të hapë kanale në mes të llucës?

Ne kishim ardhur fukara, pa gjë prej Tepelenës. Nuk kishim as çizme. Në kanal duheshin çizme. Më kapeshin ushujëzat nga këmbët dhe pinin gjak. Me lekët e para që morëm blemë çizme dhe bukë.

Nënë Rina a ka punuar me ju në kanale?

Ajo, në kanale atëherë nuk ka mundur. As nusja e axhës, se kishte fëmijën e vogël. Ato janë marrë me pastrim kazermë. Por ato i janë nënshtruar gjykimit; ata i kanë munduar, po neve nuk na kanë kallëzuar gjë. Nuk dimë çfarë u kanë bërë atje.

Ne kishim ardhur fukara, pa gjë prej Tepelenës. Nuk kishim as çizme. Në kanal duheshin çizme. Më kapeshin ushujëzat nga këmbët dhe pinin gjak.

Ne ishim fëmijë. Edhe neve, na kanë çuar për të na gjykuar, aty në Lushnje. Atje ishin ca burra të ashpër. Thoshin, tregoni të drejtën që e keni parë babën atje. U ka çuar nëna ta shikoni.

A u përpoq babai juaj, Marashi t'ju merrte?

Atëherë pati ardhur, po ishte vonë.

Po kur ju çuan në Lushnje, e mori vesh? A bëri ndonjë përpjekje t'ju merrte?

Pati ardhur me do shokë me na marrë, por kanë rënë në përpjekje me ushtrinë. Në kufi ka qenë reparti ushtarak. Mirashi nuk ka dashur kurrë me na lënë. Ai nuk u martua më, kurrë.

Pra, është ndeshur me forcat e kufirit?

Po, me forcat shqiptare të ushtrisë. Ai donte ta merrte gruan edhe vajzat kur mësoi se na liruan prej Tepelenës dhe na çuan në Lushnje. U nis me disa vetë, por nuk mundi. Vëllai tjetër që mbeti në Shqipëri, axhë Deda, ka vuajtur shumë në burgje.

Është dënuar dy herë nga 8 vjet. 14 vjet i ka bërë burg.

Në cilin burg, ka qenë?

Në disa burgje: Tiranë, Shkodër, Lezhë. Ka bërë burg shumë. Ai ka qenë shumë punëtor, mjeshtër i madh. Nuk kanë pas nevojë kurrë me ikur prej Shqipërisë. Ka punuar edhe vullnetar. Shtëpia e tyre ka patur tokë e mall, çdo gjë gjeje atje. Ata veç komunizmi i ka larguar dhe mashtrimi. Ata kanë patur kostarë me e kosit barin 80 në ditë; kanë patur 500 kokë dhenë e plot pasuri. Ua bënë me hile, me mashtrim. Kur na kanë internuar, në shtëpinë tonë kanë futur gjithë repartin ushtarak, aq e madhe ishte. Nuk kishin ku ta strehonin dhe na hoqën neve e na morën shtëpinë. Shumë të tjera i kanë djegur fare. Për këtë tonën erdhi urdhëri të mos digjej. Ishte shumë e madhe dhe u duhej.

A ishte më mirë jeta në Lushnje?

Po, po, më mirë se në Tepelenë. Pas 3 muajsh,

**Babës i çuan fjalë
duke u tallur:
O Mirash, të ka
vdekur nëna, a po
vjen ta shtish në
dhe? Nuk ishte
asnjeri prej nesh
atje. E ka varrosur
një nga dhëndurët
e saj që ishte atje
tok me të birin...**

na lanë në punë të lirë, kanaleve. Në Tepelenë, kemi kryer gjithfarë punësh që kanë dashtë ata. Fëmijë e gra. Burrat i çuan për të bërë tulla. Burrat e shkretë kishin pirë ujë deti, ujë të kripur e ishin qërruar nga sytë. Për krahësh i mbanin dhe i kanë futur nëpër kazerma. Se kishin pirë ujë të kripur. Këta që bënë tulla për të ndërtuar shtëpitë shtetërore punën e kishin pa lekë, quhej punë vullnetare; për atë punë nuk na kanë dhënë lekë. Vullnetarë, me atë copë bukë me racion. Kur erdhëm në Lushnje ka qenë

një fije më mirë. Në Tepelenë ishim të rrethuar me tela. Nuk na linin të shkonim as te çezmat që i kishim brenda në kamp. Kishte plot sëmundje e vdekje. Të sëmurët rëndë i çonin në Gjirokastër, në spital, me kamionë, se nuk kishte makina të tjera, shoqëruar me policë. As ambulanca, nuk na sillnin. Të vdisje rrugës, nuk merrte vesh njeri. Gjithkush ka vdekur rrugës për në Gjirokastër. I kanë qitur nga makina, i kanë lënë rrugës aty në mal, pa e ditur se në ç'vend.

Edhe pranë lumit të Vjosës, u bënë shumë varre. Pas drejtorisë kishin bërë gati vendin për varret, si për katolikë, edhe për ortodoksë e myslimanë. Por drejtuesit dhanë urdhër të largoheshin të vdekurit prej aty. I kemi çuar tek ura e Bënçës. I mbartën të gjithë të vdekurit e i çuan aty. I kapnin për krahësh e për këmbësh. U këputej krahu... o o zot, thoshte nëna ime, se kishte shkuar edhe ajo me i mbajtur. Thoshte, oh, çfarë kemi hequr, se i nxirrshin nga gropa për t'i çuar te vendi tjetër, dhe u këputeshin këmbët... Hoxha ka ndejtur gjithë natën duke kënduar. Ne ishim të vogla, por kishim merak me e dëgju.

Mbaj mend që kur kemi ardhur në Lushnje, thanë se e kapën Hamit Matjanin. Nuk di prej nga ka qenë. Veç di që e kishin kapur se ishte arratisur. E vunë në trekëmbësh aty, në fushë të sportit, dhe kanë marrë të gjithë kampet me të internuar i kanë çuar ta pështynë. Ishte arratisur, e kapën, e vranë, e varën dhe na thanë shkoni e pështyni.

Po nëse nuk e bënit?

Të shanin, të bërtitnin. Ne thonim s'kanë nga na çojnë më zi. Nuk na nxinte as burgu se ishim shumë.

Sa vjet keni jetuar në këto kushte në Lushnje?

Kam kaluar plot 13 vjet. Pastaj jam martuar dhe i kam lënë njerëzit e mi atje.

Bashkëshortin e ke njohur aty, në Lushnje?

Jo, as nuk e kam takuar, as nuk e kam ditur nga vjen.

Edhe ai ka qenë i internuar?

Jo, jo, ai ka qenë i lirë. Djali i tezes më ka nxjerrë mua, se atëherë me shkuesi ishin punët. Ai i kishte 4 vëllezërit të gjithë në Jugosllavi. 5 vëllezër ishin ata. Kanë pas ikur krejt me të gjitha, me tesha, bagëti e çfarë kanë patur. Në fillim lypën motrën time. Kur ata kanë ikur në Jugosllavi, ky ka qenë ushtar, prandaj e kanë prurë në internim. Atëherë lypi motrën time, biles nëna nuk deshte t'ia jepte. Thoshte: Unë nuk di, nuk e njoh. Nuk dua t'ia jap. Dhe nuk donte me ia dhënë; Ky u shkroi vëllezërve në Jugosllavi: Merruni vesh. Kështu nënës sime i erdhi një letër, mirëpo nëna as e pranoi letrën. Pastaj i erdhi një telegram.

Si ju ka ardhur telegrami në internim?

Po, ka ardhur. Ndahej posta për çdo ditë. Kontrolluhej. Nëna nuk ia pranoi letrën, atëherë erdhi një telegram që thoshte, mos bëj fjalë as një, as dy, por jepja vajzën Palit. Nëna ime u detyrua dhe ia dha. Ama, me mërzi se nuk e njihje, nuk dinte nga vjen, a ka shtëpi a çfarë ka. Motra u martua atëherë. Pas dy vjetësh, vijnë e më kërkojnë mua.

Po shkuesi, si ka ardhur në internim?

Ishim në internim ne, po nuk ishim në një sektor. Kunati, ai që mori motrën time, ishte në Savër. Ne kemi ndenjur më larg, në një tjetër vend, në Plug të Lushnjës. Tek puna e ka parë, e ka pëlqyer dhe e ka lypur motrën time. Ne kemi punuar edhe në fermë. Kunati me bashkëshortin tim të ardhshëm ishin djem tezesh. Nëna ime nuk donte. Ajo ka qarë gjithmonë për mua. Si të të jap edhe ty? Edhe të parën ashtu e dhashë, pa pëlqim. Ty të kam në qafë vetë. E kam merak, se për këto gjëra janë bërë luftëra gjithmonë. Kur nuk kanë përparuar, kanë thënë, ja, shkjaun nuk e ka lënë me bo hajër kurrë. Prandaj ajo nuk ka pas qejf, hiç.

Djali po më pëlqen, thoshte, po nuk di a ka gjë, e nuk dua ta di. Me atë djalë e di që bën jetën. Nuk lypte pasuri, kurrëgjë. Veç me atë djalë, thoshte, ta kesh mirë. Në qafë të kam vetë. Atëherë u martova. Kam pritur 2 vjet, se nuk më erdhi lirimi. Një herë erdhi tek ky djali i tezes. Pas dy vjetësh pritje, më erdhi lirimi. Djali i tezes i nisi telegram dhe e njoftonte që u lirova. U lirova me motrën, se ishte edhe ajo e internuar. Atëherë edhe nëna u lirua; ishte 25 nëntor. Atëherë kanë ardhur e më kanë marrë. Pas dy vjetësh kam shkuar me i pa njerëzit e mi. ...Kur u lirua, gjyshja shkoi në Theth, por vdiq pa dalë ende axha prej burgut. Ka vdekur tek shtëpia në Theth. As të shkonim nuk mundeshim, por lajmin na e sillnin. Edhe babës i çuan fjalë duke u tallur: O Mirash, të ka vdekur nëna, a po vjen ta shtish në dhe? Nuk ishte asnjëri prej nesh atje. E ka varrosur një nga dhëndurët e saj që ishte atje tok me të birin... Këto vuajtje nuk numërohen.

Sa vjeç ishit ju kur u larguat nga kampi?

Prej Lushnjës, 17-18 vjeç, kur jam martuar, 19 vjeç, besa.

Ku keni jetuar me burrin?

Këtu, gjithmonë, që kur jam martuar.

Si ishte jeta me burrin?

Mirë. Kam thënë që unë kam qenë prej familjeve më të mëdhaja që ishim në kampin e Tepelenës, edhe në Lushnje. Të gjithë, bashkë, familjet më të mëdhaja: familja e Abaz Kupit, Gjon Markagjonit, Hasan Dostiit, Prek Pervizit, Kolë Bib Mirakaj, etj. Dhe nuk martoheshin me shoqe-shokun.

Kishim edhe italianë të internuar. Kishin ndenjtur në Tepelenë, erdhën edhe në Lushnje. Punonin në kanal. Bile Atë Frati, kur ata do largoheshin, i ka pyetur se çfarë donin si kujtim prej Shqipërisë? Ata thanë: Jo, nuk duam kujtime, se kemi kujtime sa nuk mundemi më. Kemi kujtime boll prej Shqipërisë.

Për cilën arsye e arrestuan burrin tuaj?

Burri im, besa, 7 vjet martesë kam pasur. Më ka lënë me tri fëmijë. Vetëm se ia vodhën shtëpinë.

E ka sharë Enverin. ...Agjitacion, thonin ata, agjitacion e propagandë. Nuk ishin të vërteta, por kishin hall me e shti brenda, se kish marrë vajzën e të persekutuuarit... të prekurën. Nuk kishim të drejta ne për asgjë. As për shkollë, as për shumë punë, se ishim të prekur. Atëherë e kena vuajtur, e kena ditur.

A është martuar ndonjë vajzë në familje komuniste?

Jo. Të gjitha familje si ne. Familje të prekura. Aty u ka dasht me i dhënë ose me i lënë në shtëpi. Edhe kur më ra burri në burg, erdhën me na sekuestrue. Kishim tri fëmijë edhe ishim me kunatin, se ka pas veç një vëlla dhe nanën burri im, kurse baba i ka pas vdekur. Erdhën më sekuestruan edhe bagëtinë. Unë desha ta marr një lopë se duhej të pinte fëmija, nuk më la kunati. Po, na i morën të gjitha. Çfarë me bo?- i thashë. E çuan në burg. Në gjyq pas disa kohësh, e dënuan 3-4 vjet. E çuan në Vlorë. Aty e ka bërë burgun. Ne nuk kishim mundësi me shkuar në Vlorë. As me e pa me sy. Vuajtjet tona nuk mbaronin.

Sa fëmijë keni patur kur bashkëshorti juaj hyri në burg?

Tri, dy i kishim binjake, edhe tani i kam. Njëra e martuar në Koplik. U rritën si u rritën. Me sherbet, me sheqer.

Çfarë ndodhi me Rinën? Po pjesa tjetër e familjes?

Ato familjet ndenjën atje. As nuk i liruan krejt. Lora u kthye më përpara, se u liru axha prej burgut. I shkreti donte me liru edhe nënën, me ardhur nëna se rrinte vetëm. Ia liruan nënën, erdhi me ne. Për një fjalë goje, e kanë shti për të dytën herë në burg!

Kanë shkuar të gjithë në brigadë të punojnë në kooperativë dhe ka thënë që atë e kanë dorëzuar jugosllavët. Aty e kanë pyetur: Si e kalonit atje, në Jugosllavi? Si ikte jeta, kishit për të ngrënë? Atje janë tuj vdekur se nuk kanë as me ngrënë as me pi askurrëgjë! Ky ka thënë: Si more, unë kam dy vëllezër atje, ka qenë më i pasuri, me i shitur nja dy kuintal kërtolla. Edhe e kanë kapur e kanë arrestuar e në burg prapë për të dytën herë. Për

atë fjalë që ka folur. Pse i ka thënë shokut të vet, janë dy kunjtal e po ia postoj vëllazerve.

Edhe që jam martuar me të, njerëzit e dinin që s'kam rob. A kam vëlla a kam motër, nuk dinin kurrgjë, se thoja, po i qis këta rob në sherr. U rujshim mos me fol, mos me qit burrin e kunatin. Thoja, po më bie në burg edhe fëmija. Nuk kanë dit gjë! Tani që erdhi kjo jetë e mirë, ka ardhur jetë shumë e bukur sot edhe janë çuar komunistat e kanë ikur e kanë shkuar, kanë ikur nëpër shtete tjetra. Më parë se të gjithë kanë ikur ata.

Kanë ikur kur ka ardhur demokracia?

Kur ka ardhur demokracia, ata kanë ikur vrap nëpër shtete të tjera, në Amerikë, në Greqi... kudo. Ka ikur gjithë ai millet.

A ju ka shkuar mendja sikur të iknit jashtë Shqipërie?

Po, për të jetuar më mirë. Por, jo!

Pse?

Ku me ta marr mendja se shkoj unë?

A e dini kur ka vdekur Enver Hoxha? Kur dëgjuat lajmin, çfarë ndodhi me ju? Ndjetë gjë? Gëzim, çlirim?

Gëzuar?! Jo, kemi kërcyer në shpirt! Çfarë kemi bërë atë ditë? Kemi bërë festë. Dikush ka qarë boll. Por ne, besa kemi gëzuar! Atë ditë kemi prë një pulë për gëzim!

A të kujtohet kur ka ndodhur?

1985. Më 16 shkurt² ka vdekur, more.

Vdiq diktatori por, prapë ai sistem mbeti. E viji edhe Ramiz Alia, apo jo?

Na u duk sikur çfarë po ndodh. U thye busti komunist³. Ishte ideologjia...

2. Këtu ngatërrohet datën e vdekjes së diktatorit me vite më pas kur u rrëzua busti i tij nga demonstratat e protestës popullore më 20 shkurt. (Shënim i redaktores M. Sinani)

3. Edhe këtu vijon të flasë për të njëjtën ngjarje, rrëzimin e bustit të diktatorit (Shënim i redaktores M. Sinani)

Në vend të
jeni te shtëpia
të bëni pajën,
shkoni të
bëni kanalet e
shtetit, e qante
nëna me lot.
E kishte atë
merak!

Menduat që kaq ishte?

Kemi vuajtur edhe pak, por e kemi ditur që do ia dalim. U çua i gjithë populli në këmbë. Në Tiranë e kanë rrëzuar bustin e Enverit, popull i madh e çfarë kanë bërë atje. Edhe këtu në Shkodër, më parë se ata biles. E janë vra nja 4 vetë, rini, kështu.

Meshën e parë e kemi bërë në Xhaminë e Plumbit në Shkodër. Janë dy raste që kemi marrë pjesë si familje. Kur u hap kisha në Shkodër, ka ardhur gjithë populli i Shkodrës.

Në cilën kishë?

Kisha e të Mëdhenjve. Mesha e parë, Don Simoni i parë. Ai ka marrë guximin, se thoshin,- do vrasin popullin. 50% kanë ardhur edhe myslimanë. Nuk ndodhi asgjë. Kanë hyrë të gjithë, veç me e ndër-tuar atë kishë. Ka qenë e prishur. Kanë ardhur myslimanë e katolikë, veç duke qarë. Prej gëzimit qanin. Erdhën tek kisha të gjithë myslimanët, veç me na ndihmuar neve. Edhe për xhaminë kanë ardhur katolikë. Qanin të gjithë, gra e fëmijë, për bukurinë e asaj meshe. Tani ia kanë nxjerrë një këngë, për meshën atë ditë. O zot, të bën të qash.

Si është ajo kënga?

Nuk e di. Uratë a çfarë është, e di Don Simoni, që ka mbajtur meshën e parë. Veç nuk di ta tregoj, aq bukur që e kanë nxjerrë. Ju si besimtarë katolikë, si e keni përballuar kohën kur ndalohej besimi? Ka qenë shumë siklet. Nuk kam guxuar as për festa. Të gjithë ishin pushim, Ne ishim të detyruar të shkonim në punë, nuk na linin të festonim.

A i kryenit lutjet me vete?

Po me vete, po, e kam mbajtur.

Si?

E kemi mbajtur, se kemi patur dëshirë për Zotin. Ka qenë kisha e Shna Ndout, Kisha e Laçi i themi, edhe atje nuk kanë shkuar se nuk i kanë lënë. I merrnin i fushin drejt në burg, i kanë rrahur. Nuk i kanë lënë.

Gjatë kohës që ju internuan apo kur ishin mbyllur në kamp në Tepelenë, a ju kanë godi-

tur fizikisht, qoftë juve si fëmijë, qoftë nënën e motrën?

Goditur? Joo, kemi qenë të vogla. Po çfarë nuk kanë bërë...

E di që e keni të vështirë. A mundeni të na tregoni diçka për nënën Rinë?

Nëna Rina ka pas kujtime si ata italianët... Ka pas kujtime boll, por nuk na e ka shprehur ne fëmijëve, se kishte merak po na vjen gazepi në shtëpi. Nuk na e shprehte, se boll e kanë munduar. Po tani ma zi është.

Përse?

Sa për nder, kush ka dashur s'kish kush ta ndalte... të doje të bëje lojra e gjëra me ta, jooo...

A ka folur ndonjëherë nënë Rina për Mirashin? E ka marrë malli për burrin?

Besa e ka marrë malli boll, për Palin për djalin. Për djalin ka qarë. Dhe kur ka qenë duke dhënë shpirt, "Pal, nuk po të shoh nëna", tha. Edhe Pali, kur ka qenë në fund, ka parë nënën time. E pa duke ardhur, edhe tha, "erdh Rina". E kanë pas fatin që u ndanë nga jeta të dy. Pali e ka pas merak ta vinin tek nëna. Kishte marrë një grusht dhë nga nëna, e kishte patur në xhep. Varrin ia kanë bërë fort mirë. Tek baba janë tre, në kufi e ka baba. Ai ka qenë në Amerikë. Ka pas vëllain Gjelo-shin në kufi ku ka pas shtëpinë përpara. Kishte thënë, më merr e më çu, se du me shku atje prej meraku, në kufi, tek vëllai, më duket se më vjen ajri i Shqipërisë. Prej merakut, ka thënë, më vjen ajri i Shqipërisë me më çu në kufi. Atëherë, aty ia kanë bërë varrin e kanë shtirë aty, edhe axha Gjelo-sh aty ka hyrë. Edhe Drania me ta.

A e keni parë më babën?

Tek varri, i kanë vënë një fotografi të madhe.

Kur ka qenë duke dhënë shpirt e kanë pyetur: çfarë ke? Ka thënë, kurr gjë s'po kam merak, veç të shkoj në vendin tim. Për atë, e kanë lënë 15 vjet në burg në arkivol. Kur u lirua, e prunë.

Dashuritë e vjetra kanë qenë shumë më të fuq-

Kam shkuar në Tepelenë dhe na dukej sikur ku isha, e jo mo të shkoj nëpër shtete. Thonë, vendi i huaj, mjerë kush e shkel, nuk thonë, lum kush e shkel!

ishme se sa sot. Pse ndodh kjo? Lek Vuksanika iku pas Kacoles. Ka marrë vajzën e fejume dhe ka ikur Leka mbrapa. Kanë shkuar e kanë jetuar bashkë. Sot nuk e bëjnë një gjë, kaq ekstreme. Kanë pas edhe pjesën e vuajtjeve, dhe pjesën e mrekullueshme njerëzore. Leka ka lënë 5 vajza të mrekullueshme, janë në Amerikë. Janë me shkollë, të mira, të mrekullueshme. Kjo është një intervistë e vogël që mund t'i bësh hallës ti, por është gjë e madhe, që këto gjëra të jenë diku. Por kjo është realiteti. Ne nuk dimë të gënjejme. Nuk kemi ndonjë trysni prej dikujt që të themi kjo, kjo, kjo. Shteti do vazhdojë punët e veta. 5 parti bënë një shtet në Amerikë. Kurse në Shqipëri akoma grinden...a ku e di unë. Një gazetar nuk është i lirshëm. I thashë këtij djalit, dëgjo njeriu ka dinjitet, këtë e kam shkruar bazuar mbi këtë fakt. Po nuk mundem unë të tjetërsoj. Po kjo është bazë. Kjo nesër mund të bjerë poshtë, por mund edhe të mbijetojë. Mund të jetojë në çdo kohë. Mua më ka takuar të rrija 17 vjet në Tropojë. Fshat për fshat i kam shëtitur, me thënë të drejtën.

Babën e kam futur me duar në tokë. Edhe nënën. Jeta e fëmijëve, duhet të krijoj mundësi të tjera. Kam bërë gjithçka.

Kur ke qenë vajzë në internim, a mbani mend çfarë mendonit ju se po ndodhte?

Ne mund mos të shkonim më në shtëpi. Kur shikonim makina e motorra me targa Shkodre, na dukej sikur i thonim "na merrni në shtëpi". Ishim mërziur në Tepelenë; kur shikonim makinat na dukej sikur shikonim shtëpinë. Edhe një punë e ka pas Tepelena të keqe. Aty ishte vend lufte dikur, kazerma të ushtrisë. Por kishin lënë edhe municione, nëpër lumë. Aty, ishte një hapësirë me la teshat, dhe disa njerëz na kanë vdekur aty. Bënin zjarrmin, u hapshin bumet, e tredhnin me gjithë kazan. Edhe tani trembem kur bën zjarrin kush. Po shprazen bumet. Më ka mbetur në shpirt. Janë mbytur shumë atje me bume. I kanë çuar të internuarit për t'i mbledhur nëpër lumë. Kur na niste në punë që natën, nëna qante me lot. Në vend të jeni te shtëpia të bëni pajën, shkoni të bëni kanalet e shtetit, e qante me lot. E kishte atë merak!

A keni ndejtur pranë nënës kur ajo u vendos në Theth?

Kam shkuar, po s'ka pas makina...veç kamiona. E takonim. Kur është sëmurur, më çoi fjalë djali

axhës. Më ka thënë është nëna sëmurë, hajde. Dhe kam shkuar edhe më ka lënë dy javë burri. I kam bërë yzmet deri sa dha shpirt në dorën time. Ka vdekur shumë kollaj. Veç me Palin në gojë. 40 vjet pa e parë!

Cila ka qenë fjala e fundit?

Ajo, besa, e pati prurë dhëndri tjetër. Të tërë i thirri, gjithë robtë e shtëpisë, ua linte merakun, amanetin, ti kështu, ti kështu, mua s'ma ka lënë. E mori për vete. E kam pasur merak gjithë jetën, si s'ma la mua.

Çfarë amanetesh ka lënë?

"Ata nuk i shohim më, veç bëni derman për vete. Shifni jetën tuaj, se ata nuk vijjnë më. Kanë marrë dhet' e huaj". Thoshte "ka qenë shtëpi e mirë e punës". Vinin kosovarët u jepnin bukë. Kjo bukëdhënia i ka shpëtuar të gjithë, që nuk i ka gjetur gjë, as nuk i ka vrarë kush. Vetëm kur të vjen prej zotit. Kurrë nuk të gjen gjë prej bukës dhe nderës që kemi dhënë. Ka qenë shtëpi e madhe: 36 vetë kanë jetuar të gjithë. Tani nuk kanë qejf, nuk duhen kunatat. Në atë kohë ishim 36 bashkë. Si u ka thënë vjehrra grave, si u ka thënë i zoti i shtëpisë, ajo ka qenë më bukur!

Si e jetuat momentin e kalimit nga diktatura në demokraci?

Mirë ishte ajo punë, po prapë me gjys gëzimi edhe pse erdhi demokracia, babën nuk e pashë, vëllai erdhi vonë. Atëherë kur erdhi ai, erdhi me sëmundje, nuk jetoi. Ku t'ia shohim hajrin ne, tani?

E kujtoni këtë kohë, flisni me familje apo mikeshat?

Po, more. Kush e ka vuajtur, unë e kam vuajtur boll. E flasim, si nuk e flasim. Fort bile. Vuajtjet e mia i kam kujtim!

Djali im donte ta çonte Palin në Theth. Ka shkuar e ka marrë në Shkodër, me e qit Palin atje, tek oborri. Ne me burrin shkuam me makinë tjetër. I them, na e ndal makinën se dua të shkoj tek nana; u ula, qava, i thashë, ka ardhur Pali, ti nuk po e sheh e as nuk e ke parë. Ajo nuk foli hiç. Jeta paska shumë. Na duket e gjatë prapë, po

nuk është fort e gjatë. Kalojnë. Lum kush e kalon mirë! Me punë pa punë, i ngrënë i pa ngrënë nuk kemi bërë zë. Tash duan gjithçka.

Hallë, rrofsh 100 vjet.

Edhe atë s'po e du.

Përse? Tash familja është shumë mirë, shtëpia shumë bukur.

Po, gjithçka boll mirë. Thotë nusja nganjëherë, pse të rrinë këtu për të vuajtur? Të shkojnë diku, në ndonjë shtet tjetër. I thashë: e kush të pret atje? Po nuk i kam thënë kurrë, do na lini neve vetëm. Ne kemi qenë të vuajtur. Duhet lekë për në Amerikë. Lekë për në Francë.

E ke qejf Shqipërinë?


E kam qejf Shqipërinë, të thashë, kam shkuar në Tepelenë dhe na dukej sikur ku isha, e jo mo të shkoj nëpër shtete. Thonë, vendi i huaj, mjerë kush e shkel, nuk thonë lum kush e shkel, por mjerë. Atje kanë shkuar me gazep edhe ata që kanë shkuar. Dikush ka ndenjur poshtë urës se nuk ka pas, me javë e muaj. Nuk ka pas ku të hyjë, nuk i ka dashur kush. I kanë ndjekur me gomone në det...Unë kam ndenjur 7 vjet pa folur se s'kam pas telefon. Kur kanë shkuar me gomone, i kanë lënë në det që 200 metra larg. Kanë qenë burë e grua me dy fëmijë, njërin 3 vjeç e tjetrin 5 vjeç. Zoti i ka shpëtuar. Pas 7 vjetësh, më ka shkruar letër, krejt vuajtjet si kanë shkuar, krejt, 22 fletë i kam, që kur është nis këtu e deri si kanë mbërritur atje. 7 vjet pa i parë e pa dëgjuar asgjë. Kur kanë marrë letrat i kanë marr krejt për gjithçka. Më thotë "i morëm letrat". Të gëzoj që i ke marrë, i them, po më fort jam gëzuar kur keni kaluar detin. Ajo vjen. Nganjëherë vjen.

Çfarë bëni këto ditë, a po merreni me bahçe?

Unë vetë nuk merrem me bahçen, hiç. Ia kam lënë nuses tani. Kam punuar boll, gjithçka, tash nuk mundem. Nipat e mbesat i dua ma kalojnë mërzinë. Të gjitha më duan fort. Tana të mirat i kanë.

Ju falënderojmë për gjithë këto kujtime që na dhatë. Shëndet e gëzime te gjithë njerëzit tuaj të dashur.

**DHE UNË I KAM THËNË PIKË
“FALEMINDERËS MOS QOFSHA,
DERISA E DI VETEN TË PAFAJSHËM”,
PIKË “FALEMINDERËS MOS QOFSHA!”.**
NGA DËSHMIA E Z. HAZIR HAZIRI



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT